



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Auditim Financiar”

Tiranë, shkurt 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4-5
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	5-6
II.	HYRJA	6
1.	Objektivat dhe qëllimi	6
2.	Identifikimi i çështjes.....	6-7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	7-8
5.	Kriteret e vlerësimit.....	8-9
5.	Standardet e auditimit.....	9-10
7.	Metodat e auditimit.....	10-11
8.	Dokumentimi i auditimit.....	11
III	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	11
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	11-12
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	12
2.1	Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.....	12-19
2.2	Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	19-39
2.3	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023.....	39-58
2.4	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	58-85
IV	REKOMANDIME	85-96

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Mirditë, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Mirditë për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqënies së qytetarëve. Në Raportin e Monitorimit për Buxhetin 2023, të publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Mirditë dhe të dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, janë evidentuar parashikimi sipas PBA 2023-2025, buxheti fillestar 2023, buxheti i rishikuar 2023 dhe realizimi i buxhetit 2023. Nga përlllogaritjet e grupit të auditimit, rezulton se mosrealizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 është në vlerën 183,317 mijë lekë ose i realizuar në masën 88,2%. Niveli i realizimit të të ardhurave, rezulton masën 87.8% ose me mos realizim në shumën 8,823 mijë lekë.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.

Auditimi i këtij subjekti është auditim i radhës, sipas planit vjetor të miratuar në fillim të vitit 2024, nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit dhe në vijim të rëndësisë që ka auditimi i njërive të vetëqeverisjes vendore sipas detyrimeve që lindin nga kërkesat e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njërive të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Mirditë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit.

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e opinionit financiar mbi veprimtarinë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
- Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Metodot e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në

procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse; Raporte dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 17 gjetje dhe ka dhënë 18 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore.

Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me procedurat e mbajtjes së sistemit të kontabilitetit; me plotësimin e dokumentave kontabël në përputhje me ligjin; me hartimin dhe plotësimin e gjurmës së auditimit; me procesin e inventarizimit; Për periudhën objekt auditimi ka rezultuar se ka mangësi në funksionim të ligjit Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit me afat 5 vjeçar të Bashkisë Mirditë; mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit etj. Vlera e përllogaritur për vjeljen e tarifës së hapësirës publike nuk është në përputhje me përcaktimet e Paketës Fiskale, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën prej 1,793,110 lekë; në lidhje me penalitetet Drejtoria e të Ardhurave nuk i ka aplikuar në përputhje me përcaktimet ligjore e dhe rezultoi një diferencë prej 1,254,409 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë; disa subjekte (për tarifën e pastrimit), nuk janë tarifuar sipas VKB-së nr.100, datë 30.11.2022 për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2023” duke krijuar të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë në vlerën prej 4,690,000 lekë; janë krijuar të ardhura të munguara nga mos aplikimi i penaliteteve për kontratat e lidhura, në vlerën prej 576,821 lekë, dhe 16,129,719 lekë të ardhura të munguara nga mos mbledhja e detyrimeve të qerasë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Mirditë, Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit dhe Pyjeve, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin në Pasqyrat Financiare, të pronave, Pyje, kullota, plantacione.
- Strukturat Drejtuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë të marrin masa, që të kryhet procesi inventarizimit dhe vlerësimit të i aktiveve të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.
- Titullari i Bashkisë Mirditë, me atributet e Kryetarit të GMS dhe Koordinatorit i Riskut të institucionit, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin e risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.
- Bashkia Mirditë, përmes Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për të nxjerr njoftimet e vlerësimeve për arkëtimin e detyrimeve, për taksën e hapësirës publike nga debitorët, në shumën prej 1,793,110 lekë.

- Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit të marrë masa për të nxjerr njoftimet e vlerësimeve për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve (të ndodhura në tabelën nr.II.6.5), duke përllogaritur edhe penalitetet përkatëse sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe të kryejë kontabilizimin e tyre, në vlerën prej 7,091,347.
- Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit në Bashkinë Mirditë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 16,129,719 lekë, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 10 subjektet qiramarrës, të bëjë llogaritjen e kamatëvonesave për këto detyrime si dhe ato të mbledhura pa llogaritur kamatëvonesat në vlerën prej 576,821 lekë. Në rast të mos kryerjes së pagesave nga qiramarrësi, të ndërmerren hapa ligjor sipas parashikimeve të bëra në kontratë deri në zgjidhjen e saj.

I. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

Për drejtimin e Bashkisë Mirditë mbi auditimin e pasqyrave financiare:

Opinionit i auditimit mbi pasqyrat financiare.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Mirditë për vitin ushtrimor 2023, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një ***opinion të pamodifikuar/pakualifikuar me theksim të çështjes*** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Mirditë, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Pakualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2023, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemin e tyre.

Baza për opinionin:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 3,361 mijë lekë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për

këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

“Theksimi i çështjes”:

- Në pasqyrat financiare, gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fund të vitit 2023, paraqitet me një vlerë 6,284,216 lekë e pa ndryshuar, nga viti mëparshëm. Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

- Referuar analizës aktiv për aktiv të gjendjes në vlerë bruto prej 2,360,758,322 lekë të llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” u konstatuan aktive të cilat, nuk është kryer inventarizim fizik për të verifikuar nëse gjendja fizike përputhet me atë kontabël.

- Gjendja e llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”- rezultoi se vlera në fund të vitit 2023 ka në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të Bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i mungesës së informacionit, të mbartur si problematike nga ish komunat dhe Bashkitë. Në këtë rast garancive të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur janë në vlerën 103,894,850 lekë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1344/1 prot., datë 13.11.2024, të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 14.11.2024 deri më datë 16.12.2024, në subjektin Bashkia Mirditë, për periudhën e veprimtarisë së subjektit, nga data 01.01.2023 deri në 31.12.2023, u krye auditimi “Mbi auditimin financiar”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- T. A, Përgjegjës Grupi.
- S. D, Auditues.
- K. F, Auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

Objektivat dhe qëllimi i auditimit: është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të Bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet Projektaporti i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Mirditë.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bzaë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i

shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Mirditë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit të gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Mirditë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Kryetari i Bashkisë Mirditë (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Mirditë, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e Bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t’i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Mirditë në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të

arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Mirditë është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

Kriteret e vlerësimit: Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; Ligji nr. 137/2020 “*Për buxhetin e vitit 2021*” dhe Ligji nr. 115/2021 “*Për buxhetin e vitit 2022*”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë

29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit: ISSAI 100 “Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

-ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;

-Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;

-Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm.

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);

-Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t.

Metodat e auditimit: Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në

subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Në gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë: Risku i lidhur me shpenzimin specifik dhe Pështetja specifike që një zë shpenzimesh, zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit.

- Kontrolli aritmetik. Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese. Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese. Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- Kontrolli i vlerësimit. Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- Konfirmim nga të tretët. Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërive ose të çdo regjistrimi tjetër.

- Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- Intervistimi - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit: Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet

e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet dhe Verifikimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Projekt Raport Auditimi.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm: Bashkia Mirditë kufizohet në veri me Bashkitë e Fushë Arrësit dhe Pukës, në perëndim me të Lezhës dhe në lindje me Bashkinë e Kukësit, në jug-lindje me Bashkinë Dibër, në jug me Bashkinë Mat ndërsa në jugperëndim me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj Bashkie është Qyteti i Rrëshenit. Sipas Censusit të vitit 2011, Mirdita ka 22,103 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrat Civil kjo Bashki numëron 37,384 banorë. Me një sipërfaqe prej 869.71 km², me densitet prej 42.98 banorë/km² sipas Regjistrat Civil dhe 24.64 banorë/km² sipas Censusit 2011. Bashkia e Mirditës shtrihet në një territor me trashëgimi të larmishme kulturore dhe etnografike, ndërkohë që nëntoka e saj është gjithashtu e pasur me minerale. Mirdita mori rëndësi si rrugë kalimi dhe si porta natyrore hyrëse për në Kosovë, pas ndërtimit të autostradës Përveç cilësisë së udhëtimit, kjo rrugë solli një impakt modest për zhvillimin social-ekonomik të zonës. Sipërfaqja e pyjeve në Bashkinë e Mirditës është 10 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore. Për këtë arsye, problemet ekologjike të zonës, të tilla si përpunimi i drurit, ai i frutave të pyllit, prodhimi i lëngjeve vitaminore dhe zhvillimi i gjuetisë sportive janë të lidhura me pyjet. Një nga fushat më interesante është edhe shfrytëzimi i kapaciteteve hidro-energjetike të lumenjve të Fanit të Madh dhe Fanit të Vogël, Urakës, Zallit të Dodajve, dhe përrrenjve të tjerë malorë, ku vlerësohet se mund të sigurohen kapacitete prodhuese energjetike deri në 60 MW/H. Pasuritë e mëdha nëntokësore të Mirditës kanë bërë që në territorin e kësaj krahine të krijohen katër qytete, të cilat janë të lidhura me industrinë minerare. Pjesa më e madhe e kësaj industrie është e mbyllur tashmë. Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në formë të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.

Në zbatim të nënpikës 2.1.1 të programit të auditimit: “Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Veprimtaritë e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

3. Strukturën organike të institucionit me ndryshimet për vitet objekt auditimi dhe nëse ka pasur ndryshime në strukturë, a është reflektuar edhe në rregullore;

4. Shkresat e përcaktimit të NA në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;

5. Shkresat për krijimin e grupeve të Menaxhimit Strategjik;
6. Trajnimet e stafit si dhe planifikimet për trajnime të tyre;
7. Strategjinë dhe Regjistrin e Riskut;
8. Lista ose harta e proceseve të punës;
9. Raportet e Monitorimit;
10. Pyetësori i Vetëvlerësimit dhe a është dërguar në Ministrinë e Financave;

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Mirditë, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: *“Mjedisi i Kontrollit”*, *“Menaxhimi i Riskut”*, *“Aktivitetet e Kontrollit”*, *“Informimi dhe Komunikimi”* si dhe *“Monitorimi”*, sipas përcaktimit të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* i ndryshuar, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijon dhe vlerëson sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë deri diku mirë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

1. Mbi mjedisin e kontrollit

-Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

(Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010) Bashkia Mirditë funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Mirditë, nr. 4600 prot, datë 27.10.2022. Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përta i përket pjesës për Rregulloren Brendshme të Njësisë Publike, vihet re se është hartuar bazuar në këtë manual, duke përmblajtur disa elemente thelbësore që çdo rregullore duhet të ketë.

- Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

-Kodi i Etikës Kodi i Etikës që funksionon për vitin 2023 është miratuar në vitin 2020, shkresa nr.502/1 prot., 06.02.2020, në bazë të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, Urdhër Nr. 28, datë 06.02.2020, nr. 502 prot., bazuar në legjislacionin përkatës, ku mbështetet Njësia Publike për hartimin dhe përpilimin e tij. Rezulton se si grup pune, për hartimin e Kodit të Etikës Profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, Kryetari i Bashkisë ka ngarkuar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun; dhe Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”.

Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës: Për vitin 2023, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Mirditë, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2023, me shkresën Nr.764. prot., datë 15.02.2022, është gjithsej 380 punonjës, përfshirë këtu edhe punonjësit e Institucioneve (agjencie) në varësi të Bashkisë edhe ata të Njësisë Administrative. Nga të cilët

në pozicione pune, trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, janë, 55 punonjës me status, Shuma totale e punonjësve në Agjencitë e varura nga Bashkia dhe marrëdhëniet e tyre rregullohen me KP do të jetë 259 punonjës. Nga auditimi u konstatua se, për emërimet dhe largimet, sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” Kreu III, pika 27 dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale sipas, e cila përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

- Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Përsa i përket politikave që lidhen me burimet njerëzore jo në çdo rast janë zbatuar kërkesat sipas manualit MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Kapitulli III pika 3.1. Komponentët E Menaxhimit Financiar Dhe Kontrollit si më poshtë:

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

-Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;

- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;

-Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t’i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;

-Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;

- Një sistem stimulues për punonjësit për t’i nxitur të rrisin cilësinë e kryerjes së detyrave të caktuara;

- Një sistem për qarkullimin e punonjësve për të lejuar punonjësit të përftojnë një eksperiencë të gjerë në njësinë ku punojnë;

- Një sistem transparent sanksionesh, që të përcjellë një ide të qartë të qëndrimit të titullarit të njësisë ndaj shkeljes së rregullave të vendosura dhe një tolerancë zero ndaj sjelljeve të tilla;

- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

2. Mbi menaxhimin e riskut

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Për vitin 2023 është hartuar regjistri i riskut me shkresën nr.5004/1 prot., datë 25.11.2022.

Me urdhër të brendshëm nr.477 prot datë 27.12.2023 është caktuar koordinator i riskut znj.D P, me pozicion Zv. Kryetare e Bashkisë Mirditë.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”.

Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të Bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e Bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshira detyrat dhe përgjegjësit e koordinorit të riskut, dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe gjithëpërfshirës.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Mirditë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet programit Excel ose Word.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u konstatua se nga Bashkia Mirditë nuk ka plane operacionale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit (me afat 5 vjeçar) të Bashkisë Mirditë sipas përcaktimit në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi koordinatori i riskut.

3. Mbi veprimtaritë e kontrollit

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”.

Grupi i Menaxhimit Strategjik (Në zbatim të kërkesave të nenin 22, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010) Referuar shkresës, Urdhër Nr. 64, datë 02.03.2023, nr. 887 prot., datë 02.03.2023 “Për ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjik”, të përbërë nga 15 anëtarë, për përgatitjen e Buxhetit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Mirditë. Deklarata e Cilësisë për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm, për vitin 2023 është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE me shkresën nr. 820/2 prot., datë 27.02.2023. Pyetësi i Vetëvlerësimit

për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për Bashkinë Mirditë, është hartuar dhe miratuar sipas formatit standard të manualit MFK. Përgjithësisht pyetësi është realizuar duke u mbështetur në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Vlerësimi i riskut është bërë sipas katër seksioneve, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”.

- Mungojnë procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) për ruajtjen e tij në raste të jashtëzakonshme.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

-Raporti vjetor për funksionimin e sistemi të kontrollit të brendshëm, viti 2023.

Për vitin 2023, është hartuar dhe përpiluar sipas manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, bazuar në Neni 18, Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke përmbajtur të gjitha rubrikat kryesore si përmbledhja ekzekutive, vlerësimi i sistemit të MFK-së, gjetjet dhe rekomandimet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm, masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen. Harta e Proceseve të Punës Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë, për periudhën objekt auditimi 2023, funksionon me hartën e proceseve të punës të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, me shkresën nr 5491/2 dt 30.12.2023. Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen për periudhën objekt auditimi, është i hartuar dhe miratuar për periudhën 2023, nr. 5491/4 prot., datë 30.12.2022.

Gjurma e Auditimit e Bashkisë Mirditë.

Në Bashkinë Mirditë, bazuar në Urdhër Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., “Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK”, janë hartuar gjurmët e auditit për gjithë aktivitetin ekonomik - financiar, duke marrë në konsideratë ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si më poshtë:

Gjurma e Auditit në përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA (2024-2026) Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., “Për miratimin e dokumenteve të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK”, gjurma e auditit për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm PBA është miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe hartimi i saj është për periudhën 2023 - 2025 sipas shkrësës Nr. 919 prot , datë 27.02.2023.

Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, përgatitja e kërkesave buxhetore; kërkesa shtesë për shpenzime në programin buxhetor afatmesëm; raportimi i kërkesave buxhetore. Gjithashtu janë paraqitur të gjitha proceset e kategorive të sipërpërmendura, duke adresuar edhe strukturat përgjegjëse që angazhohen me secilin nga proceset.

Gjurma e Auditit e zbatimit të Buxhetit (viti 2022) Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., “Për miratimin e dokumenteve të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK”, gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe hartimi i saj është për periudhën 2022 sipas shkrësës Nr. 820 prot , datë 27.02.2023. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, procedurat standarde të shpërndarjes së fondeve të buxhetit vjetor (rishpërndarja e fondeve buxhetore, numri i punonjësve buxhetorë); procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike; marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve

publike; rakordimi mujor i shpenzimeve; titulli për arkëtim dhe paraqitja e tij në bankat e nivelit të dytë; rakordimi mujor i të ardhurave; raportet e monitorimit. Gjithashtu janë paraqitur proceset e kategorive të sipërpërmendura, duke adresuar edhe strukturat përgjegjëse që angazhohen me secilin nga proceset. Bashkangjitur me gjurmën e auditit për programin buxhetor afatmesëm PBA, është hartuar edhe përshkrimi i punës, për detyrat specifike, që kryhen në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit.

4. Informimi dhe komunikimi

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

- Sistemi i raportimit nuk ofron sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e Bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

Komunikimi i brendshëm Një prej kanaleve më të rëndësishme të komunikimit nuk është në nivelet e duhura, në një njësi është ai ndërmjet titullarit, menaxherëve dhe punonjësve të tij “komunikimi vertikal”. Punonjësit nuk njihen sa duhet me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdo njeri ka në këtë sistem. Falë komunikimit ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me UMF nr.108, datë 17.11.2016. Kapitulli III. Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.4.

5. Monitorimi

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”.

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 24. Manuali i MFK, miratuar me UMF nr. 108, datë 17.11.2016.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”.

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit: Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, nënpika 1.2 “Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm”, dhe nënpika 1.3 Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Baza Ligjore: Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”;

-Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, VKM nr. 83, datë 03.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, me VKM nr. 353/2016.

-Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”.

- Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2023 ka funksionuar me 3 Auditues me, 1 përgjegjës Sektori dhe 2 specialiste audit, sipas VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, ku sipas pikës 3, të këtij vendimi thuhet se “Njësia e Auditit të Brendshëm përbehet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e Njesisë”. Në strukturën e Njesisë së Auditit të Brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si Auditues të Brendshëm në sektorin publik.

Tabela nr. I.1, Struktura e Auditit të Brendshëm me të dhënat sipas tabelës;

Nr.	Nga data e krijimit 03.04.2017 deri me 31.12.2023	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme	Shënime
1	A. M 12.04.2017	Përgj. AB	I lartë Ekonomik	7	06.07.2018	40 orë	Larguar me 31.12.2023
2	G. M 01.08.2017	Specialist	I lartë Juridik	7	05.07.2019	40 orë	Vazhdim
3.	G. N 24.11.2021	Specialist	I lartë Ekonomik	2	01.07.2023	40 orë	Vazhdim

Burimi: Bashkia Mirditë Njësia e Auditit të Brendshëm.

Plani strategjik:

Planet Strategjike dhe Vjetore të NJAB të Bashkisë Mirditë janë përcjellë në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”

Për vitin 2023 është miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr. 4125/2 prot datë. 17.10.2022 plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2023-2025 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Mirditë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te MFE raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2023 me shkresën nr. 615 prot., datë 12.02.2024. Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Mirditë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike.

Karta e AB: Për miratimin e kartës së Auditit të Brendshëm”, Karta e Auditit të Brendshëm është dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave me shkresën nr. prot 3935/2 datë 14.10.2022.

Plani Vjetor: Për vitin 2023 është miratuar ndryshimi i planit vjetor me shkresën nr. prot 4240/2 dhe me relacion shpjegues nr.4240/1 data 11.10.2023.

Për vitin 2023 janë planifikuar 5 dhe realizuar 5 auditime si më poshtë vijon:

Tabela I.2.; auditimet e kryera nga AB për vitin 2023;

Nr.	Subjektet e audituara	Lloji i auditimit
1.	Njësia Administrative Orosh 2023	
2.	Njësia Administrative Kthellë 2023	
3.	Drejtorja e Burimeve Njerëzore (Ndryshim plani vjetor nga Kryetari) 2023	
4.	Njësia Administrative Selitë 2023	
5	Spektori i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (Ndryshim plani nga Kryetari) 2023	
	Zbatimi i rekomandimeve të vitit 2022	Monitorim
	Monitorimi i rekomandimeve të KLSH-së për vitin 2022	Monitorim

Burimi: Bashkia Mirditë Njësia e Auditit të Brendshëm.

Nga auditimi rezulton se nga 5 auditimet e realizuara janë kryer auditime të llojit auditim përputhshmërie.

Tabela nr.I.3 të dhënat sipas raportimit

Nr	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2023	24	13	11	0	0	0	0	0
TOTALI		24	13	11	0	0	0	0	0

Burimi: Bashkia Mirditë Njësia e Auditit të Brendshëm.

Nga auditimet e kryera janë dhënë në total 24 rekomandime, nga të cilat 11 rekomandime janë në proces zbatimi, 13 prej tyre janë zbatuar.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se:

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se në disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit. Në fund të procesit të auditimit në disa dosje mungojnë letrat e punës për secilin auditues të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit.

Nga njësia e Auditimit të brendshëm nuk janë kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, Asetet, Taksat dhe tarifat vendore etj. Njësia e Auditimit të brendshëm duhet të marrë në konsideratë se disa fusha me risk të lartë mund të nevojitet të auditohen çdo vit, sepse kanë në vazhdimësi risk shumë të lartë dhe sjellin ndikim negativ në njësinë publike. Gjithashtu konstatohet se në ndryshimin e planit të auditimit nuk pasqyrohen shpjegimet e ndryshimeve të bëra, dhe arsytet që kanë ndikuar në lidhje me ndryshimin e planit. Këto veprime janë në kundërshtim me MAB të miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” kapitulli II 8. Plani i auditimit të brendshëm, kapitulli III pika 3.1.1. pika 3.4, 3.1.4 3.13 kapitulli IV, pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”; Kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, pika 6.1 “Niveli i dokumentimit.

2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni i hartimit të PBA 2023-2025 auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
- Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
- Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Mat për shpenzimet dhe të ardhurat;
- Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
- Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të pa likuiduara dhe vendimeve gjyqësore;
- Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimin të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
- Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;

- Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj).

2.1 Programimi PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023:

Bashkia Mirditë për vitin 2023 ka hartuar dhe miratuar buxhetin, në zbatim të kërkesave:

- te ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,
- te ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,
- te ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor RSH” ndryshuar,
- te ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, - të ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”,
- te udhëzimit plotësues MF nr. 1 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”.
- te UMF 8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm 2023-2025”,
- te UMF 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”,
- te UMF 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”,
- të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

Për vitin 2023 buxheti i Bashkisë Mirditë është miratuar me VKB nr. 110, datë 30.11.2022 “Për miratimin e buxhetit 2023”

Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor i dërguar nga Kryetari Bashkisë në Këshill Bashkiak për miratim, bazuar në udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor VKB nr. 8 prot., datë, 31.01.2022 dhe me shkresën nr. 377/1 Prot., datë 02.02.2022.

-Udhëzimi vjetor i Kryetarit të Bashkisë për përgatitjen e buxhetit afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore 2023- 2025 nr. 1 prot., datë 05.04.2022 dhe me shkresën nr. 1491 prot., datë 05.04.2022, Udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit afatmesëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore 2023 - 2025 nr 2. datë 29.07.2022 me nr. 3376 Prot., datë 29.07.2022.

- Me shkresën nr. 1252/1 prot., datë, 29.03.2022 dhe vendim të kryetarit të Bashkisë nr.27 prot., datë 29.03.2022, janë miratuar tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025.

Me shkresën nr. 3220/1 prot., datë, 27.07.2022 dhe vendim të kryetarit të Bashkisë nr. .59 prot., datë 27.07.2022, janë miratuar tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së 2023-2025.

Urdhri i Titullarit të Institucionit nr. 86, datë 11.03.2022, “Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Urdhri i Titullarit nr.85 prot., datë 11.03.2022 , “Për ngritjen e ekipeve të menaxhimit të programeeve EMP”

Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Tabela nr.II.1. PBA 2023-2025;

000/lekë

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
1	AA133 Aparati dhe Drejtimi i Bashkisë	97,607	20%	97,607	20%	99,708	20%
2	AB133 Punët Publike dhe Mirëmbajtja	120,439	25%	120,439	25%	124,204	25%
3	AC133 Siguria Publike	48,514	10%	48,514	10%	50,514	10%
4	AD133 Arsimi, Shërbimi Social, Kultura dhe Sporti	163,205	33%	163,205	33%	165,640	33%
5	AE133 Bujqësia, Veterinaria dhe Pyjet	57,579	12%	57,579	12%	60,079	12%
6	RK133 Fondi Rezervë dhe Kontigjencë	3,000	1%	3,000	1%	3,000	1%
	TOTALI	490,344		490,344		503,145	

Burimi : Bashkia Mirditë.

Tabela nr.II.1.1. Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023;

Planifikimi i të ardhurave 2023		Planifikimi i shpenzimeve 2023	
Burimi i të ardhurave	Vlera në 000/ lekë	Emërtimi i zërave	Vlera në 000/ lekë
Të ardhura të planifikuara për vitin 2023	75,000,000	Art. 600 Paga	330,135,686
Te ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023	3,072,905	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shend.	53,560,071
Total të ardhurat e veta	78,072,905	Art.602 Shpenzime operative	79,763,000
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.	42,815,113	Art.604 Transferime korrente te brendshme (Fondi I emergjencave civile)	2,500,000
Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.).	17,385,190	606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	4,932,000
Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2023	257,814,619	Art.230-231 Investime	103,433,188
Transferte specifike e çelur për llogari të vitit 2023	182,736,118	Fondi Rezervë + Kontigjencës (604)	4,500,000
Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit	500,751,040		
TOTALI TE ARDHURAVE	578,823,945	TOTALI SHPENZIMEVE	578,823,945

Burimi : Bashkia Mirditë.

Tabela nr.II.1.2 Konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit;

Nr.	Gjatë hartimit të PBA 2023-2025	Gjatë hartimit të Buxhetit 2023
1	Njësia Administrative Rrëshen datë 07.11.2022 ora 16:00, datë 17.11.2022 ora 16:00, datë 23.11.2022 ora 16:00	Njësia Administrative Rrëshen datë 07.11.2022 ora 16:00, datë 17.11.2022 ora 16:00, datë 23.11.2022 ora 16:00
2	Njësia Administrative Rubik datë 22.11.2022 ora 16:00	Njësia Administrative Rubik datë 22.11.2022 ora 16:00
3	Njësia Administrative Kaçinar datë 20.10.2022 ora 10:00	Njësia Administrative Kaçinar datë 20.10.2022 ora 10:00
4	Njësia Administrative Orosh datë 24.11.2022 ora 16:00	Njësia Administrative Orosh datë 24.11.2022 ora 16:00
5	Njësia Administrative Fan datë 25.11.2022 ora 16:00	Njësia Administrative Fan datë 25.11.2022 ora 16:00
6	Njësia Administrative Kthellë datë 21.10.2022 ora 16:00	Njësia Administrative Kthellë datë 21.10.2022 ora 16:00
7	Njësia Administrative Selitë datë 21.10.2022 ora 10:00	Njësia Administrative Selitë datë 21.10.2022 ora 10:00

Burimi : Bashkia Mirditë

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësive vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës. Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtë artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të Kryetarit të Bashkisë. Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Mirditë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara. Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara

nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Konkretisht ka ndodhur ndryshimi buxhetor sipas VKB nr.14 datë. 31.08.2023 si shtesë në buxhet në zbatim të VKM nr. 328, datë 31.5.2023, Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të Vetëqeverisjes Vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Tabela nr.II.2. Tabela e ndryshimeve në Buxhet

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023 dhe rishpërndarja e fondeve													
Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar	Buxheti shtesë				Pakësimi i Buxhetit	Shtesat dhe Pakësimet në buxhet në total	Rishpërndarjet: Shtesa/Pakësime të Buxhetit					Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	Miratuar me VKB Nr. 110 dt 30.11.2022	Miratuar me VKB Nr. 19 dt 17.02.2023 (Trashegimet 2022 per 2023)	Miratuar me VKB Nr.14 dt. 31.08.2023 (Shtese buxheti VKM 328 Dt 31.05.2023	Miratuar me VKB Nr. dt		Miratuar me VKB Nr. dt.		Miratuar me VKB Nr. dt	Miratuar me VKB Nr. dt	Miratuar me VKB Nr. dt	Miratuar me VKB Nr. dt	Rishpërndarje total	
	1 (Vlera)	2 (Vlera)	3 (Vlera)	4 (Vlera)		5 (Vlera)	6=2+3+4-5	7 (Vlera)	8 (Vlera)	9 (Vlera)	10 (Vlera)	11=7+8+9+10	13=1+6+11
Art. 600 Paga	304,186,000	3,955,020	21,994,666	-	-	-	25,949,686	-	-	-	-	-	330,135,686
Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	50,181,000	167,000	3,212,071	-	-	-	3,379,071	-	-	-	-	-	53,560,071
Art.602 Shpenzime operative	75,556,000	4,207,000	-	-	-	-	4,207,000	-	-	-	-	-	79,763,000
Art. 603 Sponsorizime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Art.604 Transferime korrente të brendshme (Fondi i emergjencave civile)	1,500,000	1,000,000	-	-	-	-	1,000,000	-	-	-	-	-	2,500,000
Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	532,000	4,400,000	-	-	-	-	4,400,000	-	-	-	-	-	4,932,000
Art. 230-231 Investime	55,389,000	48,044,188	-	-	-	-	48,044,188	-	-	-	-	-	103,433,188
Fondi Rezervë + Kontigjencës (604)	3,000,000	1,500,000	-	-	-	-	1,500,000	-	-	-	-	-	4,500,000
TOTALI SHPENZIMEVE	490,344,000	63,273,208	25,206,737	-	-	-	88,479,945	-	-	-	-	-	578,823,945

Burimi : Bashkia Mirditë.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit, mënyra e përdorimit të të ardhurave.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mirditë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuara të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Mirditë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2023, referuar akt-rakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr.II.3. Buxheti përfundimtar Plan-Fakt

000/lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia, për vitin 2023, në mijë lekë						
Nr.	Përshkrimi i shpenzimeve	Plani 2023	Fakti 2023	Realizimi në %	Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta+Granti	Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti
1	Artikulli - 600 Paga	333,416	291,675	87.48%	284,081	7,594
2	Artikulli - 601 Sig. shoqërore & shend	54,261	48,587	89.54%	47,839	748
3	Artikulli - 602 Shpenzime operative	83,596	65,513	78.37%	64,834	679
4	Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme	8,372	4,844	57.86%	-	4,844
5	Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (Ndihma ek. dhe PAK)	356,448	332,049	93.15%	7,135	324,914
6	Artikulli - 230 Projekte	830	-	-	830	-
7	Artikulli - 231 Investime	718,523	629,461	87.60%	36,945	591,686
	TOTAL viti 2023	1,555,446	1,372,129	88.21%	441,664	930,465

Burimi : Bashkia Mirditë.

Për vitin 2023, planifikimi i buxhetit i rishikuar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore transfertën e pa kushtëzuar dhe specifiken, ka vlerën 1,555,446 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 1,372,129 mijë lekë, ose në masën 88%. Zëri shpenzime page dhe sigurime shoqërore është planifikuar në vlerën 387,677 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 340,262 mijë lekë, ose në masën 87%.

Zëri shpenzime operative (602) është planifikuar në vlerën 83,596 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 65,513 mijë lekë, ose në masën 78%.

Zëri transferta korente të brendshme është planifikuar në vlerën 8,372 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 4,844 lekë.

Zëri transferta buxhete familjare është planifikuar në vlerën 356,448 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 332,049 mijë lekë, ose në masën 93%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 718,523 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 629,461 mijë lekë, ose në masën 87.6 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Mirditë në fillim të vitit buxhetor duhet të planifikohen angazhime buxhetore realiste. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit:

Tabela nr.II.3.1. Buxheti përfundimtar Plan-Fakt;

000/lekë

Nr.	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi në %	Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar				
							Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga Sponsorizimet	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet
1	Paga600	333,416	291,675	87.48%	31,560	70.55%	129,607	122,914	-	7,594	-
2	Sigurime shoqërore 601	54,261	48,587	89.54%	-	-	27,298	20,541	-	748	-
3	Shp. Operat602	83,596	65,513	78.37%	18,953	73.80%	32,822	13,059	-	679	-
4	Subvencion 603	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
5	Transferta Korrente të brendshme 604	8,372	4,844	57.86%	-	-	-	-	-	4,844	-

6	Transferta per familje dhe individe 606	356,448	332,049	93.15%	60	5.31%	6,828	247	-	324,914	-
7	Investime 230-231	719,353	629,461	87.50%	1,271	21.86%	20,106	16,398	-	-	591,686
	Totali	1,555,446	1,372,129	88.21%	51,844	66%	216,661	173,159	-	338,779	591,686

Burimi : Bashkia Mirditë

Niveli i mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta;

Për vitin 2023: njësia vendore nuk planifikon të ardhura për mbulimin e shpenzimeve për ndihmën ekonomike dhe PAK në vlerën 332,049 mijë lekë (e cila zë 24% të buxhetit faktik vjetor), por vetëm administron këtë proces në lidhje me plotësimin e kriterëve nga përfituesit dhe hartimin e listave. Duke marrë parasysh këtë fakt, duke zbritur nga shpenzimet totale vlerën e ndihmës ekonomike dhe PAK, konstatohet se shpenzimet faktike totale për vitin 2023 janë në vlerën 742,668 mijë lekë Bazuar në këtë vlerë, mbulimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta të njësisë vendore për vitin 2023 (pa transfertat e pa kushtëzuara) ka vlerën 51,844 mije lekë, ose në masën 37.7 % të shpenzimeve totale të realizuara.

Të dhënat e mësipërme për vitin 2023, tregojnë për nivele të ulëta të mbulimit të shpenzimeve me të ardhurat e veta, të cilat kanë si shkak nivelin e ulët të mbledhjes së të ardhurave.

Planifikimi i të ardhurave nga burimet e veta për vitin 2023 ka vlerën 72,275 mijë lekë, ndërsa realizimi ka vlerën 63,452 mijë lekë, ose në masën 87.8%.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës, emergjencë;

Planifikimi dhe realizimin i fondit rezervë dhe të kontigjencës, bashkëlidhur dokumentacioni, relacion, VKB, urdhër-shpenzim.

Fondi rezervë dhe i kontigjences është planifikuar në vlerën 1,000,000 lekë dhe nuk është përdorur gjatë vitit 2023.

Tabela nr.II.3.2. përdorimi i fondit rezervë;

000/lekë

Emertimi	Vkb nr/datë	Objkti i shpenzimit	shuma
Planifikim fond rezerve	Nr.110/ dt.30.11.2022	Buxheti fillestare	3500
Realizimi sipas vkb			
1	Nr.96/dt.28.10.2022	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.E.Z	50
2	Nr.99/31.10.2020	Ndih.fin femijet jetim D	120
3	Nr.48/20.05.2020	Ndih.fin femijet jetim K	180
4	Nr.95/28.10.2022	Te moshuar mbi 100-vjeç	1500
5	Nr.6/08.02.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.J.P	30
6	Nr.7/08.02.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.A.P	30
7	Nr.28/31.03.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.S.S	30
8	Nr.29/31.03.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.A.M	30
9	Nr.34/31.03.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.K.P	30
10	Nr.35/31.03.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.Gj.Z	30
11	Nr.42/02.05.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.b.k	30
12	Nr.57/12.05.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.P.b	100
13	Nr.42/02.05.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.m.gj	30
14	Nr.42/02.05.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.s.s	30
15	Nr.42/02.05.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.p.h	30
16	Nr.42/02.05.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.p.r	30
17	Nr.42/02.05.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.m.b	30
18	Nr.29/03.11.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.J.L	30
19	Nr.32/03.11.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.A.P	30
20	Nr.34/03.11.2023	Ndih.finac kushte te vesht jetese z.N/L	15
21	Nr.31/03.11.2023	Pagese antare komisioni per pagese komisioni te posaçem	50
		Totali i realizimit	2435
trasheguar per 2024			1065

Burimi : Bashkia Mirditë.

Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.

Tabela nr.II.3.3. Planifikimi dhe realizimin i fondit të emergjencave civile, sipas VKB-ve;

000/lekë

Emertimi	Vkb nr/datë	Objkti i shpenzimit	shuma
Planifikim fond emergjenca civile	Nr.110/ dt.30.11.2022	Buxheti fillestare	2500

Realizimi sipas vkb			
	Nr.30/dt.31.03.2023	Bonus qeraje per z.Lekë Bunaj banesa e shmbur nga fatkeqesi natyrore	185
	Nr.42/24.11.2023	Blerje karburant per automjetet e APPM per nderhyre ne situatë emergjente	300
		Totali i realizimit	485
Gjendje e trasheguar per 2024			2015

Burimi : Bashkia Mirditë

Raportet e Monitorimit

Për vitin 2023, janë përgatitur tre raportet periodike 4-mujore të miratuara me VKB Nr.55 prot., datë 12.05.2023 “Për miratimin e Raportit periodik katërmujor i buxhetit të Bashkisë Mirditë për periudhën Janar - Prill 2023”, VKB Nr.17, datë 29.09.2024 “Për miratimin e Raportit periodik të buxhetit të Bashkisë Mirditë për periudhën Janar - Gusht 2022”, si dhe Raporti vjetor është miratuar me VKB nr.19 datë 26.02.2024 “Per raportin e konsoliduar të buxhetit 2023” Raportet e monitorimit përgjithësisht është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë paraqitur për diskutime edhe në Këshillin Bashkiak.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE) ku evidentohen detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve detyrimeve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)

Tabela nr.II.4. Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2023.

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur nga viti 2022 (në lekë)	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023 (në lekë)	Total detyrime (në lekë)	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2023 (në lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023 (në lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Investime nga Ministrinë e linjës	191,177	17,973,617	18,164,794	10,241,100	7,923,694
Investime nga Bashkia	317,114	17,855,480	18,172,594	0	18,172,594
Mallra dhe shërbime	1,493,035	2,449,373	3,942,408	2,632,813	1,309,595
Vendime gjyqësore	0	0	0	0	0
RINDERTIMI.	1,313,477	421,009,300	422,322,777	420,802,816	1,519,961
Totali	3,314,803	459,287,770	462,602,573	433,676,729	28,925,845

Burimi : Bashkia Mirditë.

Detyrime të prapambetura nga fondet e veta të Bashkisë (grand +transferte e pakushtezuar + të ardhurat e veta), fonde të FZHR-së dhe fonde të Rindertimit, paraqiten në tabelën nr.II.4.1 në aneks.

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (Nga të ardhurat e veta+transfertën e pakushtezuar), paraqiten në tabelën nr.II.4.2 në aneks.

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2023 për investimet (Nga transfertat të kushtëzuara, si investime nga Ministri të linjës, FSHZH) , paraqiten në tabelën nr.II.4.3 në aneks.

Analiza e vlerës së detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2023 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtë:

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e financës dhe e Buxhetit rezultoi se, Bashkia Mirditë ka detyrime të prapambetura në fillim të vitit të mbartur nga vitii 2022 shumë prej 3,314,803 lekë , ndërsa detyrim i krijuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 është në vlerën 459,287,770 lekë, dhe në total ka detyrime në vlerën 462,411,396 lekë. Përsa i përket shlyerjeve gjatë vitit ushtrimor janë shlyer detyrime në vlerën 433,676,729 lekë, dhe si rrjedhojë e situatës së krijuar si më lart kemi të bëjmë me një mbetje detyrimesh në fund të periudhës 31.12.2023 në vlerën 28,925,844 lekë. Detyrime të krijuara nga ministrinë e linjës janë në vlerën 7,732,517 lekë, detyrime të krijuara nga Bashkia Mirditë janë 18,172,594 lekë për investime, dhe 1,309,595

lekë për mallra dhe shërbime, për detyrimet me financim nga fondet e Rindërtimit, janë krijuar dhe akumuluar detyrime të papaguara në fund të vitit ushtrimor në vlerën 1,519,961 lekë. Përsa i përket detyrimeve të prapambetura që ka Bashkia Mirditë nga të ardhurat e veta, ku është e përfshirë shuma e detyrimeve të prapambetura, për fatura për të cilat janë të mbartura prej vitesh dhe nuk janë likuiduar për mangësi në dokumentacion, në shumën prej 1,309,595 lekë për mallra dhe shërbime, dhe vlera 317,114 lekë, dhe për investime, në shumën totale 1,626,709 lekë. Ndërsa shuma 17,855,480 lekë është paraqitur si detyrim i prapambetur për faturën nr. 173 prot ., datë 15.09.2023 për investimin ndërtim ujësjellësi Rubik , për të cilën ka qenë fondi i alokuar në buxhet, por për faktin se praktika për pagesë nuk ka patur të bashkangjitur akt/kolaudimin i objektit nuk është bërë i mundur kalimi i veprimit financiar, për këtë asye kjo faturë është regjistruar si detyrim i prapambetur për vitin 2023 i cili është pagaur në vitin 2024 me urdhër shpenzimit nr.803., datë 15.07.2024.

Nga Bashkia Mirditë është bërë kërkesë drejtuar degës së thesarit Mirditë nisur nga fakti se në sistemin e thesarit ka disa fatura të viteve të mëparshme si detyrime të prapambetura , por qe nuk kanë dokumenta justifikuese, duke i kërkuar stornimin nga debia e llogarisë 486 konkretisht për faturat si më poshtë:

Tabela nr.II.4.4. Fatura të viteve të mëparshme si detyrime të prapambetura.

Nr	Furnitori	Mallra/Sherbime	Datë fature	Shuma e faturës në lekë
1	M shpk	Lyerje Objektesh	06.10.2017	150,635
2	E-M 2010	Materiale Pastrimi	26.09.2017	97.560
3	M-Pt	Materiale Elektrike	10.04.2018	252.960
4	Gj B	Drru zjarri	20.02.2018	565.440
5	G Konstruksion	Mbikëqyrje rruga Kodër rrëshen	17.05.2018	33.557
6	B M	Kolaud. Pun , ujësjellës	18.12.2018	25.448
7	B M	Kolaud. Pun , lumi zmeja Madhe	18.12.2018	28.705
8	B M	kolaud, ndërt, ura fsh, jeztene,klos18.12.2018	18.12.2018	25.065
9	B M	Kolaud ndërt fusha sportit	18.12.2018	16.009
10	B M	Kolaud skema ujit bukmirë	18.12.2018	22.640
11	AEK	Emergjencia e borës	15.04.2019	243.000
12	K SHPK	Rikonst zyra Nja. Rubik	13.10.2020	100.382
13	P Konstruksion	Kolaud , punimesh, furnizim, energji, god Bashkisë	13.12.2020	65,218
	Totali			1,626,709

Burimi : Bashkia Mirditë.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara

Pagesat të kryera nëpërmjet Bankës në lidhje me respektimin e afatit 30-ditor për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 si vijon:

Tabela nr.II.4.5. Sasia e faturave te palikuiduara ne vlerën e plotë.

Nr.	Periudha	Nr. fature	Datë fature	Shuma	Nr. USH	Vlera	Diferenca
1	janar	31	22.04.2022	1,337,213	75	1,337,213	0
2	shkurt	105	14.11.2022	4,793,858	1045	4,793,858	0
3		83	08.11.2022	598,704			598,704
4		1264	02.12.2022	103,484			103,484
5		1265	02.12.2022	103,000			103,000
6	mars	11	27.12.2022	275,830	1264	275,830	0
7		128	28.12.2022	5,171,412	1046	5,171,412	0
8	prill			0			
9	maji	14	28.02.2023	6,779,014			6,779,014
10		22	28.02.2023	35,007,710	1246	22,447,684	
					413	12,560,026	0
11		27	01.03.2023	52,891,317	1247	52,891,317	0
12	qershor	30	31.03.2023	18,186,370	1248	18,186,370	0
13		31	31.03.2023	51,325,126	1249	51,325,126	0
14		4	20.04.2023	593,568	1250	593,568	0
15		40	25.04.2023	58,698,598	1251	58,698,598	0
16	korrik	47	02.05.2023	22,989,694	1252	22,989,694	0
17	gusht	30	01.06.2023	10,087,711	1253	10,087,711	0
18		31	01.06.2023	40,512,700	1254	40,512,700	0

19		04	13.06.2023	1,200,000	1255	1,200,000	0
20		39	19.06.2023	4,272,798	1256	4,272,798	0
21		64	19.06.2023	32,627,959	1257	32,627,959	0
22		63	19.06.2023	17,379,551	1258	17,379,551	0
23		31	23.06.2023	50,806,780	1259	50,806,780	0
24		67	23.06.2023	24,006,260	1260	24,006,260	0
25	shtator	10011	19.07.2023	692,400	862	692,400	0
26	tetor	29	01.08.2023	324,000	1000	324,000	0
27		1	14.08.2023	216,674	1261	216,674	0
28		62	10.08.2023	95,760	993	95,760	0
29	nentor	173	15.09.2023	17,855,480			17,855,480
30	dhjetor	70	22.09.2023	354,799			354,799
31		103	10.10.2023	47,954,016	1262	47,954,016	0
		TOTAL		507,241,486		481,447,005	25,794,481

Burimi: Bashkia Mirditë

Tabela nr.II.4.6. Faturat e palikujduara sipas llogarive

000/lekë

Nr.	Periudha	Llog.602		Llog.230+231		Shuma	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Viti 2023	4	2,444	27	504,797	31	507,241

Burimi : Bashkia Mirditë.

Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se në vitin 2023, në 31 raste nëpërmjet urdhër shpenzimeve, janë kryer pagesa të faturave me vlerë 507,241 mijë lekë, mbi afatin 30 ditor nga momenti i mbërritjes së faturës tatimore në Bashkinë Mirditë, për shpenzime mallra e shërbime e investime. Nga sa më sipër, për 4 raste në vlerën 2,444 mijë lekë i përkasin faturave për mallra e shërbime (llog. 602 “shpenzime operative”), dhe në 27 raste në vlerën 504,797 mijë lekë për investime (llog.231), të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”, me Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Vendime shpronësimesh.

Bashkia Mirditë për vitin 2023 nuk paraqet vendime shpronësimi, pasi nuk ka pasur dëmshpërblime të pronave private për interes publik.

Vështirësia Financiare e Bashkisë Mirditë.

Vlera e raportuar nga Bashkia Mirditë në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 është **19,482,189**, konfirmuar me shkresën nr. 897 prot., datë 29.02.2024 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore. Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

Tabela nr.II.4.7. detyrimet e prapambetura;

Nr.	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	-		
a	Hua sfatgjatë	-		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	-		

b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)			
a	Shpenzime korrente			
a,1	Mallra dhe shërbime	1,309,595		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	18,172,594		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private			
c	Vendime gjyqësore			
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	19,482,189	441,575,249	4.41 %

Burimi : Bashkia Mirditë.

Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimet totale të miratuara, ka vlerën 4.41 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Mirditë në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Tabela nr.II.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR;

000/lekë

Nr.	Objekti i investimit	Burimi Financimit	Op.Fitues	Dt. Lidhjes kontrates	Vl. Kont. Me tvsh (000 lekë)	Afati 1kontrates	Likuiduar 31.12.2023
1	Ndërtim ujesjelles Rubik faza I	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, AKUM, Shkresa nr 461 Prot dt 03.03.2023	C Shpk	15.07.2020	144,513	12..01.2023	29,000
2	Mbikqyrje punimesh Ndërtim ujesjelles Rubik faza I	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, AKUM, Shkresa nr 461 Prot dt 03.03.2023	I konsulences	07.07.2020	2,365	12.01.2023	300

Burimi : Bashkia Mirditë.

Sa i përket fondeve të alokuara nga MIE të deleguara për vitin 2023 për investime të cilat kanë filluar në vitin 2020, kanë vazhduar në vitin 2023 dhe sipas kontratës përfulnë në vitin 2023, rezulton se janë financuar 2 projekte investimi me vlerë kontrate 146,878 mijë lekë, nga të cilat është likuiduar vlera prej 29,300 mijë lekë.

2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe arkëtimi i detyrimeve. Evidentimi i detyrimeve tatimore të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Mirditë për miratimin e paketës fiskale të vitit 2023;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;

- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit;

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit (Drejtoria e të Ardhurave/DA):

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, DA në Bashkinë Mirditë është përcaktuar në Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë, me nr. 17 datë 10.01.2022 ku numri total i punonjësve është 380. Referuar këtij urdhri Drejtoria e të Ardhurave ka në përbërjen e saj 10 punonjës, 1 Drejtor Drejtorie, 3 Përgjegjës Sektori dhe 6 specialistë, të ndarë sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr. II.6: Struktura organizative e Drejtorisë së të Ardhurave sipas Urdhrit nr.17, datë 10.01.2022;

Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit	Struktura	Fakt
Drejtoria Drejtore	1	1
Spektori i Transportit/tregut	2	2
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	1	1
Spektori i Taksave dhe tarifave	5	5
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	4	4
Spektori i Borxhit tatimor	2	2
Përgjegjës Sektori	1	1
Specialistë	1	1
Punonjës gjithsej	10	10

Burimi: të dhëna nga Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023, DA ka funksionuar me strukturë të plotë, kjo në përputhje me strukturën organike, të miratuar me Urdhërin me nr.17 datë 10.01.2022.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve:

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mirditë është miratuar me VKB-në nr. 100, datë 30.11.2022 “Miratimin e paketës fiskale vendore, për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Mirditë me shkresën nr.896/1 Prot. datë.16.12.2022”.

Tabela nr.II.6.1:Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Mirditë, viti 2023.

lekë

	Gr.Art	Përshkrimi	Plan	Fakt	%
A		TAKSA	28,925,587	19,297,645	66.7
	7002200	Tatim i Thjeshtuar		13,335	
	7020100	Tatim Mbi Tokën Bujqësore	450,974	163,759	36.3
	7020200	Tatim Mbi Ndërtësat	6,955,478	2,687,896	38.6
	7020600	Taksë Mbi Truallin	1,990,990	1,156,716	58.1
	7029200	Taksa Për Kalimin E Pronësisë	-	-	
	7035013			2,250	
	7035007	Taksë për therje të bagëtive	-	22,000	
	7035003	Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet	3,000,000	1,730,233	57.7
	7035005	Taksë për fjetje në hotel	150,000	-	0.0
	7035008	Taksë e reklamës	550,000	945,000	171.8
	7035009	Taksa tabelës	981,000	403,785	41.2
	7109200	Qera mbi troje	14,847,145	12,172,670	82.0
B		TAKSA TË NDARA			

	7204101	Taksa e regjistrimit të mjeteve	8,000,000	12,775,728	159.7
	7204102	Të ardhura personale	5,000,000	9,004,893	180.1
		Taksa e Rentës Minerare	-	20,040	
C		TARIFA	22,377,834	11,161,541	49.9
	7110501	Pastrim	20,023,000	8,914,688	44.5
	7035023	Ndriçim	509,000	8,300	1.6
	7110505	Tarifë për repititor	458,000	449,079	98.1
	7035016	Autorizime karburanti	-	1,403,474	
	7110106	Dhënie leje transporti	1,387,834	386,000	27.8
D		TË TJERA	7,972,000	11,193,100	140.4
	7111002	Pagesat për çerdhet	2,286,000	1,395,210	61.0
	7111001	Pagesat për kopshtet	2,286,000	2,374,285	103.9
	7111003	Pagesat për konviktet	-	-	
	7111099	Të tjera të Ardhura sekondare	3,100,000	7,321,605	236.2
	7113011	Tarifa nga zjarrëfiksja MNZ	300,000	2,000	0.7
	7115119	Gjopa të tjera të sistemit tatimor	-	100,000	
		GJITHSEJ	72,275,421	63,452,947	87.8%

Burimi: Bashkia Mirditë.

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Mirditë paraqitet në masën 87.8%, nga 72,275,421 lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 63,452,947 lekë (8,822,474 lekë më pak), duke mos arritur objektivat e përcaktuara në planifikimin e vitit 2023.

Niveli i ulët i realizimit të të ardhurave mund të ndikojë në mosrealizimin e shpenzimeve të planifikuara me burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë dhe marrjen e angazhimeve buxhetore pa patur burime financimi reale.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- VKB-në nr. 100, datë 30.11.2022 “Miratimin e paketës fiskale vendore, për vitin 2023”;

Sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, kjo vjen për shkak të mos njohjes së situatës apo moskryerjes së rregullt të procedurave duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Një ndër to është taksa e qarkullimit të mjeteve të përdorura, ku planifikimi për vitin 2023 është 8 milion lekë ndërkohë që planifikimi për vitin 2022 ka qenë 10.5 milion lekë, edhe pse fakti për vitin 2022 ka qenë 12.4 milion lekë.

Për vitin 2023 realizimi i tarifave në total ka qenë 11,161,541 lekë në total ose 49.9% ku mosrealizimi kryesor është në tarifën e pastrimit, si rezultat i mos pagesës së tarifës nga popullata. Sa i përket taksës së fjetjes në hotel rezulton se planifikimi është bërë në vlerën 150,000 lekë dhe realizimi zero. Për këtë u kërkuar informacion dhe rezultojë se nga ana e DA nuk është marr asnjë masë kundrejt subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitet “Hotel”.

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme mbanë përgjegjësi znj.D N me detyrë drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave-Taksave, zj.M N në cilësinë e Përgjegjëse e Sektorit Taksave dhe Tarifave, inspektorët e taksave dhe tarifave z.V T dhe z.K M.

Të ardhurat nga hapësira publike:

Sipas Paketës Fiskale për vitin 2023, për ndjekjen, matjen dhe kontrollin e territorit, për sipërfaqet të cilat shfrytëzohen nga bizneset nuk ka asnjë strukturë të përcaktuar, por është ngarkuar vetëm

Drejtoria e të Ardhurave për vjeljen e tarifës. Për kategorinë e cila shfrytëzon hapësirën publike për qëllime biznesi është parashikuar sipas pikës nr.7 të Paketës Fiskale me vlerë prej 100 lekë/m2/muaj. Subjektet të cilët ushtrojnë aktivitet duke përfshirë edhe hapësira publike janë sipas tabelës nr. II.6.2, paraqitur në aneks.

Bazuar në të dhënat e tabelës, grupi i auditimit konstaton se vjelja e tarifës së hapësirës publike nuk është kryer për të gjithë subjektet duke krijuar **të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë në vlerën 104,880 lekë.**

Gjithashtu, nga auditimi konstatohet se vlera e përlllogaritur për vjeljen e tarifës nuk është në përputhje me përcaktimet e Paketës Fiskale, të miratuar për vitin 2023. Në Paketën Fiskale përcaktohet se tarifa do të jetë me 100 lekë/m2/muaj, ndërkohë që DA ka faturuar 100 lekë m2/vit, duke **krijuar të ardhura të munguara në vlerën prej 163,010 x 11 muaj = 1,793,110 lekë.**

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme mbanë përgjegjësi znj.D N me detyrë drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, z.M P ish zv.Kryetar i Bashkisë Mirditë, z. N D, ish Kryetar i Bashkisë Mirditë dhe z. A M, Kryetar i Bashkisë Mirditë.

Pajisja me autorizime të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Grupi i auditimit, auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për Bashkitë e tjera*”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Mirditë, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 15 subjekte, nga të cilët 10 subjekte ushtrojnë aktivitet me autorizimin përkatës si dhe 5 subjekte të cilëve u ka mbaruar autorizimi dhe nuk kanë rinovim të tij.

Ushtrimi i aktivitetit gjatë vitit 2023 të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse ka sjell të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë në vlerën prej 5,000,000 lekë. Gjithashtu sipas të dhënave të Bashkisë Mirditë konstatohet se 6 subjekte janë debitor në vlerën prej 3,650,000 lekë. Këto detyrime të cilat konsiderohen të ardhura të munguara, janë krijuar nga mos zbatimi i përcaktimeve ligjore të sipërcituara, pasi subjektet duhej të pajiseshin me autorizimin përkatës vetëm pas kryerjes së plotë të pagesës prej 1,000,000 lekë.

Tabela nr.II.6.3; subjektet që tregtojnë lëndë djegëse në BM, viti 2023.

Nr.	Subjekti	NIPT	Fillimi i autorizimit	Mbarimi i autorizimit	Likujduar	Debitor	Shënime
1	K	L	08.05.2020	08.05.2025	600,000	400,000	
2	L	K	18.09.2017	18.09.2022	350,000	650,000	Ska autorizim (mbyll)
3	K	J	05.05.2021	05.05.2025	1,000,000	0	ok
4	K	J	18.07.2020	18.07.2025	1,000,000	0	ok
5	K	L	19.09.2021	19.09.2026	1,000,000	0	ok
6	L T	K	05.10.2020	05.10.2025	1,000,000	0	ok
7	D	L	12.05.2020	12.05.2025	800,000	200,000	Transferuar NBT
8	K	K	12.11.2015	12.11.2020		0	Ska autorizim
9	X O	L	30.07.2020	30.07.2025	1,000,000	0	ok

10	NG	L		2015		1,000,000	QKB-Aktiv
11	EO	L	22.11.2018	22.11.2022		0	Ska autorizim
12	O	J	13.09.2022	13.09.2027	1,000,000	0	ok
13	NO	L	10.11.2022	10.11.2027	1,000,000	0	ok
14	DB	L	28.02.2023	28.02.2028	400,000	600,000	Trans. Aek Munellës
15	A	K	31.08.2018	31.08.2023	200,000	800,000	Ska autorizim

Burimi: Drejtoria e të ardhurave.

Ngarkohen me përgjegjësi për veprimet apo mos veprimet e mësipërme, z.T. P. ish përgjegjës i Sektorit të Transportit Licencimit dhe Tregut të Lirë, znj.D N në cilësinë e drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, z.M P ish zv.Kryetar i Bashkisë Mirditë, z.N D, ish Kryetar i Bashkisë Mirditë dhe z.A M, Kryetar i Bashkisë Mirditë.

Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Bashkia Mirditë në vitin 2022 ka patur në total 453 subjekte tregtarë, dhe gjatë vitit 2023 ka patur 436 subjekte ose 17 subjekte më pak, nga të cilët 330 janë biznes i vogël dhe 106 operojnë si Biznes i madh.

Tabela nr.II.6.4; Numri i bizneseve në Bashkinë Mirditë deri më datë 31.12.2023

Nr	Lloji Biznesit	Gjendja Në fillim	Regjistrime të reja gjatë vitit 2023	Mbyllur aktivitetin gjatë vitit 2023	Gjendja në fund të vitit 2023
1	Biznesi i vogël viti 2023	346	3	19	330
2	Biznesi i madh viti 2023	107	0	1	106
(1+2)	Gjithsej viti 2022	453	3	20	436

Burimi: Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit.

Nga dokumentacioni administruar, subjekti na ka paraqitur edhe shkresën me nr. 2077. Prot., datë 24.05.2024, e cila i është drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, ku specialistë të DA kanë konstatuar në total 98 subjekte të cilët ushtrojnë aktivitet pa u regjistruar në QKB sipas akteve ligjore në fuqi. Nga ana e DA këto subjekte janë ngarkuar me taksat dhe tarifat përkatëse, por nga ana e DRT Lezhë nuk ka patur asnjë reagim.

Taksat dhe tarifat familjare/biznesit:

Në Bashkinë Mirditë subjektet tregtarë ngarkohen me detyrime vendore për taksën e regjistrimit, mbi truallin, pasuri, pastrim, ndriçim, tarifën e gjelbërimit etj., në tabelën nr.II.6.5 ndodhur në aneks, paraqiten detyrimet e subjekteve, në mënyrë analitike, për vitin 2023.

Sipas të dhënave të subjektit rezulton se për vitin 2023 bizneset kanë krijuar një borxh prej 5,316,938 lekë detyrime dhe 520,000 lekë penalitete, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë.

Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se në lidhje me penalitetet Drejtoria e të Ardhurave nuk i ka aplikuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114 ku përcaktohet se: “Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”, si dhe jo në përputhje me Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2023, kreu VII, ku përcaktohet se mospagimi në afat i detyrimeve aplikohet penalteti me 0,06 % në ditë e shumës së detyrimit për 365 ditë, si dhe 5,000 lekë për biznesin e vogël dhe 10,000 lekë për biznesin e madh.

Sa më sipër, grupi i auditimit përlllogarit kamat vonesat dhe penalitetet për subjektet debitor(për biznesin e madh nga 5,000 lekë në 10,000 lekë sipas paketës fiskale) dhe rezultoi një diferencë prej 7,091,347 lekë (përlllogaritje nga grupi i auditimit) - 5,836,938 lekë(përlllogaritje nga Drejtoria e të ardhurave) = **1,254,409 lekë diferencë, e cila duhet të kontabilizohet në vijim.** Në

përfundim, bizneset kanë krijuar një borxh prej **7,091,347 lekë të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë.**

Tabela nr.II.6.6; Subjektet debitor për vitin 2023, përlogaritur nga grupi i KLSH-së; në lekë

Nr.	Kategoria	Detyrimet	Kamatëvonesa 0,06% sipas KLSH	Gjoha Sipas DA	Gjoha Sipas KLSH	Totali
A	Total Biznesi Vogël	2,097,189	459,284	430,000	430,000	2,986,473
B	Total Biznesi i Madh	3,219,749	705,125	90,000	180,000	4,104,874
	Total Diferenca		1,164,409		90,000	1,254,409
	Total Detyrime	5,316,938	1,164,409	520,000	610,000	7,091,347

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi auditimit.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. D N në cilësinë e Drejtore e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore, zj.M N në cilësinë e Përgjegjëse e Sektorit Taksave dhe Tarifave si dhe znj.E V në cilësinë e Përgjegjëse e Borxhit Tatimor.

Niveli dhe aplikimi i taksave dhe tarifave vendore:

Grupi i auditimit të KLSH-së, mori në shqyrtim disa biznese për nivelin e pagesës së taksave dhe tarifave, krahasuar me taksat dhe tarifën në paketën fiskale për vitin 2023. Nga kjo u konstatua se disa subjekte (për tarifën e pastrimit), nuk janë tarifuar sipas përcaktimeve të VKB-në nr.100, datë 30.11.2022 për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2023”. Subjektet të cilat janë konstatuar me tarifimet jo sipas paketës fiskale të miratuar ndodhen në tabelën më poshtë vijon:

Tabela nr.II.6.7:subjekte me përlogaritje të gabuar të nivelit të taksave lekë

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Nipti	Vendodhja	Tarifa Pastrimit Sipas Pf	Tarifa Pastrimit Aplikuar	Diferenca
1	A -Autogril-	Karburant	K	Fan	700,000	150,000	550,000
2	D Shpk	Karburant	L	Rubik	700,000	150,000	550,000
3	E Oil	Karburant	L	Rubik	700,000	150,000	550,000
4	K sh.a	Karburant	J	Reps	700,000	150,000	550,000
5	K Shpk	Karburant	L	Fan	700,000	150,000	550,000
6	D	Karburant	L	Rrëshen	700,000	150,000	550,000
7	K shpk	Karburant	J	Rrëshen	700,000	150,000	550,000
8	D Const	Inves ndërtim	M	Koder Spaç	300,000	200,000	100,000
9	C Energy	Kerk, zbul. Kromi	L	Selite	700,000	150,000	550,000
10	E-G	Prodhime të ndr	J	Rrëshen	60,000	30,000	30,000
11	Ar.Sh	Kembim valute	L	Rrëshen	50,000	10,000	40,000
12	B Shpk	Kembim valute	L	Rrëshen	50,000	10,000	40,000
13	M Union	Kembim valute	L	Rrëshen	50,000	10,000	40,000
14	N P	Kembim valute	K	Rrëshen	50,000	10,000	40,000
15	Ç P Shpk	Farmaci	K	Rrëshen	30,000	20,000	10,000
16	D L Shpk	Farmaci	K	Rubik	30,000	20,000	10,000
17	G Gj Shpk	Farmaci	K	Rrëshen	30,000	20,000	10,000
18	L D Shpk	Farmaci	K	Rrëshen	30,000	20,000	10,000
19	M L Shpk	Farmaci	K	Rubik	30,000	20,000	10,000
20		TOTALI			6,160,000	1,470,000	4,690,000

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi KLSH-së.

Sa më sipër konstatohet se,

- 7 subjekte me aktivitet tregtim i karburantit plus shërbime të tjera si servis, lavazh, hotel, bar-kafe, ushqim i shpejt etj., tarifohen sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.4 rendor i tabelës me vlerë 150,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikohesh sipas nr.23 rendor me vlerë 700,000 lekë.
- 1 subjekt me aktivitet investime më ndërtim, tarifohen sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.8 rendor i tabelës me vlerë 200,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikohesh sipas nr.17 rendor me vlerë 300,000 lekë.

- 1 subjekt me aktivitet kërkim, zbulim, shfrytëzim kromi, tarifohet sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.4 rendor i tabelës me vlerë 150,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikohesh sipas nr.9 rendor me vlerë 700,000 lekë.
- 1 subjekt me aktivitet investime më ndërtim, tarifohet sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.7 rendor i tabelës me vlerë 30,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikohesh sipas nr.2 rendor me vlerë 60,000 lekë.
- 4 subjekte me aktivitet këmbim valutor, tarifohen sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.2 “Tarifa pastrimit për biznesin e vogël”, nr.12 rendor i tabelës me vlerë 10,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikoheshin sipas pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.13 rendor me vlerë 50,000 lekë.
- 5 subjekte me aktivitet farmaci, tarifohen sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.15 rendor i tabelës me vlerë 20,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikoheshin sipas pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.14 rendor me vlerë 30,000 lekë.

Si konkluzion, nga mos tarifimi sipas përcaktimeve të paketës fiskale të miratuar për vitin 2023, janë krijuar **të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë, në vlerën prej 4,690,000 lekë.**

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. D N në cilësinë e Drejtore e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore, zj.M N në cilësinë e Përgjegjëse e Sektorit Taksave dhe Tarifave, inspektorët e taksave dhe tarifave z.V T dhe z.K M..

Taksat dhe tarifatat familjare:

Në Bashkinë Mirditë familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifën e gjelbërimit, tarifën e pastrimit dhe tarifën e ndriçimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Mirditë taksohen gjithsej 5036 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Në krahasim me vitin 2022 familjet që taksohen janë shtuar me 188 familje, pasi në vitin 2022 numri familjeve ka qenë 4848. Në tabelën në vijim paraqiten në mënyrë të përmblendhur detyrimet e familjeve për taksat dhe tarifatat vendore sipas njësive administrative, debitorët dhe pagesat e tyre;

Tabela nr.II.6.8: Familjet debitoare për taksat dhe tarifatat vendore në BM për vitin 2023

						Lekë	
Nr.	Nj.Adm	Nr. Familje	Ngarkesa fiskale	Nr. Fam paguar	Vlera e paguar	Nr. Fam debitoare	Vlera totale debitoare
1	Fanë	706	429,854	79	51,370	627	378,484
2	Kaçinar	177	162,083	35	34,094	142	127,989
3	Kthellë	430	616,631	21	20,632	409	595,999
4	Orosh	411	611,735	127	198,856	284	412,879
5	Rrëshen	2,116	6,501,560	560	1,271,823	1,556	5,229,737
6	Rubik	1,031	2,451,478	208	362,011	823	2,089,467
7	Selitë	165	149,878	3	1,264	162	148,614
8	Total	5036	10,923,219	1,033	1,940,050	4,003	8,983,169

Burimi: Bashkia Mirditë.

Sipas tabelës më sipër rezulton se vlera e borxhit e krijuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, nga familjarët rezulton të jetë në vlerën **8,983,169 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë.** Nga grupi i auditimit konstatohet gjithashtu se kjo vlerë, në lidhje me debitorët familjarë për periudhën objekt auditimi, **nuk është e kontabilizuar.**

Vlera debitoare e kategorisë “Familjar” për taksat dhe tarifatat vendore, në krahasim me vitin 2022 ka rritje në vlerë të konsiderueshme. Kjo pasi në vitin 2022 debitorët e krijuar për këtë periudhë kanë qenë në vlerën 5,304,404 lekë për 1978 familje ndërsa në vitin 2023 janë 8,983,169 lekë për 4,003 familje.

Si përfundim, rezulton se në fund të vitit 2023 janë 4003 familje debitore, për një ose disa taksa dhe tarifa vendore, ç'ka do të thotë se 79,5 % e familjeve që taksohen/tarifohen janë debitorë.

Dinamika e borxhit:

Nga auditimi konstatohet se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën 27,780,101 lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2023 është 5,836,936 pakësimet gjatë vitit 2023 janë 4,775,009 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2023 është në vlerën **28,842,028 lekë**.

- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë” të mbartura që nga viti 2010, që i përkasin 4 subjekteve në vlerën prej 14,838,512 lekë.

Nr.	Debitor më 31.12.2022	Lëvizja viti 2023		
	Vlera	Shtuar	Pakësuar	Gjendje 31.12.2023
1.	27,780,101	5,836,936	4,775,009	28,842,028

Të ardhurat nga asetet e dhëna me qira:

Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Mirditë u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e Bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave apo marrëveshjeve lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave apo marrëveshjeve.

Bashkia Mirditë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 40 kontrata/marrëveshje për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qera pyjore), nga të cilat për vitin 2023 është lidhur vetëm një e tillë me vlerë 15,400 lekë, me objekt kontrate “përdorim i tokës për kullotë”. Këto kontrata/marrëveshje janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes. Nga dokumentacioni vënë në dispozicion, janë gjithsej 10 subjekte debitor në vlerën 16,129,719 lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Mirditë, për marrjen me qira të sipërfaqeve të ndryshme, pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr.II.6.9:Debitorët e kontratave për asetet e dhëna me qera. në lekë

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Debitor 31.12.2022	Debitor 31.12.2023
1	Albt. sh.a	Antenë	140,120	
2	Albt. sh.a	Antenë	170,000	
3	Vod. sh.a	Antenë	60,300	
4	Tel. sh.a one	Antenë	247,500	
5	T N	Antene	85,000	
6	S f	Fabrikë uji	760,750	
7	E En.	HEC	247,675	
8	K shpk	HEC	811,992	811,990
9	Z-Xhuxhe	HEC	610,471	610,471
10	S I Hec	HEC	2,010,458	3,015,687
11	N G	kullote	15,420	
12	Ri L	Kullota	20,200	
13	M M	Kullota	21,250	
14	Gj N	Kullota		156,800
15	M M	Kullota		21,250
16	E M	Kullota		137,100
17	J M	Kullota		15,400
18	Sh Energji	HEC	10,569,197	6,569,197
19	P -Er	HEC	1,776,137	1,776,137
20	S 1 Hec	HEC	3,015,687	3,015,687
	Shuma totale		20,562,157	16,129,719

Burimi: Bashkia Mirditë.

Në lidhje me debitorët e vitit 2022, të cilët kanë kryer shlyerjen e detyrimeve gjatë vitit 2023 (në total 11 subjekte me vlerë 5,768,215 lekë), nga grupi i auditimit u konstatua se Bashkia Mirditë

nuk ka aplikuar penalitetet për mos pagimin e detyrimeve në afatet e përcaktuara sipas kontratave përkatëse. Nga të dhënat e kontratave konstatohet se mos pagimi në afat i detyrimeve penaliteti është 10% e detyrimit, çka do të thotë se për Bashkinë Mirditë për vitin 2023 janë krijuar **të ardhura të munguara** nga mos aplikimi i penaliteteve për kontratat e lidhura, **në vlerën prej 576,821 lekë, dhe 16,129,719 të ardhura të munguara nga mos mbledhja e detyrimeve të qerasë.**

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Mirdite kanë leje 9 subjekte private me aktivitet për nxjerrje, prodhim dhe shfrytëzim minerali dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Mirditë.

- Nga Bashkia është lidhur kontratë për qiradhënie të hapësirës për vend depozitimin e mineralit me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali “Bakër” vetëm me subjektin “T Alb T&M” shpk për sip.4.9 ha me tarifë qiraje në vlerën 3,082,000 lekë/vit.
- Për subjektin B B konstatohet se është hequr nga fondi pyjor dhe kullor sipas VKM nr.164, datë 01.03.2017.
- Për subjektet K Inerte dhe C&E nga ana e Bashkisë Mirditë janë marrë masa bllokimi të aktivitetit.
- Pesë subjekte të tjera, B R, V shpk, B 2013, B shpk dhe B 2013, rezultojnë aktiv në faqen AKBN por që nuk ushtrojnë aktivitet.

Përsa më sipër, lidhur me krijimin e të ardhurave të munguara, ngarkohen me përgjegjësi z.M P ish zv.Kryetar i Bashkisë Mirditë, zj. D N në cilësinë e Drejtore e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore, zj.M N në cilësinë e Përgjegjëse e Sektorit Taksave dhe Tarifave si dhe znj.E D me detyrë specialiste e menaxhimit të aseteve në Drejtorinë e të Ardhurave.

Masat e marra për uljen e borxhit:

Nga auditimi u konstatua se, dokumentacioni i vënë në dispozicion lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, DA ka njoftuar bizneset/familjarët debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifave vendore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se për vitin 2023 për debitorët, u është drejtuar bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare për 114 subjekte për vlerën 13,022,806 lekë, u është drejtuar QKB-së për 118 subjekte dhe ASHK-së për 116 subjekte.

Tabela nr.II.6.10; masat shtrënguese për debitorët;

	Shkresa		Masa Bllokim	
	Nr.	Datë	Nr.sub	Vlera
Njoftim dhe kërkesë	1503	18.04.2023	122	
Masa në QKB	1847	11.05.2023	118	
Urdhër bllokimi	1876	17.05.2023	114	13,022,806
ASHK/ZRPP/KSHA	2356	26.06.2023	116	
Sekuestro	-	-		

Burimi: Bashkia Mirditë.

Drejtorja e të Ardhurave, pas dërgimit të njoftimeve për pagesat e taksave vendore, për subjektet që vijnë të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, masat e marra nga ana e DA nuk duhen të ndalen por duhet të vijnë sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. D N në cilësinë e Drejtore e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe znj.E V në cilësinë e Përgjegjëse e Borxhit Tatimor.

Taksa e tokës bujqësore:

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, “Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën vetë deklaratimet e sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë Bashkisë ku ndodhet toka”, ku është e ndarë në 8 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit si më poshtë:

Tabela nr.II.6.11; Vlera e taksës së tokës bujqësore sipas ligjit, në lekë/hektar/vit;

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas ligjit (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	700

Burimi: Ligji 9632 datë 30.10.2006.

VKB-në nr.100, datë 30.11.2022 Për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2023”, kreu I, pika 2/2, taksa mbi tokën bujqësore, janë miratuar nën kategorizimet për taksën e tokës bujqësore sipas tabelës më poshtë vijon:

Tabela nr.II.6.12; Vlera e taksës së tokës bujqësore sipas VKB-së, në lekë/hektar/vit;

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas ligjit	Niveli i taksës sipas VKB
I	1,400	980
II	1,200	840
III	1,100	770
IV	1,000	700
V	900	630
VI	800	560
VII-X	700	490

Burimi: VKB për miratimin e paketës fiskale.

Referuar VKB-së përgjegjësinë për vjeljen e kësaj takse e ka Drejtoria e të Ardhurave.

Për vitin 2023 sipas evidencës Plan-Fakt, taksa mbi tokën bujqësore është realizuar në nivelin 36.3% (planifikuar 450,974 lekë dhe realizuar 163,759 lekë).

Në tabelën më poshtë paraqiten të ardhurat dhe detyrimet e familjeve të cilat janë objekt i pagesës së taksës së tokës bujqësore:

Tabela nr.II.6.13: Debitorët për tokën bujqësore sipas njësive administrative në lekë

Numri Rendor	Njësitë Administrative	Familje Aktualisht	Sipërfaqja Tokës Gjithsej (m²)	Taksa e Tok. Bujq. (Lekë)	Numri Familjeve që kanë paguar	Vlera e Taksës e paguar (lekë)	Numri Familjeve Debitore	Shuma Debitor e
01.	Fanë	686	1,070,780	52,468	40	7,894	646	44,574
02.	Kaçinar	127	166,164	8,142	28	3,038	99	5,104
03.	Kthellë	429	3,378,215	165,533	15	6,501	414	159,032
04.	Orosh	291	410,833	20,131	50	4,341	241	15,790
05.	Rreshën	487	3,273,860	160,419	149	45,760	338	114,659
06.	Rubik	742	807,362	39,561	58	6,719	684	32,842
07.	Selitë	130	236,766	11,602	0	0	130	11,602
	TOTALI	2,892	9,343,980	457,855	340	74,253	2,552	383,602

Burimi i të dhënave: Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit.

Sa më sipër konstatohet se nuk është bërë planifikim i saktë i taksës së tokës bujqësore. Nga tabela më sipër rezulton se sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve është 934.4 ha e ndarë sipas kategorisë VII-X. Për këtë sasi toke të ndarë, planifikimi i kësaj takse për një vit ushtrimor duhej të ishte në vlerën **457,855 lekë**, por në fakt nga DA, është planifikuar në vlerën prej **450,974 lekë**, duke mos parashikuar edhe arkëtime nga detyrime të mëparshme, kjo në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5, gërma (a): “Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme”, si dhe gërma (e): “Detyrimet tatimore të pa mbledhura në kohë, prej më shumë se 18 muaj nga afati i caktuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, nuk përfshihen në parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në projektbuxhetin për vitin buxhetor pasardhës. Përdorimi i të ardhurave shtesë nga mbledhja e detyrimeve tatimore të pa mbledhura në kohë i nënshtrohet procesit të rishikimit të buxhetit vjetor, sipas përcaktimeve të nenit 46 të këtij ligji”.

Nga DA nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave, për arsye se nuk janë parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve të mëparshme..

Gjithashtu evidentohen diferenca midis çmimit për kategori, sipas ligjit dhe sipas VKB për miratimin e paketës fiskale. Ky veprim rezulton në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23. Nëse merret në përlllogaritje çmimi sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara, parashikimi duhej të ishte 934,4 ha x 700 lekë/ha = 654,078 lekë dhe jo 457,855 lekë e parashikuar me 490 lekë/ha (sipas PF), duke krijuar një **diferencë prej 196,223 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë.**

Sa i përket debitorëve për token bujqësore, për vitin 2023, për 7 njësit administrative rezulton të jetë në **vlerën 383,602 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Mirditë.**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, pika 2/1 “Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e Aluizni-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

Në Bashkinë Mirditë struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit, e cila më pas përcjell informacionin për vjeljen e taksës, në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Duke u bazuar në të dhënat që disponon kjo drejtori në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se për vitin 2023 kanë qenë 85 subjekte, të cilët kanë konkluduar në pagesën e plotë prej 1,730,233 lekë duke mos krijuar të ardhura të munguara për vitin 2023.

Tabela nr.II.6.14: Lejet e legalizimit dhe vlera e taksës; në lekë

Periudha	Nr. i lejeve të legalizimit	Vlera e taksës (lekë) (0.5% e Vl. Inv.)
----------	-----------------------------	---

01.01-31.12.2023	85	1,730,233
------------------	----	-----------

Burimi: Bashkia Mirditë.

Për Bashkinë Mirditë, sipas të dhënave vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se të ardhurat e munguara për TNI vijon të jetë i pa ndryshueshëm në vlerën 1,972,156 lekë për 67 individ, të cilat i përkasin viteve të mëparshme.

3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Për auditimin e drejtimit nr. 3 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Pasqyrat financiare të vitit 2023 të shoqëruar me formatet 1-9.
- Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
- Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2023, libri i aktiveve.
- Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2023.
- Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Mirditë në mbyllje të vitit buxhetor 2023.
- Të tjera dokumente mbështetëse (data bazë të ndryshme ne programet “excel” si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, shpenzimet te ardhurat etj.).

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Mirditë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga Kontabilistja dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Mirditë për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr.prot.1293 datë 29.03.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtoresha e Menaxhimit Financiarë dhe Buxhetit.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditarit i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë.***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë Bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2023

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë regjistruar në momentin e celjes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivitet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura .

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit Financiarë dhe Buxhetit. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduar, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësishë:

Totali i Aktivit për vitin 2023 është në vlerën 123,730,507,851 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Tabela nr.III Formati nr.1 Aktiv i Bilancit 2023;

në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	A	A K T I V E T	123,730,507,851	123,639,818,423
2		I.Aktivët Afat shkurtër	290,870,145	296,564,176
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	189,608,351	161,032,045
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	189,608,351	161,032,045
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhënie		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	5,344,861	8,528,349
12	31	Materiale	5,344,861	8,528,349
13	32	Inventar I imet		
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmëri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	95,916,933	127,003,782
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	6,681,630	6,681,630
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shogerore		
28	436	Sigurime Shendetstore		
29	437,438,	Organizma te tjere shtetore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	35,490,340	34,407,543
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	53,744,963	85,914,609
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra		
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shpërndarë ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
42		II.Aktivët Afat gjatë	123,343,254,247	123,343,254,247
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	12,781,432	6,582,402
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	12,781,432	6,582,402
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	122,920,822,614	122,711,343,021
48	210	Toka, T,roje, Terene	9,962,953	9,962,953
49	211	Pyje, Plantacione	119,419,757,580	119,419,757,580
50	212	Ndertesa e Konstruksione	2,360,758,322	2,123,344,459
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,078,820,349	1,110,966,634
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	18,000,902	20,766,909
53	215	Mjete Transporti	690,503	840,719
54	216	Rezerva Shtetore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	19,823,444	25,703,767
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	13,008,561	
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	5,880	70,867,000
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	5,880	70,867,000
62		4.Investime	506,027,780	554,461,824

63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	506,027,780	554,461,824

Burimi: Bashkia Mirditë.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 189,608,351 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” të paraqitur më poshtë:

Tabela nr.III.1 Pasqyra e flukseve monetare;

Në lekë

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse 2023	Periudha Paraardhëse 2022
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	1	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	1,391,171,812	1,529,984,095
2	1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)		
3	2	Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor	728,336,879	796,932,555
4		Te hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)	21,087,119	39,352,886
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)		
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	42,365,828	24,528,129
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	2,048,999	
10		Te tjera, arketuar(+)		
11	3	Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente	662,834,933	733,051,540
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)	23,219,252	10,956,731
13		Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	637,566,682	720,200,319
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	2,048,999	1,894,490
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-)		
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	618,916,988	-1,202,812,861
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)		
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)	-52,525,421	-30,635,450
24		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-566,391,567	-1,172,177,411
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividente te paguar(-)		
28	III	TRANSFERTA E TE TJERA	5,321,791	3,021,240
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		
30		Transferime ne buxhet te Fondeve te perdorura(-)	5,321,791	3,021,240
31		Levizje e brendshme e transferata te tjera(+/-)		
32	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	777,576,615	330,192,474
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor		
34	VI	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	189,608,351	161,032,045

Burimi: Bashkia Mirditë.

-Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 189,608,351 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”.

-Gjendja e llogarisë 532 “Vlera të tjera” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë.

-Gjendja e letrave me vlere ne 31.12.2023 është 0 lekë .

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 8,528,349 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,344,861 lekë, ku diferenca e tyre në paksim në vlerën prej 3,183,488 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- **Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 8,528,349 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,344,861 lekë, me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 3,183,488 lekë, e cila përfaqëson pakësim të gjendjes së mallrave në fund të vitit 2023.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imet”** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 127,003,782 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 95,916,933 lekë, ku kemi pakësim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i pakësimit të furnitorëve në fund të vitit.

-**Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie,defiçite,gjoha”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2022 ka vlerën 6,681,630 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 6,681,630 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 34,407,543 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 35,490,340 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 1,082,797 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të taksave në vlerën 28,842,028 lekë, që zënë 81,3% të vlerës debitore. Pjesa tjetër janë detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit. Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësura në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.III.2 Gjendja e llogarisë 468“Debitorë të ndryshëm” me datë 31.12.2023;

Në lekë

NR	DEBITORET LLOGARIA 468	GJENDJA ME 01.01.2023	Shtesa për vitin 2023	Paksime për vitin 2023	GJENDJA ME 31.12.2023
	BASHKIA MIRDITË				0
1	A	4,000,000			4,000,000
2	DG	679,979			679,979
3	JKonstrukcion	9,419,533			9,419,533
4	K	739,000			739,000
5	Biznesi madh	5,694,982	2,097,188	3,478,885	4,313,285
6	Biznesi vogël	2,045,473	3,219,748	863,688	4,401,533
7	Asetet	5,201,134	1,946,250	2,378,686	4,768,698
8	Gjoha		520,000		520,000
9	Operatori ekonomik OE C	5,074,882			5,074,882
10	G K	152,500			152,500
11	G P	145,000			145,000
12	Gj A	15,000			15,000
13	B Gj	10,000			10,000
14	K C	15,000			15,000
15	Sh N	40,000			40,000
16	Z P	32,500			32,500
17	S D	32,500			32,500
18	D M	42,500			42,500
19	T N	40,000			40,000
20	G C	40,000			40,000
21	N T	5,000			5,000
22	V Gj	60,000			60,000
23	D D	17,500			17,500
24	P D	437,500			437,500
25	B P	10,000			10,000
26	N M	22,500			22,500
27	F D	10,120			10,120
28	E N	34,120			34,120
29	D V	10,120			10,120
30	B N	20,120			20,120
31	A P	10,120			10,120
32	A N	10,120			10,120
33	N M	21,120			21,120
34	D Gj	9,120			9,120
35	P M	26,120			26,120

36	M M	31,720			31,720
37	Debitore Kopesht	205,340	20870		226,240
38	Debitore çerdhe	46,920			46,920
	Totali	34,407,543	7,804,056	6,721,259	35,490,340

Burimi: Bashkia Mirditë.

-Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 53,744,963 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2023 që trashëgohen në vitin 2024 .Kjo gjendje në analizë përfshin gjëndjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 968,892 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 16,957,385 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 1,177,288 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 5,029,137 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 686,417 lekë.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, gjendje e cila përfaqëson detyrimet të prapambetura ndaj të tretëve.Sqarojmë se kjo llogari nuk del në pasqyrat financiare të Bashkisë të rakorduar me raportet e Thesarit pasi kjo llogari mbyllet me llog përkatëse 467.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale:

1. *Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale*, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. *Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:*

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse;

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet;

3. *Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:*

a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 123,343,254,247 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 123,439,637,706 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur shtesat gjatë vitit si dhe investimet në proces. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 124,206,877,087 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 124,564,035,973 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,582,402 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën prej 12,781,702 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,582,402 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 12,781,702 lekë. Kjo llogari ka ndryshime gjatë vitit 2023. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon.

Tabela nr.III.3 Inventari i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”

në lekë

NR	Emërtimi i aktiveve sipas Njësive Administrative	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa gjate vitit 2023	Pakesime gjate vitit 2023	Gjendja më 31.12.2023	Realizimi i Investimit
1	Hartim projekti ujësjellësi Rrëshen e reps	3,684,816			3,684,816	Investim I pa bere
2	Hartim projekti ujësjellësi fan.fang.rasfik.	2,897,856			2,897,856	Investim I pa bere
3	Hartim plan mbarështrimi pyjesh	0	6,199,030		6,199,030	Investim I pa bere
	TOTALI 2020	6,582,402	6,199,030		12,781,702	

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Referuar tabelës vlere prej 12,781,702 lekë i përket 2 projekteve, të cilët pritet të vihen në funksionim në vitet e mëvonshme, si dhe plani i mbarëshitimit të pyjeve. Këto projekte janë bërë hyrje dhe ruhen në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit Urban dhe magazinën e Institucionit.

3.3 Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimi i tyre në ASHK:

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “**Aktivet afatgjata materiale**” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 122,711,343,021 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në shumën totale prej 122,920,822,614 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 124,200,294,415 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 122,920,822,491 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 9,962,953 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 9,962,953 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 është në të njëjtën vlerë prej 9,962,953 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.III.4 Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me datë 31.12.2023

Në lekë

Nr	Emërtimi i aktiveve sipas Njësive Administrative	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa gjate vitit 2022	Gjendja më 31.12.2022
1	Toka terrene sportive fusha e futbollit	9,962,953		9,962,953
	BASHKIA MIRDITË TOTALI	9,962,953	0	9,962,953

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 119,419,757,580 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 119,419,757,580 lekë.

Konkluzion : Regjistrimi në kontabilitet për pyjet nuk është bërë duke u mbështetur në vkm nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferim në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në admistrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkive”, të pa regjistruara në ASHK.

Tabela nr.III.5 Emërtimii i aktiveve sipas Njësive Administrative

Në lekë

Nr	Emërtimi I aktiveve sipas Njësive Administrative	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa gjate vitit 2022	Gjendja më 31.12.2022
1	Pyje,kullota	119,419,757,580		119,419,757,580
	BASHKIA MIRDITË TOTALI	119,419,757,580	0	119,419,757,580

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 119,419,757,580 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2022 dhe në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 119,419,757,580 lekë.

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,123,344,459 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,360,758,322 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,506,661,463 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,822,506,443 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar aktive shtesë në vlerën 328,853,587 lekë, ku vlera prej 286,015,992 lekë nga rritja e AAGJM me pagesë si: rikonstruksione shkollash, pallatesh, objekte publike(me fondet e rindërtimit) etj. Dhe shtesë pa pagesë nga jashtë sistemit në vlerën 42,837,595 lekë, që përfaqëson kalimin kapital Bashkisë Mirditë kopshti Rubik financuar nga Bashkimi Evropian sipas shkresën Nr.5480/1 prot , datë 03.05.2023 dhe tonë Nr.1863 prot, datë 16.05.2023.Paksimet gjatë vitit janë në vlerën 13,008,561 lekë të cilat kanë kaluar në llogarinë 24 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara. *Këto veprime janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë.27.12.2011 “Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74, 85, me udhëzimin e MF nr. 8, datë.09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimi”, i ndryshuar, kreu II pika5, 36 dhe kreu III pika 30.*

- **Gjendja e Llogarisë 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,110,966,634 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në 1,078,820,349 lekë. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,114,487,217 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,132,594,546 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat në vlerën 22,594,266 lekë, që përfaqëson investime të kryera me pagesë brenda sistemit në kanale vaditëse, ujësjellës etj. Gjatë vitit 2023 pakësimet janë në vlerën 4,486,860 lekë, që i përket vlerës së investimeve tuba vija vaditëse.

- **Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 20,766,909 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 18,000,902 lekë, ku diferenca është amortizimi i perllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grup aktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 63,306,529 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 67,026,834 lekë, për të cilat ka inventar fizik. Në këtë grup aktivesh ka shtesa për vitin 2023 në shumën 5,789,094 lekë nga të cilat 966,330 lekë shtesa me pagesë për TVSH e pajisjeve të kopshtit Rubik dhe 4,822,764 shtesa

pa pagesë. Pakësime janë në vlerën prej 2,068,789 lekë, e cila përbëhet nga nxjerrjet jashtë përdorimit të këtyre aktiveve të vitit 2022 sipas proces – verbaleve mbi asgjësimin fizik të nxjerra jashtë përdorimit sipas urdhrit të kryetarit me Nr.3548 Prot. Dt.27.09.2023.

- **Gjendja e llogarisë 215** “Mjete Transporti” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 840,719 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 690,503 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 28,092,230 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 28,129,430 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 37,200 lekë që përfaqësojnë blerjen me pagesë likuidimin e faturës për diferencë të makinës multifunksionale të APPM për vlerën 37,200 lekë Aneks:

Tabela nr.III.6 Inventari kontabel i llogarisë 215 "Mjete transporti " më datë 31.12.2023

	BASHKIA MIRDITË llog.215	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa Viti 2023	Paksime Viti 2023	Gjendja me 31.12.2023
1	Autobuz	2,570,000			2,570,000
2	Benz Mercedes-250 autoveturë	960,000			960,000
3	Makine teknologjike për pastrim	8,741,600			8,741,600
4	Makina e prokurorisë	368,916			368,916
5	Automjet zjarrfikës Steyer	14,727			14,727
6	Automjet zjarrfikës Steyer vinç	14,727			14,727
7	Mitsubishi i mzsh	2,827,200			2,827,200
8	Fuoristrada pic up e pyjores	2,544,000			2,544,000
9	Automjet Benz	1,496,000			1,496,000
10	Ambulancë tip Volsvagen	1,489,000			1,489,000
11	Dyshek plus krevat	12,488			12,488
12	Gomë makine	41,800			41,800
13	Mjet transporti Land-Rover	1,495,000			1,495,000
14	Benz Mercedes	788,500			788,500
15	Foristrade nisan terana AA280EH	1,985,000			1,985,000
16	Foristrade	1,940,580	37,200		1,977,780
17	Automjet zjarrfikës Mercedes Bens	802,692			802,692
	TOTALI	28,092,230	37,200		28,129,430

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 25,703,767 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 19,823,444 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 58,026,443 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 58,267,924 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa në vlerën 522,337 lekë , nga të cilat me pagesë në vlerën prej 501,600 lekë ,e pajisjeve dhe transferimet kapitale nga institucionet e tjera qendrore në vlerën 20,737 lekë, për të cilat janë ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimn e tyre. Pakësimet janë në vlerën 280,856 lekë, që përfaqësojnë aktivet e inventarit ekonomik të nxjerrë jashtë përdorimit për llogari të vitit 2022, sipas procesverbaleve mbi asgjësimin fizik të nxjerra jashtë përdorimit me Nr.3965 Prot. Dt.23.10.2023

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2023 paraqiten në Formatin nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Tabela nr.III.7 Kosto historike

Nr. Referencë Llogar	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historik	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGI/O MATERIALE	6,582,672		6,582,672	6,199,030				12,781,702		12,781,702
202	Studime dhe kerkime	6,582,672		6,582,672	6,199,030				12,781,702		12,781,702
21-28	II. AAGI/ MATERIALE	124,200,294,415	1,488,951,394	122,711,343,021	370,805,045	141,480,386	19,845,066		124,551,254,271	1,630,431,780	122,920,822,491
210	Toka,troje,Terene	9,962,953	0	9,962,953	0		0		9,962,953	0	9,962,953

211	llota Plantacione	119,419,757,580	0	119,419,757,580	0		0		119,419,757,580	0	119,419,757,580
212	Ndertime e Konstruksione	2,506,661,463	383,317,004	2,123,344,459	328,853,587	78,431,163	13,008,561		2,822,506,443	461,748,167	2,360,758,276
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,114,487,217	1,003,520,583	1,110,966,634	22,594,266	50,253,691	4,486,860		2,132,594,546	1,053,774,274	1,078,820,272
214	Insta tekn,makin,pais,vegl pun	63,306,529	42,539,620	20,766,909	5,789,094	6,486,312	2,068,789		67,026,834	49,025,932	18,000,902
215	Mjete transporti	28,092,230	27,251,511	840,719	37,200	187,416			28,129,430	27,438,927	690,503
216	Rezerva shtetore	0		0	0		0		0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0		0	0		0		0	0	0
218	Inventar ekonomik	58,026,443	32,322,676	25,703,767	522,337	6,121,804	280,856	0	58,267,924	38,444,480	19,823,444
24	A. te Qend.te trupez te demtu			0	13,008,561				13,008,561	0	13,008,5610
28	Caktime			0	0		0		0	0	0
	TOTAL I (I+II)	124,206,877,087	1,488,951,394	122,717,925,693	377,004,075	141,480,386	19,845,066	0	124,564,035,973	1,630,431,780	122,933,604,193

124

Burimi: Bashkia Mirditë.

- **Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale** paraqitet në bilanc në vlerën 1,630,431,780 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36.

Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje te periudhes ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Mirditë

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2023 për Bashkinë Mirditë dhe Njësitë Administrative në varësi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2023 kanë dalë urdheri me nr,303 datës 26.09.2023 “Per ngritjen e komisioneve të inventarizimit për vitin 2023”. Janë mbajtur procesverbale nga çdo komision .Është mbajtur relacion shpjegues për gjendjen e llogarive”si dhe procesverbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve që kanë humbur funksionin e tyre. Të gjitha proceset e kryerjes së inventarëve për vitet 2023 janë me dokumentacion bashkëlidhur. Për vitin 2023 nuk janë nxjerrë aktive afatgjata jashtë përdorimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Mirditë dhe për Njësitë Administrative ne varësi. Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2023 dhe rezultojnë pa diferenca. Është hartuar relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, protokulluar me Nr.3535/1 dt.12.12.2023, ku përshkruhet mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit.

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2023 në vlerën 124,551,254,271 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktiv. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në fund të vitit 2023 në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 9,962,953 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 119,419,757,580 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën

2,822,506,443 lekë; 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 2,132,594,546 lekë; 214“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune “në vlerën 67,026,834 lekë. Në këto inventare janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Për vitin 2023 nga auditimi i procedurës së mbajtjes dhe kontabilizimit të aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore, por mungon kartela kontabël për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur, pra në formë analitike në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30.

Konkluzion: Gjendja e llog. 231“Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 506,027,780 lekë. Kjo shumë përfaqëson investimet që janë në proces të pa përfunduara si më poshtë:

Tabela nr.III.7: Punime.

Në lekë.

Llogaria	Emertimi Objekteve	Shuma në lekë
231	Mbikqyrje punimesh godina e spitalit Shenjta Mari, & D.SH.P. Rreshen	2,401,437
231	Ndertim Ujesjellesi Rubik shtese projekti	8,670,520
231	Rikonstruks godina e spitalit Shenjta Mari, & D.SH.P. Rreshen ish infektiv	386,952,332
231	Mbikqyrje punimesh ujesjellesi Rubik	300,000
231	Ndertim Ujesjellesi Rubik	107,703,491
	Shuma	506,027,780

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i Klsh-së.

Tabela nr.III.8 Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

Në lekë

Nr.Resht i	Referenca e Llogarive	Emërtimi	Ushtrimi I Mbyllur 2023	Ushtrimi Paraardhes 2022
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	199,811,783	201,336,245
66		I.Pasivet Afat shkurtra	199,811,783	201,336,245
67		1. Llogari te Pagushme	199,811,783	201,336,245
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	968,892	62,841,597
69	42	Detyrime ndaj personelit	16,957,385	16,488,015
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,177,288	1,182,133
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	5,029,137	4,751,025
76	436	Sigurime Shendetsore	686,417	651,839
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.etrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	103,894,850	74,332,463
82	467	Kreditore te ndryshem	28,925,844	
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	42,171,970	41,089,173
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		

93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	123,530,696,069	123,438,482,178
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	123,530,696,069	123,438,482,178
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	123,444,976,688	123,280,915,596
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	85,713,501	86,699,582
101	111	Rezerva		0
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		0
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne		0
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	0
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim	0	0
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata	0	0
107		Te Tjera	5,880	70,867,000
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	123,639,818,423	123,639,818,423

Burimi: Bashkia Mirditë.

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 199,811,783 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 62,841,597 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 968,892 lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje, duke paksuar faturat e palikujduara për mallra, shërbime dhe investime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Kjo llogari ka vlerën e borxhit të krijuar në nëntor-dhjetor të vitit 2023 në vlerën 968,892 lekë, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.III.9 Analiza e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to (mallra e shërbime)” Në lekë

Nr.	Emertimi	Pershkrimi	Nr	Datë	Vlera e pa likujduar
1	N	Ushqime	775	17.12.2023	9982
2	N	Ushqime	757	10.12.2023	78288
3	N	Ushqime	806	25.12.2023	34962
4	N	Ushqime	758	10.12.2023	26130
5	S.Trading	Blerje buke	1048	29.12.2023	18480
6	M.Catering	Blerje mishi	878	13.12.2023	28050
		TOTALI I LLOGARISË 401			195,892

Burimi: Bashkia Mirditë.

Tabela nr.III.10 Analiza e llogarisë 404 “Furnitorë e llogari të lidhura me to(për investime)”

Në lekë

Nr.	Subjekti	Pershkrimi I Kontrates	Numri fatures	Data	Gjendje 31.12.2022
1	R	Mbikqyrje punimesh ndërtim I ujësjellësit qyteti Rubik shtesë projekti	70	21.11.2023	773,000
		TOTALI I			773,000

Burimi: Bashkia Mirditë.

-**Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 16,957,385 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhën në Janar të vitit 2024.

-**Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 1,177,288 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimit mbi pagën per shumen 1,040,431 lekë dhe tatimin ne burim per shumën 136,857 lekë, që do të paguhën në janar të vitit 2024.

-**Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 5,029,137 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon:

a. Sigurimet shoqërore 9.5% punëmarrësi vlera 1,917,9626 lekë.

b. Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 3,028,344 lekë.

c. Sigurim suplementarë punëmarrësi me vlerë 82,831 lekë

-Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore” në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 686,417 lekë, e cila përbëhet nga:

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarrësi vlera 343,208 lekë.

b. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 343,209 lekë.

-Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 42,171,970 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarive kundërparti 423,429 “Personeli, paradhenie, deficite, gjoba me vlerën 6,681,630 lekë dhe llog.468 “Debitorë të ndryshëm” per shumen 35,490,340 lekë në aktiv të bilancit.

-Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 103,894,850 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Mirditë. . Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 48, datë.10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 5,6,7,9, dhe 10; ligji 10296, datë.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, udhëzimi nr.8, datë.09.03.2018 i ndryshuar me udhëzimin nr.5, datë.22.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave finciare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, seksioni “Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Tabela nr.III.11Tabela permbledhëse e 5% te palikujduar më 31.12.2023;

Në lekë

N r.	Emertimi i Investimit	Emri i Firmes	Gjendja me 31.12.2022	Paguar deri me 31.12.2023	Ngurtësuar 2023
1	Rikons Rruga Shen Vincenzo di Paoli	A L	914,035		
2	Rikonstruk rruga Gjergj Fishta 5	E SHPK	135,417		
3	Rikonstrukcion pallati kultures 2008	G SHPK	97,723		
4	Rehabilitim i ianalit Nderfushaz	B	188,084		
5	Rikonstrukcion rruga hyrese	K	283804		
6	Rikons rruga Bukmire-Simon-Kaçinare	A	148,599		
7	Rehabilitimi i rezervuarit Malaj 2 Faza 2-te	A M	7,484		
8	Rehabilitim kanali ujitës nderfushaz	B	88,725		
9	Rikonstrukcion rruga klos xhuxhaj margjecaj	J	74,811		
10	Rikonst rruga koder-rreshen Valce	G NDERTIM	73,501		
11	Rikonst i shkolles 9-vjeçare Pashko Vasa	U NDERTIM	1,438,214	1438214	
12	Mbrojtja lumore zmeja e madhe unaza Rreshen	A M	128,352		
13	Ndertim fushe sportive (Kalçeto) Reps	A M	69,585		
14	Riparim i urave te ndryshme	ALVORA	85,923		
17	Rehabilitimi i ujeleshuesit ,ujembledhesit Sheshaj	K	47,706		
20	Ndertim i ujesjellesit Rubik	CURRI	4,360,362		3,107,675
21	Rikonstrukcion i ambjenteve te perbashketa pallatet rr-r f.1	U NDERTIM	14,203,815		
22	Rikonstrukcion i ambjenteve arsimore	U NDERTIM	996,919		
23	Rikonstrukcion i objekteve publike qyteti Rreshen	A KONSTRUKSION	1,086,176		
24	TVSH Rehabilitim i kanalit vadites Malaj-Tarazh	L VII	919,001		
25	Rikonstrukcion i sistemit te ngrohjes shkolla 9-vjeçare Rubik	A	398,198		
26	Mirembajtje rrugeve te brendeshme te komunes Kaçinar	LIQENI VII	96,260		
27	Mirembajtje e rrugeve Komuna Fane	XHEKSON 04	44,760		
28	Ndertim lere uji (mulli) komuna Selite	K	29,280		
29	Ndertim ujesjellesi Lekgegaj Komuna Kthella	K	404,573		
30	Rikonstrukcion shpella e Valit, Komuna Kthelle	K	13,766		
31	Ndertim rrugeve te brendeshme,Komuna Selite	K	136,389		
32	Rikonstr i objekteve te perbashketa pallatet	U	3,711,317		
33	Rikonstrukcion qender shendetesore, Komuna Fane	K	49,309		
34	Montim çmontim ure, Komuna Fane	K	38,744		
35	Ndertim ure pasarele Xhuxhe-Gjakez, Komuna Fane	A-AL	26,880		
36	Ndertim rruge varrezat Perlat i eperm Komuna Kthelle	A-AL	17,516		
37	Plotesimi i rrjetit ujitës Malaj 2	A M	375855		
38	Plotesimi i rrjetit ujitës fshati K/Rreshen lagja Zalli Zmese	A M	75000		
39	Rikonstrukcion i ambjenteve te perbashketa pallatet rr-r f..2	U NDERTIM	13,938,690		4,187,608
40	Rikonstrukcion i ambjenteve te perbashketa pallatet rr-r f.3	U NDERTIM	1,358,646		8,012,104
41	Rikons ambjenteve te perbashketa pallatet Reps	LIQENI VII	9,199,569		
42	Rikonstrukcion i ambjenteve arsimore	U NDERTIM	3,896,054		
43	Prishje e pergatitjes shesh ndertimi per banesat individuale	L VII	1,058,071		
44	Rikonstrukcion i objekteve publike qyteti Rreshen	A KONSTRUKSION	4,072,525		
45	Ndertim godina kopesht/çerdhe zona e re per zhvillim	E KONSTRUKSION COMPANY	959,510		2,878,353
46	Rik.godina spitalit Shenjta Mari dhe DSHP ish spitali infektiv	E KONSTRUKSION COMPANY	7,817,159		11,530,458

47	TVSH Rehabilitim i kanalit vadites Malaj-Tarazh	L VII	1,193,636		
48	Rik.pusetave hyrese ujeleshuesi,ujembledhesi Geziq	A	52,620		
49	Zhbllokimi i pusetaive hyrese ujelesh, ujembledhsi Geziq	A	19,900		
50	Plotësimi i rrjetit ujitës fshati k/rrëshen lagja Zalli Zmesë	A M	0		195853
51	Rikonstrukcion i kanalit ujitës Dushaj-m= Ashtë fshati Malaj	K			120000
52	Ndërtim i ujësjiellësit Rubik shtesë projekti	A			433526
53	Mbrojtje nga përroi Jezull ne fshatin Jezull	A M			556,109
TOTALI BASHKIA + NJESITE ADMINISTRATIVE			74,332,463	1,438,214	31,021,686

Burimi: Bashkia Mirditë.

- Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të vonesave të krijuara në kryerjen e procedurave të prokurimit, në lidhjen e kontratave apo në mbërritjen me vonesë të faturave dhe si rezultat i bllokimit të transaksioneve financiare nga MFE në ditët e fundit të dhjetorit të vitit ushtrimor. Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 28,925,844 lekë vlere.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në Aneks.

Tabela nr.III.12 Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”

			Në lekë	
Nr. rresht	Nr. Llogari	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR 2023	VITI I M E P A R S H E M 2022
a	b	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	749,536,683	817,369,359
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	21,087,119	39,352,886
3	700	1.Tatimi mbi te Ardhurat	5,555,563	106,620
4	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
5	7001	Tatim mbi Fitimin		
6	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	177,094	106,620
7	7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat	5,378,469	
8	702	2.Tatimi mbi Pasurine	10,638,814	14,437,878
9	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	10,638,814	14,437,878
10	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		
11	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine		
12	703	3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit	4,892,742	24,808,388
16	7033	Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	1,789,474	19,523,515
17	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	3,103,268	5,284,873
18	704	4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare	0	0
24	708	6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare		
25	709	7.Gjoha e Kamat vonesa		
26	75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE		
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	42,365,828	24,528,129
35	710	1.Nga ndermarrjet dhe pronesia		4,593,830
38	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia		4,593,830
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	20565167	19,934,299
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	8,914,688	385,220
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	4,226,874	19,549,079
42	7112	Takse per veprime gjyqsore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve		
44	7114	Te ardhura nga biletat		
45	7115	Gjoha, kamatvonesa, sekustrime e zhdemtime		
46	7116	Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje	7,423,605	
47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	21,800,661	
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0
53	72	V.GRANTE KORENTE	682,900,248	753,975,617
54	720	1.Grant korent I Brendshem	682,900,248	753,975,617
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)		
56	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	629,155,285	668,061,008
59	7204	Pjesmarrije e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
61	7206	Financim I pritshe nga buxheti	53,744,963	85,914,609
62	7207	Sponsorizime te brendshme(nga te trete)		
63	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
64	721	2.Grant korent I Huaj	0	0

67		VI.TE ARDHURA TE TJERA	0	0
73	73	VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE	3,183,488	-487,273
74	B	SHPENZIMET	663,823,182	730,669,777
75	600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	233,578,823	207,279,911
76	6001	Paga, personel I perhershëm	233,578,823	207,279,911
77	6002	Paga personel I Perkohshëm		
78	6003	Shperblime		
79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	39,082,137	33,879,917
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shogerore	39,082,137	33,879,917
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore		
83	602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	51,111,048	93,820,110
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,444,793	2,032,800
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	5,736,697	7,055,202
87	6022	Sherbime nga te trete	30,238,277	60,939,136
88	6023	Shpenzime transporti	11,913,226	19,971,322
89	6024	Shpenzime udhetimi	984,975	1,377,115
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme		1,374,960
91	6026	Shpenzime per qeramarrje	24,000	
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		1,069,575
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
94	6029	Shpenzime te tjera operative	769,080	
95	603	IV.SUBVECIONE	0	0
101		V.TRANSFERIME KORENTE	336,867,686	396,177,112
102	604	1.Transferime korente te brendshme	4,843,528	6,482,804
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	4,843,528	6,482,804
107	605	2.Transferime korente me jashte		
112	606	3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe	332,024,158	389,694,308
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	332,024,158	389,694,308
115		VI.SHPENZIME FINANCIARE		
125		VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA		
130	63	VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT	3,183,488	-487,273
131		IX.SHPENZIME TE TJERA		
132	85	TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)	85,713,501	86,699,582

Burimi: Bashkia Mirditë.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 749,536,683 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Mirditë paraqitet më poshtë:

*Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 21,087,119 lekë, i cili kuadron me Aktrakordin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a.Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 177,094 lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël , e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

b.Gjendja e llogarisë analitike **7009 “ Të tjera Tatime mbi të ardhurat”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 5,378,469 lekë e cila përfshin tatime të tjera mbi të ardhurat, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e palujtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 14,437,878 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën, token bujqesore dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordin me thesarin.

d. Gjendja e llogarisë **7033 “Taksa mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 1,789,474 lekë e cila përfshin taksën mbi regjistrimin e përvitshëm te mjeteve.

d. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 3,103,268 lekë e cila përfshin taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja,takse hoteli,takse e tabelës reklame,takse e tabelës, zënire hapësire publike..

-Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 42,365,828 lekë, i cila kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a..Gjendja e llogarisë **711 “Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 20,565,167 lekë, e cila përfshin tarifat e pastrimit,ndriçimit,autorizime karburanti ,tarifa parkimit, kamatvonesa, tarifa transporti, licenca pagesa per çerdhe e kopeshte etj. Kjo vlerë rakordon me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **719 “Të tjera të ardhura jo tatimore ”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 21,800,661 lekë.

c. Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** është në vlerën prej 53,744,963 lekë.

*Analiza e shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 663,823,182 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 233,578,823 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 233,578,823 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 39,082,137 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 39,082,137 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 51,111,048 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 51,111,048 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime korente te brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,843,528 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 4,843,528 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime per Buxhetet familjare e Individe”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 332,024,158 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

Për vitin 2023 totali i te ardhurave në vlerë është 749,536,683 lekë dhe totali shpenzimeve është 663,823,182 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 85,713,501 rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”. Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit”** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën -3,183,488 lekë .

3.4. Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likujduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës”.

Liqishmëria dhe saktësia e e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë:

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga regjistruesi nëpunësi autorizues dhe zbatues si dhe nga nëpunësi i Thesarit me firmat elektronike.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

• Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës:

Konkluzion: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në 38 raste faturash me vlerë 50,3675,338 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Mirditë, ku 5 raste në vlerën 2,595,618 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 “shpenzime operative” dhe në 33 raste në vlerën 501,079,720 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 “investime”, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar për mungesë likuiditetesh pasi janë fonde të FZHR dhe të Rindërtimit, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 në të cilën përcaktohet se: “Nëpunësit zbatues të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.”, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”. Rastet më konkretisht paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr.III.13 Pagesat me vonesë për mallra e shërbime llog. 231

Në lekë

Nr	Urdher shpenzimi				Fatura			Shenime
	VITI 2023				Nr	datë	vlera	
	Ush	Datë	Vlera	Përshkrimi				
1	212	13.3.2023	4690402	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	18	31.03.2021	4690402	
2	213	13.3.2023	6581032	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	80	6.11.2021	6581032	
3	214	13.3.2023	9169099	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	90	9.12.2021	9169099	
4	215	13.3.2023	7841624	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	5	12.01.2022	7841624	
5	216	13.3.2023	300000	Mbikq Ndertim i ujesjellesit Rubik Inst.Kons.Ndert	25	20.9.2021	300000	
6	309	6.4.2023	37200	Blerje makine teknologjike Timac	4	21.9.2021	37200	
7	413	10.5.2023	12560026	Rikonst mjediset bashkepron pallat rreshen rubik F.2 Ulza	22	28.2.2023	12560026	
8	414	10.5.2023	717843	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	19	28.2.2022	717843	
9	1040	8.11.2023	4148369	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	29	28.2.2023	4148369	
10	1041	8.11.2023	2392154	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	41	6.5.2022	2392154	
11	1042	8.11.2023	9542197	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	63	7.7.2022	9542197	
12	1043	8.11.2023	1614725	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	75	8.8.2022	1614725	
13	1044	8.11.2023	5490776	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	81	9.9.2022	5490776	
14	1045	8.11.2023	4793858	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	105	14.11.2022	4793858	
15	1046	8.11.2023	5171412	Ndertim i ujesjellesit Rubik Curri	128	28.12.2022	5171412	
16	1246	15.12.2023	22447684	Rikonst mjediset bashkepron pallat rreshen rubik F.2 Ulza	22	28.2.2023	22447684	

Nr	Urdher shpenzimi				Fatura			Shenime
	VITI 2023							
	Ush	Datë	Vlera	Përshkrimi	Nr	datë	vlera	
17	1247	15.12.2023	52891317	Rikonst mjediset bashkepron pallat rreshen rubik F.3 U	27	28.2.2023	22447684	
18	1248	15.12.2023	18186370	Ndertim kopshi/çerdhe zona e re rindertimit E Konstruksion Company	30	31.3.2023	18186370	
19	1249	15.12.2023	51325126	Rikonstruksion spitali Rreshen & DSHP E Konstruksion Company	31	31.3.2023	51325126	
20	1250	15.12.2023	593568	Mbikqyrje Rikonstruksion spitali Rreshen & DSHP I -d	4	20.4.2023	593568	
21	1251	15.12.2023	58698598	Rikonst mjediset bashkepron pallat rreshen rubik F.3 U	40	25.4.2023	58698598	
22	1252	15.12.2023	22989694	Rikonst mjediset bashkepron pallat rreshen rubik F.2 U	47	2.5.2023	22989694	
23	1253	15.12.2023	10087711	Ndertim kopshi/çerdhe zona e re rindertimit E Konstruksion Company	55	1.6.2023	10087711	
24	1254	15.12.2023	40512700	Rikonstruksion spitali Rreshen & DSHP E Konstruksion Company	54	1.6.2023	40512700	
25	1255	15.12.2023	1200000	Mbikq Rikonst mjediset bashke pallat rreshen rubik F.3 P P	21	13.6.2023	1200000	
26	1256	15.12.2023	4272798	Mbikq Rikonst mjediset bashke pallat rreshen rubik F.2 EG	39	19.6.2023	4272798	
27	1257	15.12.2023	32627959	Rikonst mjediset bashkepron pallat rreshen rubik F.3 U	64	19.6.2023	32627959	
28	1258	15.12.2023	17379551	Rikonst mjediset bashkepron pallat rreshen rubik F.2 U	63	19.6.2023	17379551	
29	1259	15.12.2023	50806780	Rikonstruksion spitali Rreshen & DSHP E Konstruksion Company	66	23.6.2023	50806780	
30	1260	15.12.2023	24006260	Ndertim kopshi/çerdhe zona e re rindertimit E Konstruksion	67	23.6.2023	24006260	
31	1261	15.12.2023	216674	Kolaudim punimesh pallatet Reps Palma Konstruksion	1	14.1.2023	216674	
32	1262	15.12.2023	47954016	Rikonstruksion spitali Rreshen & DSHP E Konstruksion Company	103	10.10.2023	47954016	
33	1264	15.12.2023	275830	Mbikqyrje Rikonstruksion spitali Rreshen & DSHP I-d	11	27.12.2023	275830	
			501079720	Totali 231			501079720	

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i Kllsh-së.

Tabela nr.III.14: Pagesat me vonesë për investime llog 602

Në lekë.

Urdhër shpenzimi				Fatura			Subjekti
VITI 2022							
Ush	Datë	Vlera	Përshkrimi	Nr	datë	vlera	
75	25.01.2023	1337218	Energji elektrike	31	22.4.2022	1337213	Operatori sistemit shpërnarjes
430	17.5.2023	146240	Nafte	75	3.3.2022	146240	K
862	21.9.2023	692400	Kancelari	10011	19.7.2023	692400	I Office
993	20.10.2023	95760	Materiale per lyerje	62	10.8.2023	95760	E&M
1000	20.10.2023	324000	Uniforma per zjarrefikesit	29	1.8.2023	324000	E M
		2595618	Totali 602			2595618	

Burimi: Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i Kllsh-së.

4.1. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Mirditë, nga K.L.Sh-ja me shkresën nr. Prot. 521/19 prot. datë 19.12.2023, bërë hyrje në Bashkinë Mirditë me shkresën nr. 3386/24 datë 21.12.2023 për periudhën e auditimit 1.1.2022-31.12.2022, janë marrë një sërë masash dhe përgatitur programe me afate dhe persona për zbatimin e rekomandimeve, konkretisht: Në zbatim të nenit 15, shkronja j, të ligjit nr 154/2014, datë 27.01.2014' Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nga ana e Bashkisë Mirditë u hartuar Plan Veprimi mbi Zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Auditimit të KLSH-së. Plan Veprimi ka përfshirë të gjitha masat organizative, masat për shpërbllim dëmi, masat për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve, masat administrative dhe masat disiplinore të renditura sipas nivelit të riskut. Janë përcaktuar strukturat përgjegjëse që do merren me realizimin e rekomandimeve sipas afateve kohorë të përcaktuar referuar Urdhërit nr.470 datë 22/12/2023 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë -"Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar. Plan Veprimi u është dërguar Keshillit Bashkiak dhe 10 (dhjetë) strukturave përgjegjëse, Drejtori, Ndërmarrje, Inspektoriate e Sektorë që të bëjnë analize të punës së tyre me qëllim përmirësimin e punëve në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Një kopje e Plan Veprimit i është dërguar dhe KLSH-ja, me shkresën nr.112, datë 09.01.2024, **brenda 20 ditëve** nga marrja e Rekomandimeve.

Bazuar në nenin 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Po ju dërgojmë Zbatimin e Plan Veprimit dhe

Raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit 6 mujor** nga marrja njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së dhe Rekomandimeve me shkresën nr.112/1, datë 19.06.2024.

I. Në zbatim të rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Mirditë, nga K.L.Sh-ja me shkresën nr. prot. 521/19 prot. datë 19.12.2023, në mënyrë përmbledhëse realizimi është si më poshtë:

-Nga 16 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht të 16 masat në Plan Veprimin e Bashkisë Mirditë, dërguar dhe KLSH-ja, me shkresën nr 112, datë 09.01.2024.

-Nga 16 masa organizative janë zbatuar 7 masa, janë në proces 9 masa, janë pjesërisht të zbatuara 0 masa dhe nuk janë zbatuar 0 masa organizative.

-Nga 9 Masa me Dëm Ekonomik, janë pranuar plotësisht për zbatim ku 3 masa të pazbatuara, dhe 6 masa të zbatuara.

-Nga 6 Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

Janë pranuar të 6 masat të cilat janë në pjesërisht të zbatuara.

-Për masat disiplinore (16 masa gjithsej). Në Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së:

-Për masën disiplinore-vërejtje deri largim nga puna janë dhënë 10 masa për 10 punonjës me status NC nga të cilët 7 punonjës janë larguar nga puna dhe 3 aktualisht punonjës.

-Për masë disiplinore-vërejtje me paralajmërim- është dhënë 1 masë.

-Për masë disiplinore-vërejtje- janë dhënë gjithsej 4 masa disiplinore.

-Për punonjës të punësuar me kontratë individuale pune sipas K.P është dhënë 1 masë disiplinore-për largim nga puna-rekomandimi në proces zbatimi, për sa më sipër masa disiplinore është e zbatuar.

Më hollësisht zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së paraqitet si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione” paraqitet në vlerë historike në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,690,376,124 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,506,661,463 lekë. Për këto aktive nuk është kryer inventarizim fizik për të verifikuar nëse gjendja fizike përputhet me atë kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

1.1. Rekomandim: Strukturat Drejtuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë të marrin masa, që të kryhet procesi inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezultoi se është ngritur urdhri nr.303, datë 26.09.2023 “Për inventarizimin e pajisjeve dhe aktiveve, në institucionin e Bashkisë Mirditë”.

Statusi: Proces.

2. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk paraqet gjendje të saktë të detyrimeve të prapambetura që ka njësia vendore ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime e investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Kjo llogari ka vlerën zero lekë në pasqyrat financiare, por në fakt duhet të kishte vlerën 55,803,024 lekë, vlerë e cila

është paraqitur në llogarinë 401-408 “furnitorë e llogari të lidhura me to” dhe përfaqëson përfaqëson 32 fatura të prapambetura. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kreu 3.1 pika 42, Aneksi nr.1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Kap 3.3 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)pika (b,d). (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë të marrin masa, që faturat e prapambetura që paguhën në periudha të ardhshme të kontabilizohen në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ndërsa faturat e fund vitit ushtrimor që paguhën në janar-shkurt të vitit pasardhës për llogari të vitit ushtrimor të kontabilizohen në llog. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, për pasqyrat financiare në mbyllje të vitit ushtrimor 2023, rezultoi se kjo llogari është sistemuar.

Statusi: Zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se në vitin 2022, në 41 raste nëpërmjet urdhër shpenzimeve, janë kryer pagesa të faturave me vlerë 41,896,055 lekë, mbi afatin 30 ditor nga momenti i mbritjes së faturës tatimore në Bashkinë Mirditë, për shpenzime mallra e shërbime e investime. Nga sa më sipër, 34 raste në vlerën 10,956,731,lekë i përkasin faturave për mallra e shërbime l(log. 602 “shpenzime operative”), 7 raste në vlerën 36,012,981,lekë për investime (llog.231), të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”.

3.1. Rekomandim: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga data e faturës së operatorit ekonomik, me qëllim eliminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezultoi se ne krashasim me vitin 2022, gjatë vitit ushtrimor 2023, drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave ka marrë masa për zbutjen e këtij efekti.

Statusi: Proces.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2018-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 11 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, neni 1, 2, 20, si dhe neni 26, pika 5 të VKM-së nr. 914, datë 24.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mirditë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, urdhri nr 480 datë 28.12.2024 rezulton se rekomandimi është zbatuar për procedurat e prokurimeve të zhvilluara pas dhënies së rekomandimit.

Statusi: Zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2018-31.12.202, u konstatua se në 9 raste, në vlerën totale të kontratave prej 544,136,534 lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronjat a), b), d) dhe dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronjat (a), b) dhe c), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1 dhe neni 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3 dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”, me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Mirditë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se rekomandimi është zbatuar për procedurat e prokurimeve të zhvilluara pas dhënies së rekomandimit.

Statusi: Zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit me “vlerë e vogël”, u konstatua se në të gjitha rastet e blerjeve mall, shërbime e punë publike, me operatorin ekonomik të shpallur fitues, është lidhur kontrata e shërbimit dhe blerjes me afate dhe kushte të realizimit ndërsa për procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është ngritur komision nga titullari në përputhshmëri me kërkesat ligjore. Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar. Në kundërshtim me Pikën 42, 43, 52, 53, 54 të UMF 30 datë 27.11.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

6.1 Rekomandim: Titullari i njësisë vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevojë, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, Urdhri nr 84 datë 29.02.2024, Urdhri nr 91 datë 11.03.2024, Urdhri nr 195 datë 17.05.2024, Urdhri nr 134 datë 16.04.2024, Urdhri nr 226 datë 04.06.2024, urdhrin nr 296 datë 27.06.2024, Urdhrin nr 326 datë 10.07.2024, Urdhrin nr 346 datë 24.07.2024, Urdhrin nr 367 datë 07.08.2024, Urdhrin nr 393 datë 30.08.2024, 418 datë 13.09.2024, në çdo prokurim me vlerë të vogël të realizuar nga Bashkia Mirditë, janë ngritur komisionet përkatëse për monitorimin dhe zbatimin e kontratës.

Statusi: Zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Mirditë u konstatua se, formimi arsimor i një inspektori nuk është konform kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Konkretnisht nga të dhënat e marra nga drejtoria e burimeve njerëzore, është konstatuar se z. G. Ll. është diplomuar në Universitetin e Tiranës si Specialist i Gjeografisë dhe është emëruar se inspektori i IMT, veprim në kundërshtim me kërkesën e Nenit 11 të ligjit 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 11 ku përcaktohet se “Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të ndryshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidro-gjeologjisë dhe mjedisit”.

7.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mirditë, të marrë masa që plotësimi i pozicioneve të punës për inspektorët e IMTV-së, sipas kërkesave të përcaktuara në ligj, lidhur me arsimin përkatës.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton zbatuar sipas shkresës nr. 2194/1 prot datë 04.06.2024.

Statusi: Zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Mirditë u konstatua mos përmbushje e detyrave funksionale nga Kryeinspektori i IMTV.

Puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor dhe nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 m², të cilat kanë shtrirë dhe mund të vijnë aktivitetin e ndërtim në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare, të ndaluara ose të mbrojtura. Gjatë auditimit është konstatuar se: Nga verifikimi i ndryshimeve në zonë, marrë nga pamjet satelitore, janë identifikuar ndërtime pa leje në zonën Katund i Vjetër, pjesë e Njesisë Administrative Rubik, Bashkia Mirditë, Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant);

Në zonën Fshati Fang, njësia administrative Rubik, objekti ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022 dhe i përket kategorisë Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant) që i përket subjektit Xh O; në zonën Fang, Njësia Administrative Rubik, objekti i identifikuar si Kioskë Metalike me xhama që shërben si Lokal (Bar-Kafe), i gjendur anës rrugës së kombit, pranë ish uzinës ALB-Bakër.

Nga Kryeinspektori i IMVT pranë Bashkisë Mirditë nuk janë marrë masat në kohë për parandalimin e këtyre ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme. Nuk ka proces verbale konstatimi apo ndonjë masë tjetër administrative për këto raste.

Mos mbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasoja jo vetëm në mbrojtjen e territorit por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksat e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja. Bazuar në Ligjin 107/2014 Neni 52/e Kundërvajtjet administrative kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera, por këto kërkesa ligjore nuk janë zbatuar nga K/inspektori i IMT.

8.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mirditë të marrë masa që IMTV të ketë bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, kryepjeq apo dhe çdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare, pyje, lumenj apo zona të mbrojtura, si dhe të marrë masa për parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe monitorimin e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se janë nxjerrë Urdhra dhe njoftime për kontrollin e paligjshmërisë së ndërtimeve të paligjshme në territorin e Bashkisë Mirditë. Kjo provohet me Urdhër nr. 82 datë 28.02.2024, aktet administrative nr. 488 Prot datë 08.02.2024 drejtuar subjektit “A Xh” Fang Rubik, Aktin administrativ nr. 470 Prot datë 26.02.2024 për subjektin P Gj, me shkresën nr. 505 prot datë 25.03.2024 drejtuar Inspektoriatit Kombëtar. Aktet administrative ndaj subjekteve K Inerte me nr. 547 Prot datë 15.01.2024, aktet administrative ndaj “L I” me nr. 484 prot datë 18.03.2024, aktet administrative ndaj subjektit “E C C” shpk. Është mbajtur procedura në subjektin e ndërtimit K G shpk, është mbajtur akt kontrolli tematik në objekt për kushtet teknike të zbatimit (KTZ), referuar njoftimit me nr.537prot, datë 06.08.2024, rezulton se ky rekomandim është në proces zbatimi.

Statusi: Proces.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zhvillimit i zbatimit të kontratave për punë publike me objekte: “Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë” fituar nga shoqëria “LVII” SHPK me kontratë me nr. 760 prot., datë 06.05.2021 dhe me vlerë 42,261,108 lekë; “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “N N. Gjoka”, Fan Mirditë” fituar nga shoqëria “K” SHPK me kontratë me nr. 3072 prot., datë 29.07.2019 dhe me vlerë 69,805,421 lekë; “Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen” Bashkia Mirditë” fituar nga shoqëria “U” SHPK me kontratë me nr. 3974 prot., datë 13.10.2021 dhe me vlerë 97,860,882 lekë; “Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen” Bashkia Mirditë fituar nga “A K” SHPK & “G C” SHPK me kontratë me nr. 39746 prot., datë 13.10.2021 dhe me vlerë 103,177,350 lekë; “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)” Bashkia Mirditë, fituar nga shoqëria “U” SHA me ofertë 187,417,132 lekë me TVSH, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mirditë nuk është kryer Oponenca Teknike, veprim në mospërputhje me Ligjin Nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 6.

9.1. Rekomandimi: Bashkia Mirditë të marrë masa që të pajisin me Oponencë Teknike për çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, oponenca teknike me nr. 730/2 datë 28.05.2024, oponenca teknike me nr 868/2 datë 21.08.2024, oponenca teknike me nr. 1066/2 datë 25.09.2024, Oponenca teknike me nr 1253/2 datë 08.10.2024, oponenca teknike me nr. 871/2 datë 26.09.2024, rezulton se ky rekomandim është zbatuar.

Statusi: Zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Në 3 (tre) raste nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratave për punë publike, u konstatua se kolaudimi i punimeve është bërë me vonesë dhe konkretisht:

a) Për kontratën me objekt “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan Mirditë”, Mirditë”, Bashkia Mirditë”, me vlerë 69,805,421 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “K” SHPK, për kolaudimin e punimeve, është lidhur kontrata me nr. 2567 prot., datë 14.08.2020 ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “A” SHPK. Kolaudimi i objektit është bërë me datë 18.08.2020, ndërkohë që punimet e kontratës kanë përfunduar me datë 24.01.2020, rreth 7 (shtatë) muaj me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12.

b) Për kontratën me objekt “*Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)*”, Bashkia Mirditë”, me vlerë 187,417,132 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “U” SHPK, për kolaudimin e punimeve, është lidhur kontrata me nr. 2228/4 prot., datë 23.06.2023 ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “N S” SHPK. Kolaudimi i objektit është bërë me datë 23.06.2023, ndërkohë që punimet e kontratës kanë përfunduar me datë 30.02.2022, rreth 16 muaj me vonesë në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 dhe, ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë.

10.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mirditë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia me nr.2914/1 datë 04.06.2024, rezulton se ky rekomandim është në proces zbatimi.

Statusi: Proces.

11. Gjetje nga auditimi: Në 2 (dy) raste nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratave për punë publike, u konstatua se mungonte kontrata e kolaudimit të punimeve në objektet si më poshtë:

a) Për kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018, me objekt “Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit “Arjana Arapi” Rrëshen”, Bashkia Mirditë, ku kolaudator i objektit rezulton të jetë OE “G K” SHPK.

b) Për kontratën me nr. 3196 prot., datë 06.08.2019, me objekt “*Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2, Faza III*” Rrëshen”, Bashkia Mirditë, ku kolaudator i objektit rezulton të jetë ing. B M PF.

Në dosjet teknike të këtyre dy objekteve administrohet akti i kolaudimit i objektit por nuk vërtetohet të jetë lidhur kontratë për këtë shërbim. Sa sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë.

11.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Mirditë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, me qëllim formalizimin zyrtar të këtij shërbimi dhe funksionimin e tij bazuar në një kontratë dy palëshe.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, urdhri nr. 529 datë 20.11.2024 (për fillimin e procedurës së kolaudimit), urdhri nr. 530 datë 20.11.2024 (për fillimin e procedurave të kolaudimit), urdhri nr. 531 datë 20.11.2024 (për fillimin e procedurave të kolaudimit) rezulton se ky rekomandim është zbatuar.

Statusi: Zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane ndërtesë-kufi pronë, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh,

intensiteti i ndërtimit dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit. Anomalitë e mësipërme janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Ndërtim restorant dhe hotel*", me zhvillues "A K" ShPK;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Ndërtim godinë banimi 2 kat*", me subjekt zhvillues z. N N;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 100, nr. 4459 prot; datë 09.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Bujtina Gjin Lleshi, rikonstruksion + shtesë 2 kt + p/fingo*", me subjekt zhvillues z. V Gj Ll;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin "*Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues*", me subjekt zhvillues "Z-F" ShPK;

Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, më konkretisht me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar, Neni 35; Neni 38, pika 1; Ligjin 107/2014, "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Neni 38, pika 1; Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë, e ndryshuar, pasaportat e njësive strukturore MR_B_BA1_498/1, MR_UB_A2_343/2, MR_B_BA1_893/2.

12.1. Rekomandim: Nga DPKZHT, Bashkia Mirditë, të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është në proces zbatimi.

Statusi: Proces.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në gjashtë raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, siç janë mangësi në dokumentin e rilevimit topografik, projekti arkitektonik nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e domosdoshme, mangësi në deklaratat, policat dhe licencat e projektuesit, mangësi në projektin ndërtimor, kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhurnuara gjatë 3 muajve të fundit, mungon prokura ose autorizimi nga ana e zhvilluesit për aplikantin, nuk është evidentuar gjendja faktike ekzistuese e objektit tek i cili do të do të kryhet rikonstruksioni dhe shtimi i volumeve, jo i gjithë dokumentacioni i ngarkuar është i nënshkruar elektronikisht, si dhe në një rast, relacioni i projektit konstruktiv është nënshkruar nga drejtoresha e DPKZHT etj. Anomalitë e mësipërme janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Ndërtim restorant dhe hotel*", me zhvillues "A K" ShPK;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 96, nr. 3581/6 prot; datë 29.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Kompleks shërbimesh në funksion të agroturizmit*", me subjekt zhvillues "R – M" ShPK;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Ndërtim godinë banimi 2 kat*", me subjekt zhvillues z. N N;

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 100, nr. 4459 prot; datë 09.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Bujtina Gjini Lleshi, rikonstrukcion + shtesë 2 kt + p/fingo"*, me subjekt zhvillues z. V Gj Ll;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues"*, me subjekt zhvillues "Z-F" ShPK;
- Certifikatë përdorimi miratuar me vendim rr. 6, nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë për objektin *"Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të"*, me subjekt zhvillues z. K M.

Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, më konkretisht me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"*, i ndryshuar, Neni 10, pika 1, nënpika b), ç); Neni 14, pika 1; Neni 15, pika 1, nënpika c), ç), dh), e), ë), g), pika 1/1, nënpika i), iii), iv); Neni 26, pika 5; Neni 27/1, pika 1, nënpika ë); Neni 27/2, pika 1, nënpika ë), g), gj); VKM-në nr. 457, datë 29.06.2022, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.05.2015..."*, Neni 13, Neni 18, Neni 21; Ligjin nr.111/2018 *"Për kadastrën"*, Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6; Ligjin 107/2014, *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, Neni 13, pika 1; Neni 29; Rregulloren e Brendshme e Bashkisë Mirditë, nr. 4600 prot; datë 27.10.2022, Neni 27, pika 1, nënpika a); Neni 3.1, pika k); Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, *"Për nënshkrimin elektronik"*, i ndryshuar, Neni 9; Ligjin nr. 10 273, datë 29.04.2010, *"Për dokumentin elektronik"*, i ndryshuar, Neni 6.

13.1. Rekomandim: Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacione e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi ose përdorimi me mangësi si, policat dhe deklaratat e përgjegjësive profesionale, licencat profesionale, projektet teknike që përbëjnë projektin ndërtimor, plani i rilevimit, projekti arkitektonik në formatin DWG, plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese, kartelat e pasurisë së paluajtëshme të rifreskuara përgjatë tre muajve të fundit etj. DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të marri masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, si dhe vlefshmërinë sipas afateve për ato dokumenta që kanë përcaktime ligjore mbi vlefshmërinë.

- Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa të kërkojnë në çdo rast vërtetimin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për subjektet që kanë hartuar projektet ndërtimore, si dhe vërtetimet mbi statusin e subjekteve, sipas kuadrit ligjor në fuqi, për të marrë sigurinë e nevojshme se këto subjekte kanë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit.

- Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa për të kontrolluar nënshkrimin elektronik në të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e-lejet, të vërtetojë nëse këto dokumenta janë nënshkruar ose jo elektronikisht, nëse ky nënshkrim është kryer sipas përcaktimeve ligjore dhe nëse është kryer nga personat përgjegjës për hartimin e këtyre dokumentave.

- Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa, që për të gjitha aplikimet për ndërhyrje në objekte ekzistuese, si shtesa anësore ose në lartësi, të kryejnë verifikime në terren për ekvidentimin e gjendjes ekzistuese të objektet, si dhe të kërkojnë evidentimin e gjendjes ekzistuese të objektit në të gjitha projektet teknike që në tërësi përbëjnë projektin ndërtimor.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është në proces zbatimi.

Statusi: Proces.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste të audituara, nuk është kërkuar dhe/ose respektuar mendimi i autoriteteve të tjera publike, që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, për lejet si më poshtë:

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Ndërtim restorant dhe hotel*", me zhvillues "A K" ShPK.

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 96, nr. 3581/6 prot; datë 29.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Kompleks shërbimesh në funksion të agroturizmit*", me subjekt zhvillues "R P – M" ShPK.

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti "*Ndërtim godinë banimi 2 kat*", me subjekt zhvillues z. N N.

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin "*Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues*", me subjekt zhvillues "Z-F" ShPK.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, "*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*", i ndryshuar, Neni 10/1 "*Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi*", pika 6; Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Mirditë, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 2, datë 20.06.2018 (e rishikuar me Vendim nr. 9, datë 14.10.2020), dokumenti i rishikimit, pika 2, nënpika c); Ligjin nr. 111/2012, "*Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore*", i ndryshuar, Neni 33; VKM-në nr. 550, datë 15.07.2020, "*Për miratimin e formularëve për miratimin, në parim, për dhënien me koncension...*", pika III.

14.1. Rekomandim: Nga DPKZHT Mirditë të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPKZHT Mirditë, të shqyrtojë me përparësi të gjitha kërkesat e parashtruara nga këto autoritete dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi deri në plotësimin e kërkesave.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është në proces zbatimi.

Statusi: Proces.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një nga rastet e audituara, zhvilluesi ka filluar ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, më konkretisht:

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin "*Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues*", me subjekt zhvillues "Z-F" Shpk. Objekti ka filluar ndërtimin përpara pajisjes me leje ndërtimi. Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 30.04.2021. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Korrik, 2019, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Mirditë, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar.

15.1. Rekomandim: Bashkia Mirditë dhe DPKZHT të marrë masa dhe të përdorë të gjithë instrumentat për të kryer kontrollet e nevojshme deri në marrjen e sigurisë së plotë se objektet për të cilat aplikohet për leje zhvillimi / ndërtimi nuk kanë filluar ndërtimin pa marrë miratimet e nevojshme sipas ligjit. Në çdo rast të evidentuar, Bashkia Mirditë, DPKZHT dhe IMTV duhet të ndjekin procedurat ligjore për të gjithë ata subjekte që zhvillojnë objekte pa miratimin e organeve kompetente.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është në proces zbatimi.

Statusi: Proces.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në një nga rastet e audituara, objekti i ndërtuar dhe i pajisur me certifikatë përdorimi, ndryshon nga projekti i miratuar, më konkretisht:

Certifikatë përdorimi miratuar me vendim nr.6, nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë për objektin “*Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të*”, me subjekt zhvillues z. K M. Nga verifikimi në terren dhe këqyrja e dokumentacionit fotografik të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar, pasi në fasadën lindore dhe perëndimore, kati papafingo, janë realizuar çarje të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në projektin e miratuar. Gjithashtu në fasadën veriore konstatohet ndërtimi i një hapësire, i përbërë nga mure dhe soletë beton/arme, të paparashikuara në projektin e miratuar, e cila lidh objektin me murin mbajtës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 39 të Ligjit 107/2014, “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

16.1. Rekomandim: Bashkia Mirditë, DPKZHT dhe IMTV të marrin masa për të mos lejuar asnjë objekt në zhvillim të devijojë nga projekti i miratuar, në kushtet e mungesës së lejeve të posaçme. Bashkia Mirditë të mos miratojnë asnjë certifikatë përdorimi kur konstatohet se ky objekt ka shmangie nga projekti i miratuar, pa proceduar paraprakisht me ndjekjen e hapave ligjor, deri në ndryshimin e objektit sipas projektit të miratuar, si dhe penalizimin e personave përgjegjës.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është në proces zbatimi.

Statusi: Proces.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh”, Bashkia Mirditë, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 184,001,854 lekë, realizuar nga BOE “L VII” SHPK & “K” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 540,416 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe BOE “L VII” SHPK & “K” SHPK.

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **540,416 lekë pa tvsh** nga BOE “L VII” SHPK & “K” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022, me objekt “Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh”, Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është zbatuar sipas ekstraktit të llogarisë se thesarit e muajit shkurt 2024, derdhje në llogarinë e Bashkisë Mirditë nga “L VII” sh.p.k vlera 540 416 lekë, bashkëngjitur kopje e ekstraktit.

Statusi: Zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikonstruktion i plotë Pallati i Sportit “Arjana Arapi” Rrëshen”, Bashkia Mirditë*, me vlerë të kontratës (me tvsh) 63,269,169 lekë, realizuar nga BOE “A M” SHPK & “J” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 638,120 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4616 prot., datë 23.10.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe BOE “A M” SHPK & “J” SHPK.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **638,120 lekë pa tvsh** nga BOE “A M” SHPK & “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018, me objekt *“Rikonstruktion i plotë Pallati i Sportit “Arjana Arapi” Rrëshen”, Bashkia Mirditë*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

Statusi: Pazbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)”, Bashkia Mirditë*, me vlerë të kontratës (me tvsh) 47,196,085 lekë, realizuar nga OE “A M” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 300,924 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3196 prot., datë 06.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe OE “A M” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 300,924 lekë pa tvsh nga OE “A M” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3196 prot., datë 06.08.2019, me objekt *“Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)”, Bashkia Mirditë*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

Statusi: Pazbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikonstruktion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen”, Bashkia Mirditë*, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 362,526,402 lekë, realizuar nga OE “U” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 326,400 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1282/16 prot., datë 13.07.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe OE “U” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **326,400 lekë pa tvsh** nga OE “U” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1282/16 prot., datë 13.07.2022, me objekt *“Rikonstruktion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen”, Bashkia Mirditë*, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është zbatuar sipas ekstraktit të llogarisë së thesarit të muajit shkurt 2024, derdhje në llogarinë e Bashkisë Mirditë nga “U” shpk vlere 326 400 lekë, bashkëngjitur kopje e ekstraktit.

Statusi: Zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë”, me vlerë 42,261,108 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “L VII” SHPK, *rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara*, për zërin e punimeve: “2(3.25/b) Gërmim me krah, tokë e zakonshme” në vlerën **170,375 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 760 prot., datë 06.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “L VII” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **170,375 lekë pa TVSH** nga shoqëria “L VII” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt “Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë”.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është zbatuar sipas ekstraktit të llogarisë së thesarit të muajit shkurt 2024, derdhje në llogarinë e Bashkisë Mirditë nga “L VII” shpk vlere 170 375 lekë, bashkëngjitur kopje e ekstraktit.

Statusi: Zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan Mirditë”, me vlerë 69,805,421 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “K” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **457,017 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3072 prot., datë 29.07.2019 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “K” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **457,017 lekë pa TVSH** nga shoqëria “K” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3072 prot., datë 29.07.2019, me objekt “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan Mirditë”, Mirditë”, Bashkia Mirditë”.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

Statusi: Pazbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen” Bashkia Mirditë, me vlerë 69,805,421 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “U” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën 277,004 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3974 prot., datë 13.10.2021, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “U” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **277,004 lekë pa TVSH** nga shoqëria

“U” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3974 prot., datë 13.10.2021, me objekt “Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen” Bashkia Mirditë, Mirditë”, Bashkia Mirditë”.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është zbatuar sipas ekstraktit të llogarisë së thesarit të muajit shkurt 2024, derdhje në llogarinë e Bashkisë Mirditë nga “U” shpk vlere 277 004 lekë, bashkëngjitur kopje e 05.01.2024.

Statusi: Zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen” *Bashkia Mirditë*, me vlerë 103,177,350 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve “A K” SHPK & “G.C” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën 232,590 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 39746 prot., datë 13.10.2021, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe “A K” SHPK & “G. C” SHPK

8.1 Rekomandim: Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej 232,590 lekë pa TVSH nga “K” SHPK & “G.C” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr.39746 prot., datë 13.10.2021, me objekt “Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen”, Bashkia Mirditë”.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është zbatuar sipas ekstraktit të llogarisë së thesarit të muajit shkurt 2024, derdhje në llogarinë e Bashkisë Mirditë nga “A K” shpk vlere 232,590 lekë, bashkëngjitur fatura datë 05.01.2024.

Statusi: Zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)” *Bashkia Mirditë*, me vlerë 187,417,132 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “U” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara në vlerën 412,102 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3711/3 prot., datë 02.12.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “U” SHPK.

9.1 Rekomandim: Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej 412,102 lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “U” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr.3711/3 prot., datë 02.12.2022, me objekt “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)” Bashkia Mirditë”.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se ky rekomandim është zbatuar sipas ekstraktit të llogarisë së thesarit të muajit shkurt 2024, derdhje në llogarinë e Bashkisë Mirditë nga “U” shpk vlere 412 102 lekë, bashkëngjitur kopje e ekstraktit.

Statusi: Zbatuar.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën **16,418,632 lekë**, vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **6,160,335 lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është në vlerën **22,578,967 lekë** e cila përbëhet nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të vogël në shumën 2,045,473lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të madh në shumën 5,694,982lekë;
- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë” në vlerën prej 14,838,512 lekë, që i përkasin 4 subjekteve të mbartura që nga viti 2010.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181. me VKB nr. 100, datë 24.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022”.

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive 22,578,967 lekë, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:

- Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
- Të bashkërojnë punën me QKB Bashkia Mirditë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, sipas shkresës nr.Prot.2192/1 datë 13.06.2024 rezulton se përsa i përket biznesit të vogël, subjekte debitorë deri në fund të vitit 2023, nga 2,045,473 lekë janë paguar 863,688 lekë. Për subjektet e tjera janë ndjekur hapat e borxhit tatimor dhe gjatë vitit në vazhdim. Nga subjektet me status person juridik nga 5,694,982 të lënë shumë debitorë nga KLSH, janë arkëtuar 3,478,885 lekë. Të njëjtat hapa janë ndjekur dhe për këto subjekte. Në tabelën IV.1.1, ndodhur në aneks, gjendet lista me pagesat e kryera.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mirditë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për taksën e ndërtesës e truallit dhe tarifën pastrim, gjelbërim e ndriçim. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Mirditë dhe NJA taksohen gjithsej 4848 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Nga familjarët e taksuar konstatohet se në fund të vitit 2021 janë trashëguar 1461 familje me vlerë debitorë prej 4,646,301

lekë dhe në fund të vitit 2022 në Bashkinë Mirditë dhe NJA, janë gjithsej 2536 familje debitoare për vlerën 4,596,239 lekë, nga të cilat 558 familje janë të trashëguara nga viti 2021, te cilat nuk janë paguar as në vitin 2022 dhe 1978 janë debitor të krijuar brenda vitit 2022. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.100, datë 24.11.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022”, pika C.1, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.

2.1. Rekomandim: Bashkia Mirditë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksa dhe tarifave vendore të debitorëve familjarë në vlerën 4,596,239 lekë, si dhe të plotësojë e përditësojë regjistrin për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, sipas shkresës nr. Prot.2192/1 datë 13.06.2024 rezulton se për vitin 2023 është bërë përditësimi i regjistrit të taksapaguesve familjarë me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe është bërë përllogaritja e detyrimeve vendore referuar paketës fiskale të miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Nga vlera debitoare e lënë në vitin 2022 për shumën 4,596,239 lekë janë likujduar progresivisht gjatë vitit 2023 shuma prej 1,940,050 lekë.

Numri Rendor	Njësitë Administrative	Familje Aktualisht	Ngarkesa Fiskale	Numri Familjeve	Paguar (Lekë)	Numri Familjeve Debitore	Shuma Debitore
01,	Fanë	706	429.854	79	51.37	627	378.484
02,	Kaçinar	177	162.083	35	34.094	142	127.989
03,	Kthellë	430	616.631	21	20.632	409	595.999
04,	Orosh	411	611.735	127	198.856	284	412.879
05,	Rreshën	2116	6.501.560	560	1.271.823	1556	6.501.560
06,	Rubik	1031	2.451.478	208	362.011	823	2.451.478
07,	Selitë	165	149.878	3	1.264	162	148.614
TOTALI		5.036 familje	10.923.219	1033	1.940.050 lekë	4003	8.983.169

Burimi: Bashkia Mirditë.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, realizimi i taksës bujqësore është në vlerën 51,278 mijë lekë nga 188,700 mijë lekë ose në masën 27%. Nga kryqëzimi i informacionit të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me informacionin e administruar nga Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore/Spektori i Kadastrës mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, që familjet kanë në pronësi apo në përdorim rezultoi se, në planifikim është marrë në konsideratë vetëm sipërfaqja e fermerëve që kanë tapitë e tokave (ATM) për sipërfaqe të ndarë prej 932 ha, duke përjashtuar pjesën tjetër prej 2915 ha të ndarë sipas ligjit 7501. Debitorët për taksën e tokës bujqësore në fund të vitit 2021 janë në vlerën 188,474 lekë, gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë në vlerën 278,627 lekë dhe në fund të vitit 2022 debitorët në vlerë progresive janë 197,777 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, Aneksi 1 dhe me VKB nr. nr. 100 datë 24.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”, pika A.2 nën pika (b).

3.1. Rekomandim: Bashkia Mirditë, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e taksës bujqësore nga debitorët fermerë në vlerën 197,777 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në

bashkëpunim me Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore/Spektori i Kadastrës të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve, që kanë në pronësi apo në përdorim tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë, planifikimin e plotë dhe përlllogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, sipas shkresës nr. prot.2192/1 datë 13.06.2024 rezulton se përta i përket taksës së tokës bujqësore, nga 197,777 lekë vlerë debitoare e vitit 2022 janë likuajduar gjatë vitit 2023, 89,506 lekë. Ndërkohë Bashkia ka marrë masat që për subjektet familjare apo biznes që nuk likuajdojnë taksat ndaj Bashkisë, të mos marrin shërbime dokumentacioni.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale rezulton se, në Bashkinë Mirditë ka detyrime të papaguara në vlerën 1,282,663 lekë për 40 objekte, që janë legalizuar që nga viti 2019 deri në 31.12.2021. Nga korrespondenca zyrtare e Bashkisë Mirditë me ASHK Rajonale Lezhë për periudhën objekt auditimi rezulton se, gjatë vitit 2022 është krijuar gjendje debitoare prej 635,484 lekë e 27 përfituesve dhe në fund të vitit 2022 vlera progresive debitoare është 1,972,156 lekë të 67 përfituesve të legalizimit, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mirditë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesat në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe me VKB nr. 100, datë 24.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022”, pika A.4, nënpika (f).

4.1. Rekomandim: Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit në Bashkinë Mirditë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 67 debitorë në vlerën 1,972,156 lekë, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Mirditë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, me qëllim evidentimin e objekteve të legalizuara, evidentimin e pagesave dhe mbi bazën e tyre evidentimin e debitorëve.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, sipas shkresës nr. Prot.2192/1 datë 13.06.2024 rezulton e duke qenë se ka pasur vështirësi në kërkesën për informacion dërguar ASHK-së nga Urbanistika për subjektet që kanë bërë pagesën pranë ASHK-së, zyra e urbanistikës i ndjek sërish me shkresa zyrtare dhe informacion verbal ASHK-së Mirditë sepse është detyrë e ASHK që të mis japë asnjë dokumentacion pronësie pa shlyer detyrimet ndaj Bashkisë. Për sa më lart, informacioni i saktë është në zyrën e urbanistikës. Pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ardhur asnjë autorizim pagese për lejet e ndërtimit.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mirditë për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 43 kontrata për dhënien me qira

të tyre. Nga të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i dosjeve dhe ai financiar rezulton se, në fund të vitit 2021 paraqiten 5 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara me vlerë progresive debitore prej 15,176,566 lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 paraqiten 12 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara në *vlerën debitorë progresive prej 14,945,988 lekë*, vlerë e cila nuk rakordon me kontabilitetin. Në këtë gjendje debitorësh detyrime të pa paguara më të mëdha i kanë subjektet e dy kontratave: Subjekti qiramarrës “Sh”shpk me aktivitet “HEC”, kontrate e vitit 2017 me afat 10 vjecar, me detyrime të papaguara në vlerën 10,569,197 lekë, me aktivitet te pezulluar dhe Subjekti P-E me aktivitet “HEC” kontrate e vitit 2018 me afat 10 vjecar, me detyrime të papaguara në vlerën 1,784,791 lekë lekë, me aktivitet te pezulluar.

Gjithashtu referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Mirditë ushtrojnë aktivitetin 8 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Mirditë. Nga Bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimit të mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të mungura për Bashkinë Mirditë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 826-840, me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkëtesë neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 14,945,988 lekë, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 12 subjekte qiramarrës, si dhe të bëjë llogaritjen e kamatëvonesave për këto detyrime, referuar kushteve të kontratave. Në rast të mos kryerjes së pagesave nga qiramarrësi, të ndërmerrn hapa ligjor sipas parashikimeve të bëra në kontratë.

Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 8 rastet e subjekteve private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Mirditë, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave, që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga zhfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të Bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, sipas shkresës nr. Prot.2192/1 datë 13.06.2024 rezulton se në bazë të rekomandimit të lënë nga KLSH për vitin 2022, gjatë vitit 2023 janë arkëtuar detyrimet për subjektet e lëna debitore. Nga shuma e lënë prej 14,945,988 lekë janë arkëtuar 7,190,678 lekë gjatë vitit 2023. Për subjektet e mbetura janë marrë masat për njoftimin e tyre dhe janë kryer të gjitha negocimet me subjektet përkatëse debitore dhe pagesa e tyre vazhdon të kryhet dhe për vitin 2024. Bashkëngjitur janë të gjithë mandatët e pagesave të bëra gjatë vitit 2023)

	Subjekti	Ekonomia pyjore	Aktiviteti	Debitor 31.12.2022	Pagesat
1	A sh.a	Nenshejt	Antenë	140.1	05.04.2023
2	Al sh.a	Bulshizë	Antenë	170	26.05.2023
3	Vod. sh.a	Lurth	Antenë	60.3	
4	Tel. sh.a one	Fanë-Thirrë	Antenë	247.5	çmontuar që në 2021
5	T N	Ulez	Antene	85	26.05.2023

6	S	Fane -Thirre	Fabrikë uji	760.8	01.02.2023
7	E En.	Fanë-Konaj	HEC	247.7	18.01.2023
8	Kt shpk	Selitë	HEC	812	
9	Z-Xh	Munelle	HEC	610.5	
10	S Hec	Thirre-Fanë	HEC	2.010.458	
11	N Gj	Fane- Konaj	kullote	15.42	11.09.2023
12	R L	Kulme Derven	Kullota	20.2	24.01.2023
13	M M	Fan Xhuxhë	Kullota	21.25	04.01.2024

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mirditë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Në territorin e Bashkisë Mirditë për periudhën objekt auditimi kanë ushtuar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 14 subjekte nga të cilat, 4 subjekte konstatohet se kanë detyrime të papaguara në vlerën 2,650,000 lekë, si: shoqëria “K” shpk në vlerën 600,000 lekë, shoqëria “L” shpk në vlerën 850,000 lekë, shoqëria “D” shpk në vlerën 200,000 lekë dhe shoqëria “N G” shpk ka detyrim të hershëm në vlerën 1000,000 lekë, ku aktiviteti i tyre figuron i pezulluar apo i mbyllur. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

6.1 Rekomandim: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, nga subjektet: shoqëria “K” shpk në vlerën 600,000 lekë, shoqëria “L” shpk në vlerën 850,000 lekë, shoqëria “D” shpk në vlerën 200,000 lekë dhe shoqëria “N G” shpk në vlerën 1,000,000 lekë si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve. Bashkia Mirditë të ndërpresë praktikën e hartimit të aktmarrëveshjeve për pagesën me këste të detyrimit të për paisjen me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, sipas shkresës nr. Prot.2192/1 datë 13.06.2024 rezulton se në bazë të rekomandimit të lënë nga KLSH, përse i përket subjekteve K, L, D dhe N G, asnjë nga këto subjekte nuk kanë bërë pagesën që kanë detyrim. Në monitorimin e KLSH-së për vitin 2023, janë paraqitur akt konstatimet për L shpk dhe N G që këto subjekte nuk ushtrojnë aktivitet realisht. Ndërsa subjektet e tjera nuk kanë bërë akoma pagesë dhe vazhdojnë të jenë debitor për shumat e lëna. Gjithashtu ju bëjmë me dije se gjatë vitit 2023 nuk është lëshuar autorizim për asnjë subjekt për tregtim karburanti.

Statusi: Pjesërisht e zbatuar.

E. MASA DISIPLINORE.

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja i rekomanduar **Kryetarit të Bashkisë Mirditë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të

atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05/03/2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale për **15 punonjës**, si më poshtë:

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandimë Kryetarit të Bashkisë Mirditë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a. **“Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”**, sipas shkeljeve të konstatuara për punonjësit si më poshtë:

1. Z. M. P, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

2. Z. T. P, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

3. Zj. A. D, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për moszbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 53, pika 4, si dhe në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në procedurat si më poshtë:

- Për procedurën e prokurimit, “Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit ‘Arjana Arapi’ Rrëshen” - viti 2018, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë” - viti 2018, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Rehabilitimi i skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza2)” - viti 2019, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Rehabilitimi i skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)” - viti 2019, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar “Ndrec N. Gjoka” Fan” - viti 2019, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës “Pashko Vasa” Rrëshen”, Bashkia Mirditë” - viti 2019, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Ndërtimi I Ujësjellësit qyteti Rubik”, Bashkia Mirditë”, viti 2020, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Blerje Automjet teknologjik (kamion) për grumbullimin dhe konteniere (kosha) të përshtatshëm për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Mirditë”

- viti 2021, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

4. Zj. M. D, në cilësinë e antarit të Njesisë së Prokurimit;

5. Z. B. D, në cilësinë e antarit të Njesisë së Prokurimit;

6. Zj. M. M, në cilësinë e antarit të Njesisë së Prokurimit;

7. Z. A. M, në cilësinë e antarit të Njesisë së Prokurimit.

Për moszbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26, pika 5, si dhe në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për procedurën e prokurimit:

- “Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen” - viti 2018;
- “Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë” - viti 2018;
- “Rehabilitimi i skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)” - viti 2019;
- “Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës “Pashko Vasa” Rrëshen - viti 2019;
- “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar “Ndrec N. Gjoka” Fan” - viti 2019.
- “Ndërtimi I Ujësjiellësit qyteti Rubik”, Bashkia Mirditë”, viti 2020;
- “Rehabilitim I rrjetit ujitës Malaj-Tarazh”, Bashkia Mirditë, viti 2021
- “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), rikonstruksionit të objekteve arsimore dhe publike si dhe përgatitja e shesheve të ndërtimit per banesat individuale”, Viti 2021;
- “Ndërtimi I Ujësjiellësit qyteti Rubik (Shtesë projekti)”, viti 2022
- “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), ne qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)”, viti 2022

8. A. P, në cilësinë e antarit të Njesisë së Prokurimit për procedurat e prokurimit:

- “Rehabilitim i rrjetit ujitës Malaj-Tarazh”, Bashkia Mirditë”, viti 2021
- Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), rikonstruksionit të objekteve arsimore dhe publike si dhe përgatitja e shesheve të ndërtimit per banesat individuale”, Viti 2021;
- “Ndërtimi i Ujësjiellësit qyteti Rubik (Shtesë projekti)”, viti 2022
- “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), ne qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)”, viti 2022

9. N. N, në cilësinë e antarit të Njesisë së Prokurimit, për procedurën e prokurimit, “Blerje Automjet teknologjik (kamion) për grumbullimin dhe konteniere (kosha) të përshtatshëm për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Mirditë” - viti 2021,

10. F. C, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, pasi nuk ka administruar sipas legjislacionit në fuqi dosjet personale të nëpunësve të MZSH.

b. “Vërejtje me paralajmërim” për:

11. Z. J. K, në funksionin e kontrolluesit të shqyrtimit të aplikimeve pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit;

Për shkeljet e konstatuara që kanë të bëjnë me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, më konkretisht, për miratimin e lejeve të ndërtimit kur objekti nuk respekton kondicionet urbane në 4 (katër) raste, kur janë konstatuar mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e

kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi në 6 (gjashtë) raste, për mos-kërkimin dhe respektimin e mendimit të autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në 4 (katër) raste, për miratimin e lejes së ndërtimit pa marrë sigurinë e plotë se zhvilluesi nuk e ka filluar ndërtimin e objektit përpara marrjes së miratimit në 1 (një) rast, për miratimin e certifikatës së përdorimit kur objekti i zbatuar ka ndryshime nga ai i miratuar në 1 (një) rast.

c -“Vërejtje” neni 58 shkronja (a), për katër punonjës si më poshtë:

12. Zj. D. N, me detyrë Drejtore e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore

13. Zj. M. N, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave.

Për mangësitë e konstatuara:

Në mospërputhje me kërkesat e VKB nr.100, datë 24.11.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet neni neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23 neni 24, neni 4 pika 7, nenet 89, 90, 91, 93, 94 si:

- Mos planifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mospasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhurave, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore

- Mos marrjen e masave për mbledhjen e detyrimeve tatimore nga biznesi i madh dhe i vogël, të cilat në fund të vitit 2022 janë në vlerën progresive debitore prej 22,578,967 lekë për taksa e tarifa vendore.

- Mos mbajtje të regjistrave të plotë, planifikim jo i saktë dhe mos vjelje e taksës së ndërtesës e truallit, tarifat pastrim-ndriçim-gjelbërim-arsim të taksapaguesve të kategorisë “Familjar” dhe mos identifikim i plotë i familjeve, që kanë detyrim për këto taksa e tarifa, ku vlera debitore progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën 4,596,239 lekë lekë, që i përkasin 2536 familjeve debitore,

- Planifikim jo i saktë i taksës bujqësore, pasi në planifikim është marrë në konsideratë vetëm sipërfaqja e fermerëve që kanë tapitë e tokave (ATM) për sipërfaqe të ndarë prej 932 ha, duke përjashtuar pjesën tjetër prej 2915 ha të ndarë sipas ligjit 7501. Mos arkëtim i taksës bujqësore, ku realizimi i saj është në masën 27% dhe detyrimet debitore progresive në fund të vitit 2022 janë në vlerën 197,777 lekë.

14. Zj.E. V, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Pronave të Palujtshme, Aseteve, Riskut në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

15. Z. E. D, me detyrë specialiste e menaxhimit të asetëve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për mangësitë e konstatuara:

Në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 826-840, me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkëtesë neni 5 "Pagesa e tarifës së qirasë" si:

- Për mos marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore nga 12 subjekte qiramarrës në vlerën 14,945,988 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.

- Mosmenaxhim i asetëve të Bashkisë Mirditë që shfrytëzohen nga subjekte private pa qira dhe si rezultat nuk është marrë asnjë masë për përgatitjen e procedurave për lidhjen e kontratave për

shfrytëzim të parcelave pyjore në 8 raste të subjekteve që ushtrojnë aktivitet për nxjerrje, prodhim dhe shfrytëzim minerali dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë.

II. Për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masat Disiplinore” dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandua Kryetarit të Bashkisë Mirditë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “**Ndërprerje e kontratës së punës**”, për punonjësin:

16. Z. N. P., me detyrë, Kryeinspektor i IVMT për periudhën nën auditim, 2018-2022, për shkeljet si vijon:

- Për mungesë profesionale dhe mosmarrjen e masave në kohë, me qëllim parandalimin e ndërtimeve pa leje në kundërshtim me ligjin.

- Për periudhën 2018-2022 vetëm në një rast është mbajtur mbajtur vlera e gjobës sipas vlerës së punimeve të kryera, ndërsa për rastet e tjera nuk është ndjekur kjo praktikë, në kundërshtim me ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Neni 52/e, “Kundërvajtjet administrative”.

- Nga Kryeinspektori i IMVT Mirditë nuk janë marrë masat në kohë, nuk ka proces verbale konstatimi apo ndonjë masë tjetër administrative, për parandalimin e tre ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme, si më poshtë:

- Në njësinë strukturore MR_N_N_2274/1, “Objekti 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant)”, ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022;
- Njësia strukturore MR_N_N_72/1, Fshati Fan, njësia administrative Rrubik, “Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (bar-restorant)” që i përket Xh O, objekti ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022;
- Njësia strukturore MR_N_N4_72/1, Fan;
- Njësia Administrative Rubik, objekti i identifikuar si Kioskë Metalike me xhama që shërben si Lokal (Bar-Kafe), i gjendur anës Rrugës së Kombit, pranë ish uzinës ALB-Bakër.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton rekomandimi është zbatuar pasi është ngritur komisioni disiplinor për fillimin e procedurave, për punonjësit e ngarkuar me përgjegjësi, me urdhër nr.3386/26 Prot., datë 26.12.2023, me relacion bashkëshoqërues me shkresën nr.3386 Prot., datë 28.12.2023.

Statusi: Zbatuar.

F. MASA ADMINISTRATIVE:

-Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 4 faqe 84-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandua Kryetarit të Bashkisë Mirditë** që në zbatim të nenit 132, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, **t’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative** në raport me shkeljet e konstatuara, për **9 (nëntë) punonjësit**, të cituar tek masat disiplinore për shkeljet në fushën e prokurimeve.

- Referuar shkeljeve të konstatuara në evidentimin e ndërtimeve pa leje, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 1, Neni 15, dhe Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 51, pika 1, bazuar në Nenin 15 dhe Nenin 30, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomanduam**, Kryetarit të Bashkisë Mirditë t’i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore me gjobë, për **z. N. P.**, me detyrë Kryeinspektor i IVMT për periudhën nën auditim, 2018-2022, për shkak se nuk janë marrë masat në kohë për parandalimin e ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme.

- Në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 1, dhe Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 52, pika 5, bazuar në Nenin 15 dhe Nenin 30, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomanduam**, Kryetarit të Bashkisë Mirditë t’i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, Bashkia Mirditë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nisë procedurat për marrjen e masave të parashikuara në ligj, për subjektin ndërtues, projektues, mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për objektin e miratuar me çertifikatë përdorimi me vendim nr. 6, nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë “Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të”, me subjekt zhvillues z. K M. **G. Për punonjësit e larguar.**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” përkatësisht:

1. **Z. T. M.**, me detyrë ish-Drejtor i Agjencisë së Shërbimit Bujqësor dhe Pyjor (larguar shtator 2023).

2. **Z. R. B.**, anëtar i NJP dhe specialist i fushës.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton se masa është zbatuar.

Statusi: Zbatuar.

H. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qëndror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga dokumentacioni i paraqitur nga Bashkia, rezulton në proces zbatimi sipas shkresës nr. 2194/1 prot datë 04.06.2024.

Statusi: Në proces zbatimi.

Konkluzioni:

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
Masa organizative	16	16	7	0	9	0
Masa për uljen e borxhit	6	6	0	6	0	0
Masa Disiplinore	1	1	1	-	-	-
Masa për Shpërbllim Dëmi.	9	9	6	0	0	3

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Mirditë për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së u konstatua se:

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Mirditë, nga KLSH me shkresën nr. Prot. 521/19 prot. datë 19.12.2023, bërë hyrje në Bashkinë Mirditë me shkresën nr. 3386/24 datë 21.12.2023 për periudhën e auditimit 1.1.2022-31.12.2022, janë marrë një sërë masash dhe përgatitur programe me afate dhe persona për zbatimin e rekomandimeve. Janë përcaktuar strukturat përgjegjëse që do merren me realizimin e rekomandimeve sipas afateve kohorë të përcaktuar referuar Urdhrit nr.470 datë 22/12/2023 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar. Plan Veprimi u është dërguar Këshillit Bashkiak dhe 10 (dhjetë) strukturave përgjegjëse, Drejtori, Ndërmarrje, Inspektorate e Sektorë që të bëjnë analizë të punës së tyre me qëllim përmirësimin e punëve në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Një kopje e Plan Veprimit i është dërguar dhe KLSH-ja, me shkresën nr.112, datë 09.01.2024, **brenda 20 ditëve** nga marrja e Rekomandimeve. Është dërguar Zbatimi i Plan Veprimit dhe Raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit 6 muor** nga marrja njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së dhe Rekomandimeve me shkresën nr.112/19, datë 19.06.2024,

I. Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Mirditë, nga KLSH me shkresën nr. Prot. 521/ prot. datë 19.12.2023, në mënyrë permbljedhese realizimi është si më poshtë:
-Nga 16 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht të 16 masat në Plan Veprimin e Bashkisë Mirditë, dërguar dhe KLSH, me shkresën nr 112, datë 09.01.2024. Nga 16 masa organizative janë zbatuar 7 masa, janë në proces 9 masa; Nga 9 masa me dëm ekonomik, janë pranuar plotësisht për zbatim ku 3 masa të pazbatuara, dhe 6 masa të zbatuara; Nga 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) janë pranuar të 6 masat të cilat janë në pjesërisht të zbatuara.

-Për masat disiplinore (16 masa gjithsej). Në Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së:

-Për masën disiplinore vërejtje deri largim nga puna janë dhënë 10 masa për 10 punonjës me status NC nga të cilët 7 punonjës janë larguar nga puna dhe 3 aktualisht janë në marrëdhënie pune.

-Për masë disiplinore, vërejtje me paralajmërim është dhënë 1 masë.

-Për masë disiplinore vërejtje, janë dhënë gjithsej 4 masa disiplinore.

-Për punonjës të punësuar me kontratë individuale pune sipas K.P është dhënë 1 masë disiplinore për largim nga puna, rekomandimi në proces zbatimi, për sa më sipër masa disiplinore është e zbatuar.

1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshejtimin e atyre në proces, si vijon:

B. MASA ORGANIZATIVE

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **638,120 lekë pa tvsh** nga BOE “A M” SHPK & “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018, me objekt “Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit “Arjana Arapi” Rrëshen”, Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **300,924 lekë pa tvsh** nga OE “A M” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3196 prot., datë 06.08.2019, me objekt “Rehabilitimi i skemës ujëtare të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)”, Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

6.1 Rekomandim: Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **457,017 lekë pa TVSH** nga shoqëria “K” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr.3072 prot., datë 29.07.2019, me objekt “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan Mirditë”, Mirditë”, Bashkia Mirditë”.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifavat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive 22,578,967 lekë, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:

-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- Të bashkërojnë punën me QKB Bashkia Mirditë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

2.1. Rekomandim: Bashkia Mirditë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksa dhe tarifavat vendore të debitorëve familjarë në vlerën 4,596,239 lekë, si dhe të plotësojë e përditësojë regjistrin për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

3.1. Rekomandim: Bashkia Mirditë, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e taksës bujqësore

nga debitorët fermerë në vlerën 197,777 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore/Sektori i Kadastrës të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve, që kanë në pronësi apo në përdorim tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë, planifikimin e plotë dhe përlllogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

4.1. Rekomandim: Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit në Bashkinë Mirditë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 67 debitorë në vlerën 1,972,156 lekë, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Mirditë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, me qëllim evidentimin objekteve të legalizuara, evidentimin e pagesave dhe mbi bazën e tyre evidentimin e debitorëve.

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 14,945,988 lekë, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 12 subjekte qiramarrës, si dhe të bëjë llogaritjen e kamatëvonesave për këto detyrime, referuar kushteve të kontratave. Në rast të mos kryerjes së spagesave nga qiramarrësi, të ndërmerren hapa ligjor sipas parashikimeve të bëra në kontratë. Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 8 rastet e subjekteve private për prodhim dhe nxjerrje minerare e insertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullësor, asete të Bashkisë Mirditë, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave, që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga shfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të Bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

6.1 Rekomandim: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, nga subjektet: Shoqëria “K” shpk në vlerën 600,000 lekë, Shoqëria “L” shpk në vlerën 850,000 lekë, Shoqëria “D” shpk në vlerën 200,000 lekë dhe Shoqëria “N G” shpk në vlerën 1,000,000 lekë si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve. Bashkia Mirditë të ndërpresë praktikën e hartimit të aktmarrëveshjeve për pagesën me këste të detyrimit të për pajisjen me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni protokolluar në KLSH me shkresë nr.1344/2, datë 27.12.2024 dhe nr.1344/4 datë 10.02.2025 “Mbi Aktet e konstatimit dhe mbi Projektraportin e Auditimit” nga z/znj. D N, E Vj, M N, V T, K M dhe G M, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1-Lidhur me taksën e fjetjes në hotel, gjatë vitit 2024 janë marrë masat për arkëtimin e tarifës planifikuar në vitin 2023...

2-Sa i përket hapësirës publike është lidhur marrëveshja me subjektin dhe bërë përlllogaritjet me 100 lekë/m² në vit, ndërkohë në paketën fiskale është 100 lekë/m² në muaj. Nga drejtoria e të

ardhurave nuk është vënë re dhe pas konstatimit tuaj është bërë njoftimi për diferencën e papaguar ku deri tani janë arkëtuar 204.060 lekë.

3-Lidhur me pajisjen me autorizime të subjekteve që tregtojnë karburant sqarojmë se, në vitin 2023 nuk është dhënë asnjë autorizim. Shuma debitorë deri në 01.11.2024 është 2,650,000 lekë dhe për këtë shumë janë marrë të gjitha masat për arkëtim....

4-Lidhur me tarifat dhe taksat e bizneseve sqarojmë se në sajë të masave shtrënguese të marra nga sektori i taksave për vitin 2024 është bërë i mundur arkëtimi i mbi 50% të shumës debitoare...

5-Në lidhje me nivelin dhe aplikimin e taksave dhe tarifave vendore për subjektet që tregtojnë karburant vetëm 2 prej tyre janë të regjistruar si “Autogrill”, ndërsa të tjerët tarifohen më vete për çdo aktivitet tjetër që kryejnë veç tregtimit të karburantit...

6-Lidhur me tarifat dhe taksat familjare gjatë vitit 2024 kanë paguar 2025 familje për detyrimet e prapambetura...shuma totale e detyrimeve të prapambetura të mbledhura gjatë vitit 2024 është mbi 50%...

7-U njohëm me projekt raportin dhe me gjetjet e lëna nga ana juaj. Më poshtë po paraqesim observacionin si dhe realizimet gjatë vitit 2024 të gjetjeve të lëna në projektin e raportit ...

8- Lidhur me gjetjen nr.2 të projekt raportit (faqe 89) sqarojmë se:

- Në auditimin e ushtruar nga ana Juaj na është kërkuar që të dorëzojmë planet strategjike në zyrën tuaj gjë e cila është realizuar. Në planet strategjike dhe vjetore miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit me shkresë nr.4125/2 të datës 17.10.2022 për vitin 2023 janë parashikuar 8 (tetë) subjekte, 2 (dy) nga të cilat me rrisht të lartë përkatësisht, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit-Sektori i Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e të Ardhurave Taksave, Menaxhimit të tregut dhe Transportit-Sektori i të Ardhurave-Taksave , Tarifa dhe Qera, si dhe 6 subjekte me risk të mesëm (Bashkëngjitur kopje).

- Përsa i përket rekrutimit, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” neni 11, pika 2, shkronja “c” sqarojmë se, nga ana Juaj nuk është referuar saktë neni 1 pika 2, shkronja “c” pasi siç jeni edhe në dijeni ligji nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” ka ndryshuar me ligjin nr.12/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 114 , datë 22.10.2015” i miratuar me datë 02.02.2023 dhe i botuar në fletoren zyrtare nr.27 të datës 27.2.2023 dhe germa “ç” e pikës 2 të nenit 11 thotë “ç) nëpunësi civil ose punonjësi që punësohet në njësinë e auditimit të brendshëm dhe që nuk zotëron certifikatën si auditues i brendshëm, gjatë 3 vjetëve të parë punon nën mbikëqyrjen e drejtuesit të njësisë së Auditimit të Brendshëm ose të një audituesi të brendshëm të certifikuar dhe me eksperiencë. Brenda kësaj periudhe, ky punonjës i nënshtrohet detyrimitsh procedurës së certifikimit si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”. Në rast se brenda këtij afati nëpunësi civil ose punonjësi nuk certifikohet si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, i ndërpriten marrëdhëniet e punës, të cilat konsiderohen që janë ndërprerë për shkak të këtij ligji”...

- Nga ana juaj citohet se “Në disa dosje nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim. Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NJAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vëtvlerësimi periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII...Njësia e Auditimit të Brendshëm Ju sqaron me përgjegjësi të plotë se të gjithë Projekt Raportet e subjekteve të audituara janë kthyer me shkresë përcjellëse dhe të firmosura nga personat përgjegjës(Bashkëngjitur kopjet e shkresave dy nga projektet janë kthyer me observacione). Në të gjitha dosjet ndodhen vetëvlerësimet e grupit

të auditit. Reagimi i të audituarve është bërë në disa raste me anë të observacioneve . Letrat e punës janë të depozituara në dosjet e audituara...

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1-Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se taksa për fjetjen në hotel është një taksë që duhet mbledhur çdo fillim muaj dhe jo vitin pasardhës, prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2-Komentet e bëra nga ana e subjektit në lidhje me hapësirën publike nuk ka observim në lidhje me gjetjet e grupit të auditimit por ka vepruar duke nxjerr vendimet përkatëse për përmirësimin e situatës prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

3-Lidhur me komentet tuaj sqarojmë se gjatë vitit 2023 janë konstatuar se janë 5 subjekte të pa autorizuar ose ka mbaruar autorizimi, ushtrimi i aktivitetit të 5 subjekteve me tregtim të lëndëve djegëse, pa u pajisur me autorizimet përkatëse sjell të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë. Gjithashtu sipas të dhënave tuaja konstatohet se 6 subjekte janë debitor në vlerën prej 3,650,000 lekë. Nëse masat nga ana juaj janë marrë gjatë vitit 2024, kjo nuk është në tagrin tonë, pasi ne si grup auditimi kemi audituar për periudhën 2023, prandaj komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

4-Lidhur me tarifrat dhe taksat e bizneseve sqarojmë se nuk ka observim në lidhje me gjetjet e grupit të auditimit por ka vepruar duke nxjerr vendimet përkatëse për përmirësimin e situatës prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

5-Lidhur me komentet tuaja sqarojmë se në paketën fiskale nuk përcaktohet që tarifën prej 700,000 lekë do ta paguajnë vetëm subjektet të cilat janë të rregjistruara në QKB si autogrill, por edhe ato që përveç tregtimit të lëndës djegëse kanë edhe shërbime të tjera si bar, restaurant, hotel etj., prandaj komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

6-Lidhur me taksat familjare dhe taksën e tokës bujqësore komentet e subjektit nuk konsistojnë në kundërsime por në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2024, prandaj komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

7-Sa i përket observacionit ardhur me email datë 03.02.2025, nga ana e grupit të auditimit nuk merret në konsideratë, pasi e gjithë përmbajta i referohet gjetjeve të kryera nga grupi i auditimit të mëparshëm. Nga faqja 74-80 në projekt raport, është trajtuar drejtimi nr.4 i programit të auditimit, i cili i përket zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm. Prandaj komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.

8- Në lidhje me observacionin tuaj sqarojmë se, përsa i përket rastit për rekrutimin e punonjësve, dhe pjesës ku jeni shprehur lidhur me planifikimin e auditimeve sipas planeve startegjike dhe atyre vjetore, këto dy çështje merren në konsideratë dhe do të trajtohen në Raportin e Auditimit, kjo bazuar dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion. Nga ana tjetër konstatohet se, nga NJAB nuk janë kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së intitucionit, dhe përsa i përket pretendimit se, keni pasur ndryshim plani miratuar nga Kryetari i Bashkisë, grupi i auditimit thekson se, Drejtuesi i njësisë së auditimit, duhet të shqyrtonte dhe rregullonte planin, sipas nevojës, në përgjigje të ndryshimeve të aktivitetit të njësisë, reziqeve, operacioneve, programeve, sistemeve, dhe kontrolleve. Çdo devijim i rëndësishëm nga plani i aprovuar i auditimit të brendshëm do t'i komunikohet menaxhimit të lartë dhe komitetit të auditimit përmes veprimtarisë raportuese periodike. Për ndryshimet dhe shmangiet nga plani vjetor duhet të jepen edhe arsyet të cilat kanë çuar në një gjë të tillë. Të gjithë planet vjetorë dhe strategjikë të rishikuar të auditimit të brendshëm duhet t'i dërgohen strukturës përgjegjëse të harmonizimit për AB-në, së bashku me shpjegimet e ndryshimeve të bëra. Përsa shpreheni për ndryshimin e planit observacioni nuk merret në konsideratë.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Sa i përket planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore konstatohet se, për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin (sipas tabelës II.6.1 në RPA, fq.30), gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, kjo vjen për shkak të mos njohjes së situatës apo moskryerjes së rregullt të procedurave duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave. Një ndër to është taksa e qarkullimit të mjeteve të përdorura, ku planifikimi për vitin 2023 është 8 milion lekë, ndërkohë që planifikimi për vitin 2022 ka qenë 10.5 milion lekë, edhe pse fakti për vitin 2022 ka qenë 12.4 milion lekë. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit të ndërmarrë masa të nevojshme për të siguruar që gjatë hartimit të planit të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, të kryejë planifikime realiste duke i mbështetur në analiza të detajuara për çdo zë të ardhurash.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat e konsoliduara gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në fund të vitit 2023, paraqitet me një vlerë 6,284 mijë lekë e pa ndryshuar, nga viti mëparshëm. Konstatohet se:

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i Pyjeve dhe Kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në këtë llogari nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Mirditë, sipas VKM nr.433, datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 48, shtojca me nr.46, Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Mirditë, me numër rendor nga 1(një) deri 2160 (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë). Në këtë rast, pasqyrat financiare, nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e aktiveve, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 7, pika 1 dhe 2; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli IV, pika 74 dhe 96.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 3 faqe 41-58 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandim: Bashkia Mirditë, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Mjedisit dhe Pyjeve, të marrë masa për inventarizimin, evidentimin dhe regjistrimin në Pasqyrat Financiare, të pronave, pyje, kullota, plantacione.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se për vitin 2023, planifikimi i buxhetit i rishikuar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore transfertën e pa kushtëzuar dhe specifikën, ka vlerën 1,555,446 mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën 1,372,129 mijë lekë, ose në masën 88%. Ky mos realizim vjen si rezultat i mospasjes së fondeve në llogarinë e thesarit në momentin e lidhjes së kontratës Bashkia Mirditë në fillim të vitit buxhetor nuk ka planifikuar angazhime buxhetore realiste. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore nuk ka analizuar zbatimin e buxhetit brenda afateve siurse përcaktohet në ligj, në qershor të çdo viti dhe të propozonte në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, UMFE nr. 9, datë

20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, Udhëzimit MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë, dhe të marrë masat për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje nëpërmjet bankës, rezultoi se në vitin 2023, në 31 raste nëpërmjet urdhër shpenzimeve, janë kryer pagesa të faturave me vlerë 507,241 mijë lekë, mbi afatin 30 ditor nga momenti i mbërritjes së faturës tatimore në Bashkinë Mirditë, për shpenzime mallra e shërbime e investime. Nga sa më sipër, për 4 raste në vlerën 2,444 mijë lekë i përkasin faturave për mallra e shërbime (llog. 602 “shpenzime operative”), dhe në 27 raste në vlerën 504,797 mijë lekë për investime (llog.231), të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”, me Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 2 faqe 19-29 të Projekt Raportit të Auditimit).*

4.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga njësia e Auditimit të brendshëm nuk janë kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, Asetet, Taksat dhe tarifat vendore etj. Njësia e Auditimit të brendshëm nuk ka marrë në konsideratë se disa fusha me risk të lartë mund të nevojitet të auditohen çdo vit, sepse kanë në vazhdimësi risk shumë të lartë dhe sjellin ndikim negativ në njësinë publike. Gjithashtu, konstatohet se në ndryshimin e planit të auditimit nuk pasqyrohen shpjegimet e ndryshimeve të bëra, dhe arsyet që kanë ndikuar në lidhje me ndryshimin e planit. Këto veprime janë në kundërshtim me MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” kapitulli II 8. Plani i auditimit të brendshëm, kapitulli III pika 3.1.1. pika 3.4, 3.1.4 3.13 kapitulli IV, pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”; Kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, pika 6.1 “Niveli i dokumentimit.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 1.2 faqe 17-19 të Projekt Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që të auditohen fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të realizojë të auditime të thelluara duke përcaktuar afatet e realizimit, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB.

Menjëherë në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa Konstrukione” paraqitet në vlerë historike në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,360,758 mijë lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,123,344 mijë lekë. Për këto aktive nuk është kryer inventarizim fizik për të verifikuar

nëse gjendja fizike përputhet me atë kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 3 faqe 41-58 të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Strukturat Drejtuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë të marrin masa, që të kryhet procesi i inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, rezulton se vlera në fund të vitit 2023 ka në përbërje detyrime për garanci punimesh të Bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” si shkak i mungesës së informacionit, të mbartur si problematike nga ish komunat dhe Bashkitë. Në këtë rast, garancive të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur janë në vlerën 103,894 mijë lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr 48, datë.10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 5,6,7,9, dhe 10; ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 i ndryshuar me udhëzimin numër.5, datë 22.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, seksioni Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 3 faqe 41-58 të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave, të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë prej 103,894 mijë lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 u konstatua se:

“Mjedisi i Kontrollit”, lidhur me emërimet dhe largimet, sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” Kreu III, pika 27 dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52. “Menaxhimi i Riskut”, nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u konstatua se nga Bashkia Mirditë nuk ka plane operationale të punës, si dhe nuk është hartuar ende plani i përgjithshëm strategjik i zhvillimit me afat 5 vjeçar të Bashkisë Mirditë sipas përcaktimit në nenin 32 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. “Veprimtarit e Kontrollit”, mungojnë procedura të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm dhe hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë back-up për ruajtjen e tij në raste të jashtëzakonshme. “Informimi dhe Komunikimi”, mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. “Monitorimi”, mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Kjo

procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 24. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 1.1 faqe 12-17 të Projekt Raportit të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Mirditë, të marren masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherë të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë

9.Gjetje nga auditimi: nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Mirditë për zbatimin e Rekomandimeve të KLSH-së u konstatua se:

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Mirditë, nga KLSH me shkresën nr. Prot. 521/19 prot. datë 19.12.2023, bërë hyrje në Bashkinë Mirditë me shkresën nr. 3386/24 datë 21.12.2023 për periudhën e auditimit 1.1.2022-31.12.2022, janë marrë një sërë masash dhe përgatitur programe me afate dhe struktura përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve. Janë përcaktuar strukturat përgjegjëse që do merren me realizimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuar referuar Urdhërit nr.470 datë 22/12/2023 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë “Për ngritjen e grupit të punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar. Plan Veprimi u është dërguar Këshillit Bashkiak dhe 10 (dhjetë) strukturave përgjegjëse, Drejtori, Ndërmarrje, Inspektoriate e Sektorë që të bëjnë analizë të punës së tyre me qëllim përmirësimin e punës në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Një kopje e Plan Veprimit i është dërguar dhe KLSH, me shkresën nr.112, datë 09.01.2024, **brenda 20 ditëve** nga marrja e Rekomandimeve. Është dërguar Zbatimi Plani Veprimit dhe Raportimi në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, **brenda afatit 6 mujor** nga marrja njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së dhe Rekomandimeve me shkresën nr.112/19, datë 19.06.2024.

Në zbatim të Rekomandimeve të adresuara nga auditimi në Bashkinë Mirditë, nga KLSH me shkresën nr. Prot. 521/ prot. datë 19.12.2023, në mënyrë përmbledhëse, statusi realizimit është si më poshtë:

-Nga 16 Masa Organizative të rekomanduara, janë pranuar plotësisht të 16 masat në Plan Veprimin e Bashkisë Mirditë, dërguar dhe KLSH, me shkresën nr 112, datë 09.01.2024. Nga 16 masa organizative janë zbatuar 7 masa, janë në proces 9 masa; Nga 9 masa me dëm ekonomik, janë pranuar plotësisht për zbatim ku 3 masa të pazbatuara, dhe 6 masa të zbatuara; Nga 6 masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara) janë pranuar të 6 masat të cilat janë pjesërisht të zbatuara.

-Për masat disiplinore (16 masa gjithsej) në Plan Veprimin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së:

-Për masën disiplinore vërejtje deri largim nga puna janë dhënë 10 masa për 10 punonjës me status Nëpunës Civil nga të cilët 7 punonjës janë larguar nga puna dhe 3 aktualisht janë në marrëdhënie pune.

-Për masë disiplinore, vërejtje me paralajmërim është dhënë 1 masë.
 -Për masë disiplinore vërejtje, janë dhënë gjithsej 4 masa disiplinore.
 -Për punonjës të punësuar me kontratë individuale pune sipas Kodit të Punës është dhënë 1 masë disiplinore për largim nga puna, për sa më sipër masa disiplinore është e zbatuar. *(Trajtuar më hollësisht në pikën 4.1 faqe 58-86 të Projekt Raportit të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces, si vijon:

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 638,120 lekë pa tvsh nga BOE “A M” SHPK & “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018, me objekt “Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit Arjana Arapi” Rrëshen, Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 300,924 lekë pa tvsh nga OE “A M” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.3196 prot., datë 06.08.2019, me objekt “Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)”, Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

6.1 Rekomandim: Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej 457,017 lekë pa TVSH nga shoqëria “K” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3072 prot., datë 29.07.2019, me objekt “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan Mirditë, Mirditë, Bashkia Mirditë.

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive 22,578 mijë lekë, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:

-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- Të bashkërohet në punën me QKB Bashkia Mirditë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

2.1. Rekomandim: Bashkia Mirditë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore të debitorëve familjarë në vlerën 4,596 mijë lekë, si dhe të plotësojë e përditësojë regjistrin për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë

për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju linden familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

3.1. Rekomandim: Bashkia Mirditë, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës bujqësore nga debitorët fermerë në vlerën 197,777 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore/Spektori i Kadastrës të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve, që kanë në pronësi apo në përdorim tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë, planifikimin e plotë dhe për llogaritjen e detyrimeve që ju linden këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

4.1. Rekomandim: Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit në Bashkinë Mirditë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 67 debitorë në vlerën 1,972 mijë lekë, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Mirditë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, me qëllim evidentimin objekteve të legalizuara, evidentimin e pagesave dhe mbi bazën e tyre evidentimin e debitorëve.

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 14,945 mijë lekë, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 12 subjekte qiramarrës, si dhe të bëjë llogaritjen e kamatëvonesave për këto detyrime, referuar kushteve të kontratave. Në rast të mos kryerjes së pagesave nga qiramarrësi, të ndërmerren hapa ligjor sipas parashikimeve të bëra në kontratë.

Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 8 rastet e subjekteve private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Mirditë, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave, që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga zhfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të Bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

6.1 Rekomandim: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, nga subjektet: Shoqëria “K” shpk në vlerën 600,000 lekë, Shoqëria “L” shpk në vlerën 850,000 lekë, Shoqëria “D” shpk në vlerën 200,000 lekë dhe Shoqëria “N G” shpk në vlerën 1,000,000 lekë si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve. Bashkia Mirditë të ndërpresë praktikën e hartimit të aktmarrvëshjeve për pagesën me këste të detyrimit të për paisjen me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.

Menjëherë

Sa më sipër, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e tyre në proces.

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mirditë familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, tarifën e gjelbërimit, tarifën e pastrimit dhe tarifën e ndriçimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Mirditë taksohen gjithsej 5036 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Sipas të dhënave të Bashkisë Mirditë, konstatohet se vlera e borxhit e krijuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, nga familjarët është në vlerën 8,983 mijë lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë. Nga grupi i auditimit konstatohet gjithashtu se kjo vlerë, në lidhje me debitorët familjarë për periudhën objekt auditimi, nuk është e kontabilizuar. Vlera debitore e kategorisë "Familjar" për taksat dhe tarifatat vendore, në krahasim me vitin 2022 ka rritje në vlerë të konsiderueshme. Kjo pasi në vitin 2022 debitorët e krijuar për këtë periudhë kanë qenë në vlerën 5,304 mijë lekë për 1978 familje ndërsa në vitin 2023 janë 8,983 mijë lekë për 4,003 familje.

Si përfundim, rezulton se në fund të vitit 2023 janë 4003 familje debitore, për një ose disa taksa dhe tarifa vendore, çka do të thotë se 79,5% e familjeve që taksohen/tarifohen janë debitor. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Bashkia Mirditë, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të krijuara për taksa dhe tarifatat vendore të debitorëve familjarë në vlerën 8,983 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën 27,780 mijë lekë, vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2023 është 5,836 mijë lekë, pakësimet gjatë vitit 2023 janë 4,775 mijë lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive në fund të vitit 2023, sipas Bashkisë Mirditë, është në vlerën 28,842 mijë lekë. Kjo vlerë, është krijuar nga detyrimet e taksave dhe tarifave të biznesit të vogël, detyrimet nga taksat dhe tarifatat e biznesit të madh si dhe detyrime nga personat fizikë/juridikë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë" në vlerën prej 14,838 mijë lekë, që i përkasin 4 subjekteve të mbartura që nga viti 2010. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime, Kreut XI-"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara" neni 89, 90, 91, 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit në Bashkinë Mirditë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën progresive 28,842 mijë lekë, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:

-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar dhe nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- Të bashkërojnë punën me QKB Bashkia Mirditë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status

pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Grupi i auditimit, mori në shqyrtim disa subjekte për nivelin e pagesës së taksave dhe tarifave, krahasuar me taksat dhe tarifat të përcaktuara në paketën fiskale për vitin 2023. Nga kjo u konstatua se disa subjekte (për tarifën e pastrimit), nuk janë tarifuar sipas VKB-së nr.100, datë 30.11.2022 për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2023”(sipas tabelës nr.II.6.7, trajtuar në RPA, fq.33). Kështu:

- 7 subjekte me aktivitet tregtim i karburantit plus shërbime të tjera si servis, lavazh, hotel, bar-kafe, ushqim i shpejt etj., tarifohen sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.4 rendor i tabelës me vlerë 150,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikoheshin sipas nr.23 rendor me vlerë 700,000 lekë.
- 1 subjekt me aktivitet investime më ndërtim, tarifohen sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.8 rendor i tabelës me vlerë 200,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikoheshin sipas nr.17 rendor me vlerë 300,000 lekë.
- 1 subjekt me aktivitet kërkim, zbulim, shfrytëzim kromi, tarifohet sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.4 rendor i tabelës me vlerë 150,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikoheshin sipas nr.9 rendor me vlerë 700,000 lekë.
- 1 subjekt me aktivitet investime më ndërtim, tarifohet sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.7 rendor i tabelës me vlerë 30,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikoheshin sipas nr.2 rendor me vlerë 60,000 lekë.
- 4 subjekte me aktivitet këmbim valutor, tarifohen sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.2 “Tarifa pastrimit për biznesin e vogël”, nr.12 rendor i tabelës me vlerë 10,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikoheshin sipas pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.13 rendor me vlerë 50,000 lekë.
- 5 subjekte me aktivitet farmaci, tarifohen sipas kreut III të paketës fiskale, pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.15 rendor i tabelës me vlerë 20,000 lekë, ndërkohë që duhej të klasifikoheshin sipas pikës 1.3 “Tarifa pastrimit për biznesin e madh”, nr.14 rendor me vlerë 30,000 lekë.

Si konkluzion, nga mos tarifimi sipas përcaktimeve të paketës fiskale të miratuar për vitin 2023, janë krijuar të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë, në vlerën prej 4,690 mijë lekë. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Bashkia Mirditë, Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit të marrë masat e menjëhershme për rivlerësimin e situatës financiare të subjekteve nga mos tarifimi i saktë (të ndodhura në tabelën nr.II.6.7) dhe arkëtimin e detyrimeve përkatëse në vlerën 4,690 mijë lekë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Të ardhura të munguara nga mos planifikimi i saktë i taksës së tokës bujqësore dhe mos pagimi i kësaj takse. Rezulton se sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve është 934.4 ha e ndarë sipas kategorisë VII-X. Për këtë sasi toke të ndarë, planifikimi i kësaj takse për një vit ushtrimor duhej të ishte në vlerën 457,855 lekë, por në fakt nga Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit, është planifikuar në vlerën prej 450,974 lekë. Nga Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit nuk është kryer një analizë e detajuar në planifikimin e të ardhurave, për arsye se nuk janë parashikuar edhe të ardhurat që do të vijnë nga arkëtimet si pasojë e detyrimeve të mëparshme. Gjithashtu evidentohen diferenca midis çmimit për kategori, sipas ligjit dhe sipas VKB për miratimin e paketës fiskale. Ky veprim rezulton në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 23. Nëse merret në përlllogaritje çmimi sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara, parashikimi duhej të ishte $934,4 \text{ ha} \times 700 \text{ lekë/ha} = 654,078 \text{ lekë}$ dhe jo 457,855 lekë e parashikuar me 490 lekë/ha (sipas PF), duke krijuar një *diferencë prej 196,223 lekë, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë.*

Sa i përket debitorëve për tokën bujqësore, për vitin 2023, për 7 njësitë administrative rezulton të jetë në vlerën 383,602 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Mirditë.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit të marrë masa për përlllogaritjen e saktë të planifikimit të taksës së tokës bujqësore, si dhe të marrë masat e nevojshme ndaj familjarëve debitorë për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore në vlerën 579,825 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Konstatohet se në Bashkinë Mirditë për periudhën e auditimit, kanë ushtruar aktivitet 5 subjekte me tregtim të lëndëve djegëse pa u pajisur me autorizimet përkatëse. Kjo ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë në vlerën prej 5,000 mijë lekë. Gjithashtu sipas të dhënave të Bashkisë konstatohet se 6 subjekte janë debitorë në vlerën prej 3,650 mijë lekë. Këto detyrime të cilat konsiderohen të ardhura të munguara, janë krijuar nga mos zbatimi i përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9, pasi subjektet duhej të pajiseshin me autorizimin përkatës vetëm pas kryerjes së plotë të pagesës prej 1,000 mijë lekë.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë, për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, nga subjektet: Shoqëria “K” SHPK në vlerën 400,000 lekë, Shoqëria “L” SHPK në vlerën 650,000 lekë, Shoqëria “D” SHPK në vlerën 200,000 lekë, Shoqëria “N G” SHPK në vlerën 1,000,000 lekë, “D B Oil” në vlerën 600,000 lekë dhe “A” SHPK në vlerën 800,000 lekë, si dhe të ndërpresë praktikën e aktmarrëveshjeve për pagesën me këste të detyrimit për pajisjen me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.

5.2 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit, në koordinim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Policinë Bashkiake, duhet të marrë masa për të njoftuar subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve të pa licensuar, me qëllim që ata të aplikojnë dhe të licencohen për aktivitetin e tyre. Në rast se këto subjekte nuk përmbushin kërkesat, duhet t’i drejtohen me një shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për krijimin e një grupi pune të përbashkët me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial, me qëllim bllokimin e veprimtarisë së atyre subjekteve që operojnë pa licencë/autorizim në tregtimin e karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Bazuar në të dhënat e Bashkisë Mirditë, grupi i auditimit konstaton se vlera e përlllogaritur për vjeljen e tarifës së hapësirës publike nuk është në përputhje me përcaktimet e Paketës Fiskale, të miratuar për vitin 2023. Në Paketën Fiskale, pika nr.7 “Taksa e hapësirës publike”, përcaktohet se tarifa do të jetë me 100 lekë/m²/muaj, ndërkohë që Drejtoria e të Ardhurave e ka faturuar 100 lekë m²/vit, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën prej 163,010 (detyrimi mujor i subjekteve) x 11 muaj = 1,793,110 lekë.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Bashkia Mirditë, përmes Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për të nxjerr njoftimet e vlerësimeve për arkëtimin e detyrimeve për taksën e hapësirës publike nga 74 subjekte të përlogaritura debitorë, në shumën prej 1,793 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të subjektit rezultojnë se për vitin 2023 bizneset kanë krijuar një borxh prej 5,316 mijë lekë detyrime dhe 520,000 lekë penalitete. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se në lidhje me penalitetet Drejtoria e të Ardhurave nuk i ka aplikuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114, si dhe jo në përputhje me Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2023 me nr.100, datë 30.11.2022 “Miratimin e paketës fiskale vendore, për vitin 2023”, kreu VII, ku përcaktohet se mospagimi në afat i detyrimeve aplikohet penalteti me 0,06 % në ditë, e shumës së detyrimit për 365 ditë, si dhe 5,000 lekë për biznesin e vogël dhe 10,000 lekë për biznesin e madh. Grupi i auditimit përlogariti kamat vonesat dhe penalitetet për subjektet debitor dhe rezultoi një diferencë prej 1,254,409 lekë, e cila përbëhet nga 7,091,347 lekë (përlogaritje nga grupi i auditimit) - 5,836,938 lekë (përlogaritje nga Drejtoria e të ardhurave). Në përfundim, bizneset kanë krijuar një borxh prej 7,091,347 lekë të cilat konsiderohen të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit të marrë masa për të nxjerr njoftimet e vlerësimeve për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë (të ndodhura në tabelën nr.II.6.5), duke përlogaritur edhe penalitetet përkatëse sipas ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, neni 114 dhe VKB-së nr.100, datë 30.11.2022 për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2023”, kreu VII, si dhe të kryejë kontabilizimin e tyre, në vlerën prej 7,091 mijë lekë.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Mirditë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 40 kontrata/marrëveshje për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qira pyjore). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, janë gjithsej 10 subjekte debitorë në vlerën 16,129 mijë lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Mirditë, për marrjen me qira të sipërfaqeve të ndryshme. Në lidhje me debitorët e vitit 2022, të cilët kanë kryer shlyerjen e detyrimeve gjatë vitit 2023 (në total 11 subjekte me vlerë 5,768 mijë lekë), nga grupi i auditimit u konstatua se Bashkia Mirditë nuk ka aplikuar penalitetet për mos pagimin e detyrimeve në afatet e përcaktuara sipas kontratave përkatëse. Nga të dhënat e kontratave (sipas tabelës nr.II.6.9), konstatohet se mos pagimi në afat i detyrimeve penalteti është 10% e detyrimit, çka do të thotë se për Bashkinë Mirditë për vitin 2023 janë krijuar të ardhura të munguara nga mos aplikimi i penaliteteve për kontratat e lidhura, në vlerën prej 576,821 lekë, dhe 16,129 mijë të ardhura të munguara nga mos mbledhja e detyrimeve të qerasë.

(Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 faqe 29-40 të Projekt Raportit të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit në Bashkinë Mirditë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 16,129 mijë lekë, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 10 subjektet qiramarrës. Të bëjë llogaritjen e kamatëvonesave për subjektet debitorë në fund të vitit 2023, si dhe ato të mbledhura gjatë vitit 2023, pa llogaritur kamatëvonesat në vlerën prej 576,821 lekë. Në rast të mos kryerjes së pagesave nga qiramarrësi, të ndërmerren hapa ligjor sipas parashikimeve të bëra në kontratë deri në zgjidhjen e saj.

C. MASA DISIPLINORE

C.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe të nenit 64 shkronja “g”, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Mirditë**, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore **“Vërejtje”**, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. D. N, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së të Ardhurave-Taksave, Menaxhimit të Tregut dhe Transportit

2. Znj.M. N, në cilësinë e Përgjegjëses së Sektorit të Taksave dhe Tarifave;

3. Znj.E. V, në cilësinë e Përgjegjëses së Borxhit Tatimor;

4. Z.V. T, në cilësinë e inspektorit të taksave dhe tarifave;

5. Z. K. M, në cilësinë e inspektorit të taksave dhe tarifave;

6. Znj.E. D, me detyrë specialiste e menaxhimit të aseteve në Drejtorinë e të Ardhurave;

Për shkeljet e mëposhtëme:

- vlerën e përlllogaritur për vjeljen e tarifës së hapësirës publike nga 100 lekë/m2/muaj në 100 lekë m2/vit, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën prej 1,793,110 lekë;

- penalitetet Drejtoria e të Ardhurave nuk i ka aplikuar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 114, si dhe jo në përputhje me Paketën Fiskale të miratuar për vitin 2023, kreu VII, duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën prej 1,254,409 lekë;

- disa subjekte (për tarifën e pastrimit), nuk janë tarifuar sipas VKB-së nr.100, datë 30.11.2022 për “Miratimin e Paketës Fiskale Vendore viti 2023” duke krijuar të ardhura të munguara prej 4,690,000 lekë;

- mos aplikimin e penaliteteve për pagimin e detyrimeve jo në afatet e përcaktuara sipas kontratave të qerasë përkatëse, duke krijuar të ardhura të munguara prej 576,821 lekë.

C.2 PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandohet masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“Vërejtje”**, përkatësisht:

1. Z. M. P, ish zv.Kryetar i Bashkisë Mirditë;

2. Z. T. P, ish përgjegjës i Sektorit të Transportit Licencimit dhe Tregut të Lirë.

C.3 NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Mirditë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT